



Haxhi sipas Imam Khomeinit

HAXHI
sipas Imam Khomeinit

Tiranë, 2018

Titulli: Haxhi sipas Imam Khomeinit

E përktheu: **Vullnet Merja**

Recensent: **Sabrie Feza**

E redaktoi: **Jerida Kulla**

E korrektioi: **Vjollca Karaj**

Përgatiti për shtyp & Kopertina: **Sabrie Feza**

Botoi: **Shoqata "FLLADI"**

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

**Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!**

HYRJE

“Zoti ynë! Të lutemi Ty të mëshirosh udhëheqësin tonë të madh, që ka kaluar në Botën e Amshuar.

Të lutemi Ty, o i Plotfuqishmi Allah, ta falësh dhe ta mëshirosh atë njeri të ndershëm, atë besimtar të madh, atë besimtar të devotshëm, atë pasues të devotshëm të njerëzve të tu të dashur prej adhuruesve dhe njerëzve që kanë qenë pjesëtarë të hapësirave të afrimitetit Tënd.

Të lutemi Ty, o Allah, ta falësh, ta mëshirosh dhe ta begatosh këtë njeri mendjendritur, të zgjuar dhe të sinqertë.

Të lutemi o Allah, ta falësh atë njeri që ka luftuar dhe ka punuar gjatë gjithë jetës së tij vetëm për të fituar kënaqësinë Tënde të madhe. Hatri Yt i madh, ka qenë njësia e tij matëse, për të klasifikuar miqtë dhe armiqtë e tij.

Hatri Yt i madh, e ka ndihmuar atë, që të mos dobësohet përballë vështirësive më të mëdha.

Të lutemi Ty, o Allah, ta mbështjellësh Imamin e nderuar me mëshirën Tënde të madhe dhe me shpërblimin Tënd të pafund. Të lutemi Ty, o Allah, që të përcjellësh për shpirtin e tij një pjesë të shpërblimeve të adhuruesve dhe të haxhilerëve që e njohin atë si udhëheqësin e tyre dhe që e kanë ndjekur rrugën e tij. Bëji pjesë të mëshirës tënde, o Allah, të gjithë ata që kanë përfituar prej udhëzimit të tij dhe i kanë ndjekur me përpikëri këshillat, udhëzimet dhe mësimet e tij të vyera.

Të lutemi Ty, o Allah, që të realizosh ëndrrat e të gjithë atyre që, nëpërmjet kryerjes së ritualit të Haxhit, kanë për synim të realizojnë ringjalljen dhe përmendjen e këtij rituali abrahamik.

Të lutemi o Allah, të mëshirosh të gjithë ata që duan dhe synojnë që, nëpërmjet këtij rituali të shenjtë dhe madhështor, ymeti islam të përfitojë, të reformohet dhe të ngrihet në lartësitë që i meriton.”

Imami dhe udhëheqësi Es-Sejid Ali El-Khamenei

“إِنَّ أَوَّلَ بَيْتٍ وُضِعَ لِلنَّاسِ لَلَّذِي بِبَكَّةَ مُبَارَكًا وَهُدًى لِّلْعَالَمِينَ”

“Shtëpia e parë që është ndërtuar për njerëzimin, është ajo e ndërtuar në Bekë (prej emrave të Mekës). Ajo

Shtëpi është e begatë dhe burim udhëzimi për mbarë njerëzimin.”¹

Është bërë zakon mes myslimanëve, që, pjesa më e madhe e tyre, t’i japë rëndësi të veçantë pjesës sipërfaqësore të ritualeve të Haxhit. Ata harrojnë, shpesh, të përqendrohen te qëllimet dhe dimensionet e tjera të rëndësishme të Haxhit. Qëllimet e kësaj konference vjetore madhështore të myslimanëve në Vendet e Shenjta, organizuar prej Krijuesit, janë shumë herë më të mëdha se kryerja e disa ritualeve dhe sjelljeve adhurimi të caktuara, pa e mohuar dhe pa dashur të zbehim aspak rëndësinë e tyre të madhe. Kjo është një konferencë, një mbledhje apo një takim madhështor, ku mblidhen myslimanët e të gjitha racave të botës, të kombësive, të ngjyrave të lëkurës, të shtresave të ndryshme, me zakonet dhe veçoritë e secilës kombësi dhe racë.

Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*) vjen për të hedhur dritë dhe për të identifikuar për myslimanët në mbarë botën dimensionet më të rëndësishme dhe më të mëdha, që fshihen thellësive të një ushtrimi dhe adhurimi kaq të rëndësishëm hyjnor, sa është Haxhi.

Imami i nderuar është përpjekur vazhdimisht të sqarojë për besimtarët dhe për myslimanët kuptimet e vërteta të këtij rituali të shenjtë ibrahimite dhe muhamedane. Lidhur me këtë aspekt, ai është shprehur:

¹ Surja “Ali Imran”, ajeti 96.

“Është detyrë e të gjithë myslimanëve, që mbajnë mbi supet dhe mbi zemrat e tyre interesimin për këtë fe madhështore islame, që të njihen, të studiojnë dhe të kuptojnë dimensionet e vërteta, mësimet dhe urtësitë e mëdha që fshihen te ky ritual adhurimi kaq i madh dhe kaq i rëndësishëm. Është detyrë e të gjithë myslimanëve të ndershëm, që mbartin mbi supet e tyre hallet e Islamit, që të njihen dhe të kuptojnë dimensionin politik dhe shoqëror të Haxhit, sepse kjo i ndihmon ata ta kryejnë adhurimin në formën dhe në mënyrën e vet më të plotë. Është detyrë e të gjithë atyre, që të kuptojnë se një ritual kaq madhështor sa ky, është diçka më shumë dhe padyshim një angazhim adhurimi që i tejkalon ushtrimet fizike dhe dimensionin turistik të ritualit.”

Lidhur me këto kuptime të mëdha dhe me këto dimensione të jashtëzakonshme, Imam Khomeini (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*), ka folur shpesh dhe gjatë. Synimi i tij ka qenë padyshim sqarimi i myslimanëve, që të përfitojnë sa më shumë prej këtij kongresi të madh.

Për të realizuar këtë qëllim të lartë dhe të shenjtë jemi përpjekur të mbledhim dhe të sjellim për lexuesin tonë disa prej fjalëve dhe qëndrimeve më të rëndësishme të Imam Khomeinit (*Zoti qoftë i kënaqur me të!*), te të cilat shpalosen qartë këto dimensione të rëndësishme, të mëdha të Haxhit. E kemi bërë këtë, sepse shpresojmë shumë që myslimanët, ngado që janë, të përfitojnë sa të munden prej këtij rituali të madh adhurimi, duke shpresuar prej Allahut

të Madhëruar, që të pranojë prej Imamit përpjekjet e tij të mëdha dhe të rezervojë për të hapësirat e begata të afrimitetit.

I lutemi, gjithashtu, Allahut të Plotfuqishëm, të shpërblejë të gjithë ata besimtarë që kanë përfituar prej kuptimeve të Haxhit dhe kanë bërë të gjitha përpjekjet për të ngritur lart emrin e Islamit.

Shoqata kulturore islame “El-Mearef”

KAPITULLI I PARË

DIMENSIONI MORAL I HAXHIT

*“Dimensioni politik dhe shoqëror i Haxhit
nuk mund të realizohet pa u realizuar më
parë dimensionin e tij moral”*

Imam Khomeini (Zoti qoftë i kënaqur me të!)

MEKA, QYTETI I LUFTËS DHE I PËRPPJEKJES SË PROFETIT

*(Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të
nderuar!)*

Njëra prej çështjeve më të rëndësishme, te e cila duhet të përqendrohen haxhilerët e nderuar, është fakti se të gjitha ritualet e kryera gjatë Haxhit në Mekë, janë shfaqje e sinqertë e përpjekjeve të Profetëve të Zotit, për të përhapur fenë e Zotit, si dhe pasqyra e vërtetë, në të cilën shfaqen themelet e luftës për të ngritur në këmbë Islamin. Ajo pasqyrë është reflektimi më i sinqertë i përpjekjeve të

Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). Meka është vendi, ku ka zbritur më shpesh engjëlli Xhebrail, sikurse është vendi më i dashur i Profetëve të Zotit.

Meka është vendi i Shenjtë, e cila pasqyron për kujtesën individuale dhe kolektive të myslimanëve, besnikërinë, vuajtjet dhe fatkeqësitë e mëdha me të cilat është përballur Profeti i Zotit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) për disa vite me radhë, për hatër të përhapjes së Islamit dhe të udhëzimit të njerëzimit. Po të marrim parasysh kushtet dhe rrethanat e vështira në të cilat u dërgua Profeti i nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), do të arrijmë të kuptojmë realitetin e përgjegjësive të mëdha që bien mbi supet tona, për të mbrojtur dhe për të përhapur këtë fe madhështore, këtë amanet të madh të Allahut të Madhëruar. Po të analizojmë me kujdes rrethanat e vështira në të cilat është dërguar Profeti (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), do të vërejmë se sa të mëdha kanë qenë sakrificat e tij për të mbrojtur këtë fe dhe për të çuar më tej Mesazhin e madh Hyjnor. Është një mënyrë e sinqertë për të parë se sa ka vuajtur dhe sa është dashur të mbajë mbi supet e tij të brishta, për hir të fesë së vërtetë dhe triumfit të saj ndaj të keqes dhe të kotës. Myslimanët e parë, me në krye Profetin e nderuar, kanë qëndruar besnikë, të vendosur dhe të palëkundur përballë vështirësive të mëdha. Akuzat, sulmet

e pamëshirshme dhe shpifjet nga më të ulëtat, të adresuara prej armiqve të tij më të mëdhenj, siç ishin Ebu Xhehli dhe Ebu Sufjani, nuk i kanë ndaluar ata për asnjë moment nga rruga e tyre e shenjtë. Ata burra të mëdhenj, të ndershëm, të guximshëm dhe besimtarë nuk u lëkundën për asnjë moment dhe as nuk u përulën, pavarësisht vështirësive që ua diktoi embargoja ekonomike (embargoja e bukës), gjatë kohës kur kanë qenë te “Shuab Ebu Talib” - “vendbanimet Ebu Talib”. Pavarësisht këtyre vështirësive, nuk u tërhoqën dhe as nuk u dorëzuan për asnjë moment. Më pas, të gjithë jemi të informuar se si Profeti i nderuar u përball me shijen e hidhur të emigrimit, për hir të përcjelljes së Mesazhit Hyjnor. Ishin ata burra të mëdhenj që përballuan luftërat e egra dhe shumë të ashpra, të zhvilluara në kushte tërësisht të pabarabarta me armiqtë e tyre dhe të Islamit. Ishin ata njerëz të jashtëzakonshëm, të cilëve, përveç armiqve të tyre të drejtpërdrejtë, u duhej të përballëshin me mijëra hipokritë, që gjallonin kudo në mesin e myslimanëve. Ishin këta njerëz të pastër dhe të sinqertë, që, me ndihmën e Allahut të Madhëruar dhe me ndihmën e vullneteve të tyre të hekurta, kanë punuar fort për të udhëzuar njerëzit. Gurët, dheu, pemët, shkretëtirat, malet, lagjet dhe tregjet e Mekës dëshmojnë, gjithashtu, përpjekjet e mëdha të Profetit, për të përhapur udhëzimin e Krijuesit të Gjithësisë.

Po të ngremë perdet e misterit dhe të njihemi më nga afër me ta dhe me personalitetet e tyre madhështore, te

të cilat janë trupëzuar kuptimet e ajetit kur'anor: "**Kapupas rrugës së drejtë ashtu siç je udhëzuar** (prej Allahut).", po të njihemi nga afër me këto kuptime të mëdha Hyjnore, ne, vizitorët, haxhilerët e Shtëpisë së Allahut, do të kuptojmë se sa shumë është përpjekur dhe është munduar i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) për udhëzimin e njerëzve në Islam dhe sa shumë ka vuajtur, që ne te jemi prej fatlumëve, që do të fitojnë Xhenetin e Allahut.

Kjo është një mënyrë shumë efikase, për të parë dhe për të kuptuar se sa të rënda kanë qenë përgjegjësitë e pasuesve dhe të ndihmuesve të tij. Për një gjë duhet të jemi të bindur dhe shumë të sigurt, vuajtjet, dhimbjet dhe vështirësitë me të cilat janë përballur Imamët tanë të ndershëm, janë shumë herë më të mëdha se sa vështirësitë e ndryshme, me të cilat mund të jemi përballur ne.

QABEJA, QENDRA E DHËNIES SË BESËS ALLAHUT DHE E LARGIMIT NDAJ FEMOHUESVE

Qabeja e nderuar dhe e shenjtë, është simbolika e vendit të vetëm, ku shkatërrohen dhe thërrmohen të gjitha format e idhujve, të idhujtarisë dhe të politeizmit. Thirrja e Njehsimit (e Teuhidit) është ngritur në atë vend të shenjtë prej Profetit Ibrahim, në fillim të historisë. Atë do ta ngrejë lart, në të ardhmen edhe biri i tij i dashur, i ndershmi Imam Mehdiu, në fund të kohës dhe të historisë dhe i tillë do të mbesë deri në fund. Allahu i Madhëruar na tregon në Kur'anin Famëlartë se çfarë i ka thënë të dashurit të tij, Ibrahimit:

“وَأَذِّنْ فِي النَّاسِ بِالْحَجِّ يَأْتُوكَ رِجَالًا وَعَلَى كُلِّ ضَامِرٍ يَأْتِينَ مِنْ كُلِّ فَجٍّ عَمِيقٍ”

“Thirri njerëzit për haxhillëk: ata do të vijnë në këmbë dhe me deve prej të gjitha viseve të largëta.”²

Allahu i Madhëruar thotë gjithashtu:

“طَهَّرْنَا بَيْتِي لِلطَّائِفِينَ وَالْعَاكِفِينَ وَالرُّكَّعِ السُّجُودِ”

“Pastrojeni Shtëpinë Time (Qabenë) për ata që e vizitojnë, që rrinë aty për adhurim dhe që falen duke u përkulur dhe duke u përlur.”³

² Surja “El Haxh”, ajeti 27.

³ Surja “El Bekare”, ajeti 125.

Kjo do të thotë pastrim prej të gjitha formave të idhujtarisë, me në krye politeizmin. Kjo saktësohet qartësisht në krye të ajetit kur'anor, ku Allahu i Madhëruar thotë:

“وَأَذَانٌ مِّنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ إِلَى النَّاسِ يَوْمَ الْحَجِّ الْأَكْبَرِ أَنَّ اللَّهَ بَرِيءٌ مِّنَ الْمُشْرِكِينَ وَرَسُولُهُ”

“Ja shpallja e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij, drejtuar njerëzve në ditën e Haxhit të madh: ‘Allahu dhe i Dërguari i Tij shkëpusin çdo detyrim ndaj idhujtarëve.’”⁴

⁴ Surja “Et Teube”, ajeti 3.

XHAMIA E SHENJTË (EL-MESXHIDUL-HARAM) ËSHTË SHTËPIA E TË GJITHËVE

Shtëpia e Allahut të Madhëruar është Shtëpia e parë që është ndërtuar për njerëzimin dhe, për këtë arsye, ajo i përket të gjithë anëtarëve të njerëzimit. Atje, të gjithë janë të barabartë me njëri-tjetrin. Kështu, beduinët dhe banorët e shkretëtirave, të cilët lëvizin vazhdimisht bashkë me shtëpitë e tyre mbi supe, janë të barabartë me ata që jetojnë pranë Qabesë, me banorët e qyteteve dhe me përfaqësuesit më të lartë të shteteve të ndryshme të botës. Kjo shtëpi është ndërtuar për të gjithë njerëzit. Ajo Shtëpi e Shenjtë është themeluar dhe është ndërtuar në funksion të zhvillimit njerëzor dhe të përfitimeve shumëdimensionale të tyre.

XHAMIA E SHENJTË (EL-MESXHIDUL-HARAM) NUK ËSHTË VETËM PËR ADHURIM

Nuk ka dyshim se, në kohën e Profetit të nderuar (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), xhamitë kanë qenë qendra të rëndësishme ushtarake, sociale dhe politike. Njëkohësisht, xhamia e Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) nuk ka pasur vetëm funksion adhurimi, si për shembull të ketë rol të kufizuar, me namazin apo me agjërimin, etj. E vërteta është se roli kryesor dhe më i rëndësishëm i xhamisë së Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) ka qenë politik. Ajo ka shërbyer për të përgatitur burrat për luftë dhe për të mobilizuar shtresat e ndryshme të popullatës në kohë përballesh dhe betejash të mëdha, sa herë që ka qenë e nevojshme për ta bërë një gjë të tillë.

RËNDËSIA E DIMENSIONIT MORAL TË HAXHIT

Nuk ka dyshim se pozitat morale të Haxhit përfaqësojnë kapitalin kryesor të Jetës së Përtejme dhe të përjetësisë. Këto pozita janë ato që e afrojnë njeriun te horizontet e Njehsimit dhe të pastërtisë së shpirtit. E vërteta e madhe qëndron në faktin se do të dalim të falimentuar prej Haxhit, për sa kohë nuk do t'i kryejmë me përpikëri dhe me amanet të gjitha dispozitat e adhurimit të Haxhit. Është detyrë e të gjithë haxhinjve të nderuar, që i vizitojnë vendet e shenjta, që të mësojnë sa të munden kryerjen me përpikëri të ritualeve të Haxhit. Kjo është një detyrë po aq e rëndësishme, që bie mbi supet dhe mbi shpatullat e dijetarëve të nderuar që i shoqërojnë besimtarët gjatë kryerjes së Haxhit. Është detyrë e të gjithë njerëzve të devotshëm prej dijetarëve dhe eulijave, që të bëjnë kujdes dhe të tërheqin vëmendjen e çdokujt që mund të shkelë ndonjë dispozitë apo ta lërë atë të mangët dhe të paplotësuar. *(Mos e thëntë Zoti!)*

Nuk ka dyshim se dimensionin politik dhe shoqëror i Haxhit nuk mund të realizohet kurrsesi në rast se krijojmë boshllëqe dhe mangësi në dimensionin adhurues të tij, sepse realizimi i pasojës pa shkakun është i pamundur. Asgjë nuk mund të realizohet pa u realizuar më parë

plotësimi i thirrjes *“lebejke lllahumme” - “t’u përgjigjëm o Allah”*, si një thirrje e dalë prej thellësive të shpirtit dhe të zemrës së njeriut. Këto thirrje, drejtuar Allahut të Madhëruar, nga thellësitë e sinqeritetit, kanë për qëllim ta ftojnë qenien të hapësirat e shenjta të afrimitetit. Kjo është mënyra më e mirë, nëpërmjet të cilës besimtari vetëdijesohet se është duke iu drejtuar Krijuesit të Gjithësisë me të gjithë fuqinë dhe sinqeritetin e qenies së tij. Kjo është mënyra më e mirë për të çliruar tërësinë e qenies prej të gjitha formave të idhujtarisë dhe të politeizmit. Kjo thirrje e madhe është mënyra më e sinqertë dhe më e sigurt për ta transferuar qenien dhe për të emigruar bashkë me të për të hapësirat e afrimitetit, pasi kjo qenie është burimi i të gjitha formave të idhujtarisë dhe të politeizmit.

Shpresa është e madhe të Allahu i Madhëruar, që shpërblimi i Zotit të mbështjellë dhe të mbulojë të gjithë ata që e kanë nisur rrugëtimin dhe përpjekjet e tyre, pavarësisht nëse kanë mundur ta konkretizojnë atë apo jo. Pavarësisht nëse u ka mjaftuar jeta për ta realizuar qëllimin e tyre apo jo.

E FSHEHTA E “TELBIJES” - “DËSHMISË”, QË BESIMTARËT PËRSËRITIN GJATË HAXHIT

Të gjitha këto rituale dhe lëvizje adhurimi, që në raste të caktuara mund të tingëllojnë dhe mund të duken si të çuditshme, janë përfaqësuese të sinqerta të një tërësie të madhe mrekullish dhe rrugësh, që të shpien për te Krijuesi i Gjithësisë, për shpjegimin dhe komentimin e të cilave do të duhej një trajtesë e zgjeruar. Duhet një punë kërkimore më vete, për të përgatitur një trajtesë të plotë për të gjitha ritualet e Haxhit, që nga “*et-telbijeh*” dhe “*ihrami*” e deri në fund. Për këtë arsye, preferoj të ndalem shkurtimisht te disa kuptime, të lidhura me “*et-telbijen*”. E vërteta e përsëritjes vazhdimisht të kësaj thirrjeje prej të gjithë atyre që kryejnë Haxhin (lebejke-llahume lebejk- t’u përgjigjëm o Allah, t’u përgjigjëm) është e lidhur me përgjigjen e plotë dhe demonstrative të krijesës dhe të qenies, drejtuar Allahut të Madhëruar, Krijuesit të saj. Kjo është forma më e sinqertë e nënshtrimit të qenies së besimtarit dhe e përgjigjes së tij ndaj thirrjes së Krijuesit të shpirtit, të qenies dhe të ekzistencës. E gjithë çështja është shprehje ulëritëse e pranisë se krijesës hapësirave të afrimitetit të Krijuesit të saj dhe përballjes së saj me bukurinë e pafundme të Tij. Është e qartë se në hapësira dhe në momente kaq të shenjta sa këto, besimtari e tejkalon qenien, i tejkalon kufijtë e

vetvetes, duke mohuar kështu dhe duke u çliruar tërësisht prej formave të ndryshme të idhujtarisë dhe të politeizmit, të cilat mund ta komprometojnë besimin, edhe kur e pushtojnë qenien, edhe kur gjenden në forma mikroskopike. Këto janë ndikimet e mëdha të përgjigjes së qenies ndaj thirrjes së Allahut të Madhëruar, Krijuesit të Gjithësisë. Kjo është mënyra më e mirë dhe forma më e sigurtë, e njohur prej njerëzve të dashur të Allahut dhe eulijave të Tij, për të deklaruar çlirimin absolut prej formave të ndryshme të idhujtarisë. Kjo është mënyra më e mirë për të realizuar këto kuptime të mëdha, paçka se te këto thirrje të mëdha, të ndjera dhe të sigurta përfshihet mohimi i të gjitha formave të politeizmit dhe të idhujtarisë. Këtë e gjejmë të përmendur, gjithashtu, te ajo pjesë e thirrjes, në të cilën thuhet “të gjitha falënderimet të takojnë Ty dhe Ti je burimi i të gjitha mirësive”.

Falënderimi, në rastin e sipërpërmendur, është i lidhur me Allahun e Madhëruar. E njëjta gjë ndodh me deklarin e burimit të mirësisë absolute. Sipas dijetarëve dhe njohësve të mëdhenj (arifinëve), kjo është shprehja më e plotë dhe më e sigurtë e Njehsimit. Kjo do të thotë se burimi absolut i të gjitha mirësive në ekzistencë është Allahu i Madhëruar, duke mohuar kështu çdo mundësi dhe çdo burim tjetër të mundshëm për mirësinë. Ky gjykim dhe këto kuptime janë të vlefshme dhe të përshtatshme për të gjitha format dhe llojet e tjera të adhurimeve gjatë kryerjes së ritualit të Haxhit. Këto kuptime janë të lidhura

me të gjitha llojet e lëvizjeve adhuruese, që kryhen në ato ditë të shenjta dhe në ato vende të shenjta.

E kundërta e këtyre kuptimeve do të thotë, pa diskutim, përjetime të formave të fshehta të idhujtarisë, ashtu siç ndodh me të gjithë pjesën tjetër të njerëzve, të cilët Allahu i Madhëruar i ka sprovuar me verbëri të syve dhe, me atë ç'ka është më e rrezikshme, me verbërinë e zemrës.

Në rast se besimtari do të nënvlerësojë dhe do të groposë në varrin e harresës ngarkesat e rëndësishme kuptimore të këtyre ritualeve të mëdha, askush të mos dyshojë dhe të mos përjetojë iluzion, se do të mund të shpëtojë dhe do të mund të çlirohet plotësisht prej ngacmimeve dhe cytjeve të shejtanit të mallkuar. Një tjetër rregull, shumë i rëndësishëm, duhet të ngulitet thellë mendjeve dhe qenieve të besimtarëve, se një qenie, një shpirt dhe një zemër që nuk ka arritur të krijojë pavarësinë e plotë dhe të çlirohet prej kërkesave dhe nevojave të fuqishme të egos dhe të epshit, nuk do të mund të luftojë dhe të përpiqet për hir të Allahut të Madhëruar. Një qenie e kapur dhe e mbajtur peng prej fuqisë së epshit dhe kënaqësive të tjera të mishta të trupit, e ka të pamundur të sakrifikojë dhe të luftojë deri në vetëmohim, në shërbim të ngritjes së fesë së Allahut dhe lartësimit të emrit të Tij.

Miqtë e mi të shtrenjtë! Secili le të kthehet te vetja e tij dhe t'i bëjë asaj një analizë të hollësishme, për të identifikuar saktësisht gjendjen në të cilën ndodhet. Është

detyrë e të gjithëve ne që të meditojmë thellë rreth gjendjes së atyre që e kanë ndihmuar realizimin dhe triumfin me sukses të Revolucionit Islamik të Iranit dhe të atyre që kanë sakrifikuar gjithçka të shtrenjtë për të ndihmuar fenë e Zotit. Në këto ditë të shenjta, disa prej atyre burrave të mëdhenj, që e kanë ndihmuar Islamin dhe Revolucionin Islamik, janë dëshmitarë të gjallë në mesin tuaj dhe kryejnë bashkë me ju ritualet e shenjta të Haxhit. Është detyrë e të gjithëve ne që të marrim mësim prej këtyre transformimeve të mëdha, që kanë ndodhur thellë qenieve tuaja. Të gjithë bashkë jemi të ftuar të meditojmë rreth këtyre transformimeve të mëdha të qenieve, që sakrifikuan gjithçka të shtrenjtë, deri në vetëflim, në funksion të suksesit të Islamit dhe të realizimit të Revolucionit Islamik. Të gjithë besimtarët e kësaj bote duhet të jenë të vetëdijshëm se, në rast se nuk ndodhin te qeniet e tyre këto transformime të mëdha, atëherë ato qenie do të vazhdojnë të gjenden nën trysinë, presionin dhe diktatin e cytjeve të shejtanit të mallkuar. Të gjithë duhet të jenë të bindur se një qenie e kapur peng dhe e mbajtur si e tillë prej cytjeve të shejtanit dhe të egos, e ka të pamundur të rezervojë energjitë e saj, apo të vetëflijohet dhe të sakrifikojë për të ndihmuar Islamin, myslimanët dhe të gjithë të vuajturit dhe të shtypurit e botës.

ÇLIROHUNI PREJ GJITHKUJT TJETËR, PËRPOS ALLAHUT TË MADHËRUAR

Gjatë kohës së kryerjes së ritualeve të shenjta të Haxhit, në vendet e shenjta ku kryhet ai, të gjithë besimtarët janë të ftuar të tregojnë kujdes të veçantë dhe vigjilencë të madhe rreth sjelljeve të tyre të hapësirat e shenjta të afrimitetit dhe të hapësirat fizike të atyre vendeve të shenjta.

Të dashur dhe të shtrenjtë haxhinj!

Është detyra juaj, që të çlironi zemrat tuaja prej lidhjeve me gjithçka tjetër, përpos Allahut të Madhëruar, sikurse jeni të ftuar t'i zbrazni dhe t'i boshatisni zemrat tuaja prej gjithçkaje tjetër, përveç dashurisë për Allahun e Madhëruar. Ndriçojini zemrat tuaja me dritën Hyjnore të besimit dhe të adhurimeve. Kjo është e vetmja mënyrë që adhurimet dhe ritualet tuaja gjatë kryerjes së Haxhit të jenë të orientuara saktë drejt Allahut të Madhëruar dhe drejt fitimit të kënaqësisë së Tij. Kjo është e vetmja mënyrë për të përmbushur të plotë të gjitha kuptimet e pelegrinazhit të Ibrahimit, për të mbërritur më pas te ai i Muhamedit. Kjo është mënyra e vetme dhe më e mirë për të përfituar shpërblimin e Zotit në këtë botë dhe mirësitë e Tij të mëdha pas vdekjes. Kjo është mënyra më e mirë për t'i ngarkuar qeniet me pozitivitetin dhe me shpërblimin e

madh të Allahut, për t'u kthyer më pas të sigurt dhe të ngarkuar plot me begati për te vendet tuaja. E ku ka më bukur se të kthehesh prej atyre vendeve të shenjta dhe të sjellësh për familjarët, për miqtë, për vëllezërit dhurata të ndryshme, që e simbolizojnë hyjnoren dhe përjetësinë, prej atyre vendeve të shenjta, larg dhuratave e simbolikave që janë të lidhura me materialen e kësaj bote të rreme dhe të përkohshme?!

Kjo është e vetmja mënyrë për t'u kthyer te vendet tuaja me duar të mbushura plot e përplot me mirësi, humanizëm, të cilat kanë qenë pa diskutim boshti kryesor i thirrjes së të gjithë Profetëve të Allahut, që prej të shtrenjtit të tij, Profetit Ibrahim (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) e deri te vula e Profetëve dhe më i nderuari i tyre, Profeti Muhamed (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). Kjo është e vetmja mënyrë për t'iu bashkangjitur miqve dhe shokëve tuaj të pasionuar dhe të dashuruar me martirizimin në rrugën e Allahut të Madhëruar.

Të gjitha këto vlera të mëdha, të përfituara prej kryerjes së Haxhit, janë padyshim siguria më e madhe, që e ndihmon qenien të çlirohet prej të gjitha llojeve dhe formave të sofistikuara të cytjeve të egos, të epshit dhe të djallit të mallkuar. Kjo është e vetmja mënyrë për të çliruar zemrat e besimtarëve dhe të myslimanëve prej formave të ndërlikuara të varësisë ndaj Lindjes dhe Perëndimit për t'i shndërruar ato ashtu siç i deshi Allahu i Madhëruar, si një pemë e bekuar ulliri, as lindore e as perëndimore.

HAXHI ËSHTË KËRKESË, LUTJE DHE NEVOJË DREJTUAR ALLAHUT TË MADHËRUAR

Të gjithë myslimanët duhet ta kenë të qartë se udhëtimi për në Haxh nuk është një udhëtim për qëllime tregtie. Ai nuk është, nuk duhet dhe nuk mund të jetë një udhëtim përtej të cilit fshihen qëllime të vogla përfitimesh, të lidhura me këtë botë të vogël. E vërteta e këtij udhëtimi të madh konsiston në faktin se ai është udhëtimi më i rëndësishëm i qenies dhe i fizikut në drejtim të Allahut të Madhëruar. Kur vendosni të shkoni për të kryer Haxhin, duhet të jeni të vetëdijshëm se jeni duke shkuar te Shtëpia e Shenjtë e Allahut të Madhëruar. Është detyrë e çdo besimtari dhe besimtareje që të plotësojë me përpikëri të gjitha detyrat, në formën më të mirë dhe më të përkryer, të këtij detyrimi të rëndësishëm hyjnor.

I gjithë udhëtimi juaj, i cili fillon me përgatitjet e udhëtimit, është një rrugëtim i bekuar në drejtim të Allahut të Madhëruar. Ky është udhëtimi më i madh dhe më i rëndësishëm i jetës në drejtim të Allahut të Madhëruar, ashtu siç kanë udhëtuar e rrugëtuar edhe Profetët e Allahut përgjatë historisë së njerëzimit. Njëlloj si Profetët, që e kanë pasur të gjithë kohën e tyre, të gjitha lëvizjet dhe të gjithë frymëmarrjen e tyre në funksion të rrugëtimit për te Allahu i Madhëruar, ashtu është dhe ashtu duhet të jetë

edhe ky udhëtim i shenjtë për të gjithë besimtarët që vizitojnë Shtëpinë e Shenjtë të Allahut të Madhëruar.

Ashtu si Profetët e nderuar, edhe besimtarët, gjatë këtij rrugëtimi të shenjtë, të gjitha lëvizjet dhe frymëmarrjet e tyre duhet t'i venë në funksion të plotësimit dhe të realizimit të programit të rrugëtimit për te Allahu i Madhëruar. E vërteta e udhëtimit të Haxhit është pikërisht kjo. Të gjithë ju besimtarë dhe besimtare, që jeni nisur për në tokat e shenjta, duhet të jeni të vetëdijshëm se ky rrugëtim është transferim i drejtpërdrejtë dhe pa asnjë perde a pengesë për te Allahu i Madhëruar. Që në momentin kur mbërrini në Mikat dhe nisni thirrjen tuaj, që shpërthen nga thellësitë e sinqeritetit dhe të shpirtit: "T'u përgjigjem o Allah, t'u përgjigjem", është njëlloj sikur t'i drejtoheni Krijuesit tuaj të Madhërishëm dhe t'i thoni: "O Allah, Ti e bërë ftesën dhe thirrjen dhe ne iu përgjigjem asaj."

I lutem Allahut të Madhëruar, që gjatë kryerjes së Haxhit, t'ju mbrojë prej kryerjes së ndonjë vepre, që shkakton hidhërimin dhe pakënaqësinë e Allahut. I lutem Allahut të Madhëruar, që t'ju mbrojë në këtë udhëtim të shenjtë prej qëllimeve të ulëta të kësaj bote, si për shembull, të kryhet vetëm për qëllime përfitimi a tregtie.

Të nderuar vëllezër dijetarë!

Të nderuar zotërinj!

Të nderuar kryetarë dhe anëtarë të karvanëve, që kanë nisur rrugëtimin e shenjtë për te vendet e shenjta!

Të nderuar vëllezër dhe motra besimtare, që jeni nisur për të kryer Haxhin, jeni të lutur të hiqni dhe të pastroni qëllimet tuaja, duke e zhveshur këtë udhëtim të shenjtë prej çdo lloj përfitimi të kësaj bote të ulët dhe të gënjeshtërt. Ky është rrugëtimi më i shenjtë për te Allahu i Madhëruar, ndaj jeni të lutur të mos e komprometoni atë apo ta bëni pis, me të tjera interesa, të lidhura më përfitimet e kësaj bote.

TREGOHUNI TË SINQERTË NË HAXH

Është e ditur dhe i mirënjohur për të gjithë besimtarët dhe besimtare fakti se punët e mira dhe të gjitha adhurimet duhet të kryhen për hatër të Allahut të Madhëruar. Pra, sinqeriteti në adhurim është prej kushteve themelore të pranimit të Allahu i Madhëruar. Në rast se dikush, besimtar apo besimtare, e kryen një punë apo një adhurim në mënyrë që të duket përpara njerëzve dhe të fitojë simpatinë e tyre, ajo punë është e thërrmuar dhe e shkatërruar që në themel. *(Mos e dhëntë Zoti!)* Kjo gjë është plotësisht e refuzuar prej Allahut të Madhëruar.

Është detyrë e të gjithë haxhinjve të nderuar, që të mos i shoqërojnë Allahut shok në adhurim dhe ta kryejnë këtë ritual të shenjtë vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut. Ritualet morale të Haxhit janë të shumta dhe është shumë e rëndësishme që besimtari ta kuptojë se për ku është nisur dhe për ku është drejtuar. Është shumë e rëndësishme, që ai të dijë në Shtëpinë e kujt ka shkuar dhe ftesës së kujt i është përgjigjur.

Secili prej haxhinjve duhet ta dijë mirë, se në cilën shtëpi është mik e i ftuar dhe cilat janë normat e moralit dhe të edukatës që duhet të kihet parasysh në një vend të shenjtë si ai.

Është e nevojshme të bëhet i ditur edhe një tjetër fakt shumë i rëndësishëm dhe që duhet të jetë në vëmendjen e të gjithë atyre që nisen për të vizituar vendet e shenjta dhe për të kryer Haxhin. Të gjithë besimtarët dhe besimtares duhet ta dinë se nuk ka vend në zemrën e njeriut, për egon, për epshet, për unin dhe për dashurinë e Allahut të Madhëruar. Prania e këtyre papastërtive në zemrën e njeriut dhe në qenien e tij janë në kundërshti të plotë me rrugëtimin e tij për te Allahu i Madhëruar dhe me thelbin e këtij udhëtimi të shenjtë. Për këtë arsye, ato bëhen shkak për dështimin e plotë të arritjes së qëllimeve prej këtij adhurimi të madh. Në rast se njeriu do të arrijë të çlirojë qenien prej këtyre papastërtive që e komprometojnë kryerjen e ritualit dhe në rast se arrihen këto qëllime të mëdha prej kryerjes së ritualit, në rast se këto adhurime shkojnë në sinkron të plotë me përgjigjen e thirrjes së Allahut të Madhëruar, vjen një moment kur njeriu çlirohet përfundimisht prej energjive të liga dhe bëhet i gatshëm për të fituar të gjitha betejat politike, shoqërore, ekonomike, madje dhe ushtarake, me të cilat mund të përballlet gjatë jetës së tij. Njerëz të këtyre përmasave shpirtërore janë të pamposhtur.

O Allah! Të lutemi Ty që të na bësh ne prej atyre njerëzve që përfitojnë dhe bëhen pjesë e këtyre kuptimeve shpirtërore të mëdha, që vijnë si rezultat i realizimit me sukses, me përkushtim dhe me devocion të ritualit të shenjtë të Haxhit.

Është detyrë e të gjithë besimtarëve, që të mos i përziejnë adhurimet e tyre në ato ditë të shenjta të Haxhit me llojet e ndryshme të gjynaheve. Në ato ditë të shenjta, të gjitha lëvizjet e njeriut duhet të jenë islame dhe adhuruese. Le të jenë të gjitha format demonstrative të adhurimeve të tyre të zhveshura prej mëkateve dhe gjynaheve të ndryshme.

Le të jenë sloganet e tyre, në ato ditë të shenjta, plot e përplot me ngarkesa adhurimi, si dhe të zhveshura e të çliruara prej formave dhe llojeve të ndryshme të mëkateve. Le të jenë adhurimet e tyre ashtu siç ka dashur dhe siç ka kërkuar Allahu i Madhëruar, që të jenë. Nuk është e pranueshme që secili haxhi të bëjë çfarë të dojë, apo të thotë çfarë të dojë, apo të përdorë fjalë të këqija dhe të pahijshme për shenjtërinë e vendit dhe të pozitës. Të gjitha këto vepra të papëlqyera duhet të shmangen me të gjitha format dhe mënyrat. Kjo fillon me pastrimin e qëllimit (të nijetit) dhe përfundon me marrjen e masave përpara nisjes, duke vendosur, duke hartuar një program të mirëfilltë për të gjitha lëvizjet e trupit, të mendjes dhe të shpirtit, gjatë gjithë kohës së qëndrimit në vendet e shenjta.

E FSHEHTA E RITUALEVE TË HAXHIT

Në të vërtetë, tauafi (rrotullimi) rreth Qabesë së nderuar është shprehje e fuqishme dhe e sinqertë e qenies së besimtarit se ai nuk adhuron askënd tjetër përveç Allahut të Madhëruar dhe nuk mund të ndodhë, që të rrotullohet rreth diçkaje apo dikujt tjetër përveç Allahut të Madhëruar.

Gjithashtu, përsa i përket gurëzimit, kemi të bëjmë me një ritual, që, në thelbin e tij, simbolizon demonstrimin e qenies dhe gatishmërinë e saj për të poshtëruar e për të gurëzuar format e ndryshme të shfaqjes së djallit thellësive të qenies së njeriut. Ajo është simbolika e gurëzimit të gjithë djajve, xhindë dhe njerëz, që e kanë mbipopulluar botën dhe janë të pranishëm ngado. Ditën kur do të hidhni ato gurë, pastroni qëllimet tuaja dhe vendosni të gurëzoni dhe të nxirrni prej vendeve tuaja format e ndryshme të armiqve dhe të pushtimit. Ditën që do të hidhni ato gurë, jepini besën Allahut të Madhëruar, se do të largoni prej vendeve të myslimanëve të gjithë ata që përpiqen të grabisin padrejtësisht pasuritë e tyre. Sot, e gjithë bota islame mbahet peng në duart e amerikanëve. Është detyra e të gjithë besimtarëve që prej atyre vendeve të shenjta t'u drejtohen të gjithë myslimanëve të botës në kontinentet e ndryshme ku ndodhen, me ftesën, që të mos i nënshtrohen

asnjë fuqie tjetër në botë, përveç Allahut të Madhëruar. Është detyrë e tyre të ftojnë të gjithë myslimanët e globit, që të mos jenë skllëvër të asnjë fuqie tjetër, përveç fuqisë së Allahut të Madhëruar.

Sa herë që të thërrisni “Lebejk, lebejk!” përpiquni t’u thoni “Jo!” të gjitha llojeve të putave, që mund të pushtojnë qeniet apo imagjinatat tuaja. Ky është momenti i përshtatshëm për të ulëritur në fytyrën e të gjitha putave, të mëdha dhe të vogla dhe për t’u thënë atyre, “Jo!”. Ky është momenti i përshtatshëm për t’i thënë, me të gjithë fuqinë e qenies, “Jo!”, të gjitha formave të diktaturave, të pushtimit apo të tiranisë.

Këto janë momentet më të përshtatshme për t’i bërë këto thirrje të mëdha, pasi, gjatë tauafit rreth Qabesë, myslimani është në momente të shenjta, në të cilat ai bëhet pjesë e dashurisë së madhe të Allahut. Në ato momente madhështore, jeni të lutur të zbrazni zemrat tuaja prej gjithkujt tjetër, përveç Allahut të Madhëruar dhe t’i çlironi ato prej çdo frike tjetër, përveç frikës ndaj Allahut të Madhëruar. Sapo të mbështilleni prej dashurisë Hyjnore të Krijuesit, shpallni dhe deklaroni, me të gjithë fuqinë e qenies dhe të shpirtit, largimin e plotë dhe “divorcin përfundimtar” prej të gjitha formave të putave, prej të gjitha formave të diktaturave dhe të tiranisë, prej shërbëtorëve të tyre të ulët dhe të pavlerë, si dhe prej të gjitha fuqive të errëta, që përpiqen të sundojnë botën.

Është Allahu i Madhëruar Ai që i ka zhveshur të gjitha këto forma të tiranisë, si dhe të gjithë shërbëtorët e tyre, kudo që janë, prej mëshirës dhe dashurisë së Tij të madhe. Përveç Allahut të Madhëruar, të gjithë njerëzit e lirë të botës e kanë shpallur largimin dhe ndarjen e tyre përfundimtare me këto forca të errëta, që kanë për qëllim të shkatërrojnë njerëzimin.

Kur të prekni Gurin e Zi, duhet ta konsideroni veten sikur jeni duke i dhënë besën dhe duke i premtuar Allahut të Madhëruar, se do të jeni gjatë gjithë jetës suaj dhe me të gjithë energjitë tuaja, armiqtë më të mëdhenj të armiqve të Allahut. Duhet t'i premtoni Krijuesit të botëve dhe t'i jepni besën Atij, se do të jeni armiqtë e të gjithë atyre që luftojnë dhe pengojnë në rrugën e tyre të dashurit e Allahut, të afërmit e Tij prej krijesave dhe eulijatë e Tij në tokë. Kur ta prekni Gurin e Zi, jepini besën Allahut të Madhëruar se do t'u shpallni luftë të gjithë atyre që u shpallin luftë Profetëve të Zotit në të gjitha kushtet, në të gjitha vendet ku do të gjendeni dhe në të gjitha rrethanat e jetës suaj. Kurrë mos i ulni kokat tuaja prej humbjes dhe dëshpërimit. Kurrë mos i ulni kokat tuaja prej frikës nga armiqtë e Allahut dhe të Profetëve të Tij. Largojeni frikën prej zemrave tuaja dhe mos lini vend për dëshpërim. Duhet të jeni të bindur, se të gjithë armiqtë e Allahut, me në krye komandantin e djajve të botës, janë të trembur dhe ju kanë frikë, pavarësisht se në dukje kanë një epërsi, qoftë në

armatim, qoftë në veprime të shumta, të kryera ndaj anëtarëve të njerëzimit.

Kur të ecni ndërmjet Safasë dhe Mervasë, duhet të mendoni sikur jeni duke rrugëtuar për te Allahu i Madhëruar. Imagjinoni dhe mendoni sikur jeni duke rrugëtuar në drejtim të dashurisë suaj të madhe, të asaj dashurie që, sapo ta gjeni dhe sapo ta prekni, harroni të gjitha vështirësitë dhe hallet e kësaj bote. Të asaj dashurie që, kur e mbush zemrën dhe shpirtin, largon të gjitha llojet e dëshpërimit dhe të dyshimit. Të asaj dashurie që largon të gjitha dyshimet e mbjella prej djallit të mallkuar në brendësi të atyre zemrave. Të asaj dashurie që e ka fuqinë ta shkëpusë qenien prej lidhjeve të saj të mishta me tokësoren, me dynjanë, me materialen e kësaj bote kalimtare. Të asaj dashurie që çliron energji të mëdha, për të siguruar lirinë, aq të nevojshme për një qenie dinjitoze dhe të pavarur. Të asaj dashurie që e ka mundësinë dhe fuqinë të thyejë dhe të shkatërrojë të gjitha format e kapjes, të robërisë dhe të skllavërisë ndaj shejtanit të mallkuar, që mban sot peng një pjesë të madhe të robve të Allahut.

Nisuni, të bekuar, drejt vendeve të shenjta dhe drejt Malit të Arafatit, me besimin e madh të shpërblimi i Allahut të Madhëruar. Përqendroni mendimet tuaja më pozitive dhe ndjenjat tuaja më të bardha dhe vendosini ato në funksion të realizimit me sukses të një adhurimi madhështor sa ky. Përpiquni të jeni të gatshëm në çdo moment, për të pranuar dhe për të besuar me të gjithë

fuqinë e shpirtit dhe të zemrës, se fitorja është në anën tuaj dhe se Allahu i Madhëruar do ta kthejë botën në duart e të shtypurve dhe të mjeruarve të njerëzimit.

Me qetësinë e mendjes dhe të zemrës, meditoni thellësisht te ajetet e zbritura prej Allahut të Madhëruar. Është detyrë e të gjithë besimtarëve, që, në këto momente të shenjta, të lidhin besën me Allahun dhe t'i japin Atij premtimin, se do të bëjnë të pamundurën për të çliruar popujt e shtypur të njerëzimit prej kthetrave të pamëshirshme të zullumqarëve, të diktaturave të ndryshme dhe të tiranive. Jepini besën Allahut se do ta çlironi njerëzimin prej padrejtësisë së fuqive të errëta botërore që e sundojnë botën dhe njerëzimin sot në mënyrë të pamëshirshme. Në ato momente të shenjta, të mbushura me mirësi, mëshirë dhe begati, është detyrë e çdo besimtari dhe besimtareje, që t'i lutet Allahut dhe t'i përgjërohet Atij, që t'i furnizojë me mundësitë dhe me shkaqet e nevojshme, për të realizuar shpëtimin dhe fitoren në këtë botë dhe në Botën Tjetër.

Kur të drejtoheni për në Mina, lutjuni Allahut të Madhëruar, që për hir të sakrificës që simbolizon ai vend, t'ju plotësojë ëndrrat dhe dëshirat tuaja të bardha.

Të nderuar besimtarë! Nëse arrini të shkëputeni, bashkë me qeniet tuaja, prej këtyre cytjeve të shejtanit, prej energjive negative dhe prej kërkesave të ulëta të egos, nuk ka dyshim se do të arrini majat dhe do të mund t'i tejkaloni të gjitha problematikat, me të cilat mund të përballeni në

jetën tuaj dhe mund të fitoni dashurinë e madhe dhe kënaqësinë e Allahut të Madhëruar.

Ky është momenti më i përshtatshëm për të gjuajtur shejtanin e mallkuar dhe për ta gurëzuar atë. Ky është momenti i përshtatshëm për ta nxjerrë atë prej qenieve tuaja dhe për ta përzënë atë njëherë e përgjithmonë prej çdo skute të qenies. Goditeni shejtanin e mallkuar me fuqinë e qenies dhe të shpirtit, sipas urdhrave të Allahut të Madhëruar. Kjo është mënyra e vetme për të zhdukur prej jush të keqen e tyre dhe të shërbëtorëve të tyre.

MOS E GURËZONI VETEN TUAJ!

Të gjithë besimtarët duhet ta dinë se ky udhëtim i shenjtë dhe hyjnor, në të cilin shkoni për të gurëzuar djallin e mallkuar, mund t'ju kthehet me ndikimin e kundërt, në rast se jeni një ditë prej ditësh prej ushtarëve, ndjekësve dhe pasuesve të shejtanit të mallkuar. (*Mos e dhëntë Zoti!*)

Në këtë rast, duhet ta kuptoni qartë, se jeni duke gurëzuar veten tuaj. Kur të shkoni për të gurëzuar shejtanin e mallkuar, duhet të përgatisni shpirtat dhe qeniet tuaja për të qenë të mbuluar prej mëshirës së Mëshiruesit. Kjo është e vetmja mënyrë, që gurëzimi dhe goditja juaj të jetë goditja e pasuesve të Mëshiruesit. Kjo është e vetmja mënyrë, që gjuajtja juaj të konsiderohet si gjuajtja e pasuesve dhe e ushtarëve të Mëshiruesit ndaj shejtanit të mallkuar.

Shumë të dashurit dhe të shtrenjtët e mi haxhinj. I lutem Allahut të Madhëruar, që t'ju mbrojë dhe kërkoj prej jush, gjithashtu, që gjatë qëndrimit tuaj në ato vende të shenjta, të mos kryeni asnjë veprim që bie në kundërshti me ligjet e Zotit. Është e nevojshme, që Haxhi juaj dhe ritualet tuaja në ato toka të shenjta të mos ciflosen prej gjynaheve të caktuara, që e shkaktojnë hidhërimin e Allahut të Madhëruar.

Çdo lloj gjynahu apo kundërvajtje e kësaj natyre, do të bëjë që të humbni vlerën dhe dinjitetin tuaj përballë Allahut të Plotfuqishëm. Të gjitha këto vepra apo gjeste të ndërmarra prej jush, janë, në një farë mënyre, goditje për reputacionin e Islamit, për fenë që ju përfaqësoni. Nderi dhe krenaria e Islamit, në ditët e sotme, është e lidhur me qëndrimet tuaja, me krenarinë dhe me dinjitetin e secilit prej jush. Për sa kohë ju do të merrni qëndrime dinjitoze dhe do të ushtroni format e ndryshme të krenarisë, pjesa tjetër e myslimanëve do t'ju vështrojë dhe do të përpiqet t'ju imitojë dhe do të ndihet krenare për zgjedhjet dhe qëndrimet tuaja.

NUK MUND TË KETË HAXH TË PLOTË PA HAXH TË VËRTETË

Nuk ka dyshim se pozitat morale të Haxhit janë kapitali më i vyer dhe më i çmuar i përjetësisë. Ato pozita e afrojnë njeriun te horizontet e Njehsimit dhe të afrimitetit. Është e pamundur që të përfitojmë frytet e duhura dhe të nevojshme prej ritualeve të shenjta të kryera gjatë Haxhit, për sa kohë nuk do të praktikojmë me rigorozitet të gjitha dispozitat e lidhura me ritualin. Është detyrë e të gjithë haxhinjve dhe e dijetarëve të nderuar, që janë në krye të karvanëve të nisur për në Haxh, që të shpenzojnë të gjithë kohën dhe energjitë e tyre, për t'u shpjeguar haxhinjve rregullat dhe dispozitat e Haxhit. Është detyrë e të gjithë eulijave dhe njohësve (arifinëve) që i shoqërojnë njerëzit gjatë kryerjes së ritualeve të Haxhit, të monitorojnë dhe të kontrollojnë me kujdes të hollësishëm pjesën më të madhe të praktikave adhuruese të haxhinjve, në mënyrë që të mos gabojnë dhe ta kryejnë këtë obligim të madh në formën dhe në mënyrën më të përkryer.

Gjithsesi, kjo është njëra prej detyrave të dijetarëve të nderuar, që i shoqërojnë haxhinjtë. Detyra tjetër, shumë e rëndësishme e dijetarëve, është gjithashtu, njohja e njerëzve me imtësitë e dispozitave të Haxhit. Është vënë re se shumë prej njerëzve që shkojnë për të kryer adhurimin e

Haxhit dhe që përballen me sakrifica të mëdha për ta realizuar atë, janë të painformuar rreth detajeve dhe ritualeve që kryhen në tokat e shenjta. Për këtë arsye, sapo mbërrijnë atje, nuk dinë ku të shkojnë dhe si të veprojnë. Ndodh shpesh që një pjesë e haxhinjve të kthehen dhe të pyesin disa vite, pasi kanë kryer Haxhin. Ata vijjnë dhe tregojnë, pasi kanë kaluar disa vite, se, sipas dijenisë së tyre, e kanë kryer Haxhin sipas një forme të caktuar, duke kërkuar të dinë, nëse e kanë kryer atë në mënyrën e duhur apo jo.

Një tjetër pyetje e çuditshme që bëhet është: A vazhdojmë ende të jemi “në ihram” apo jo?! Është detyrë e dijetarëve tanë të nderuar, që i shoqërojnë ata, që t’u mësojnë atyre rregullat dhe dispozitat e Haxhit. Është detyrë e tyre që t’u mësojnë njerëzve obligimet e Haxhit, farzet e tij, ndalesat e tij, që janë çështjet më të rëndësishme, të lidhura me vërtetësinë e Haxhit ose jo. Nuk është ndonjë problem i madh që të mos kenë informacion rreth normave edukative shtesë të Haxhit, por e rëndësishme është të njihen me çështjet themelore të tij. Përsa u përket ndalesave dhe obligimeve, ato duhet t’u mësohen njerëzve çdo ditë prej ditëve të Haxhit dhe t’u kujtohen atyre në vazhdimësi, pasi ato janë edhe më të rëndësishmet. Është detyrë e haxhinjve, gjithashtu, që të shkojnë çdo ditë te dijetarët tanë të nderuar dhe të konsultohen për çështjet e ndryshme, të lidhura me dispozitat më të rëndësishme të Haxhit. Është detyrë e tyre

të ndjekin me korrektësi dhe në vazhdimësi mësimet e tyre. Është detyra e çdo besimtari dhe besimtareje, që të jetë i kujdesshëm, e kujdesshme dhe të njihet në vazhdimësi me mësimet dhe udhëzimet e dijetarëve të nderuar, si e vetmja mundësi, që të kryejnë në mënyrë të plotë adhurimet e tyre dhe të mos vijnë, pasi të kenë kaluar vitet, të pyesin: “A ka qenë tauafi im i pranueshëm, apo jo?! A ka qenë gurëzimi im i rregullt apo jo?!”

Pasi të kenë mësuar mirë çështjet e fesë së tyre, prej dijetarëve të nderuar dhe, pasi të jenë njohur nga afër me dispozitat më të rëndësishme të Haxhit, mund ta kryejnë adhurimin të plotë dhe pa gabime. Një tjetër angazhim i rëndësishëm, që duhet të kihet parasysh prej të gjithë njerëzve dhe që është detyrë e dijetarëve të nderuar, ta kryejnë atje, është të mësojnë mirë të gjitha çështjet e lidhura me Haxhin dhe të gjithë bashkë të binden se e kanë kryer një prej adhurimeve më të rëndësishme të jetës së myslimanit, në formën më të përkryer të mundshme dhe jo sipas modelit të famshëm “shkel e shko”, që ndryshe i thonë, sa për të kaluar radhën.

Është e padiskutueshme që, në një rast si ky dhe në një adhurim kaq i rëndësishëm sa Haxhi, çështja është krejtësisht e ndryshme. Në çdo vizitë tjetër që njeriu mund të kryejë apo mund të ndër marrë, nuk është ndonjë problem i madh, edhe nëse nuk i arrin qëllimet prej asaj vizite, ndërsa në rastin e Haxhit, çështja është shumë më ndryshe. Në rast se gjatë kryerjes së Haxhit ndodhin

kundërvajtje të mëdha dhe shkelje të rëndësishme, besimtarit do t'i duhet ta përsërisë Haxhin nga e para. Kjo nuk është gjithmonë një çështje që mund të realizohet lehtë. Për këtë arsye, është e nevojshme që të gjithë besimtarët të jenë të kujdesshëm dhe të përpiqen të mësojnë mirë dispozitat e Haxhit, si e vetmja mënyrë për të shmangur shkeljet e mëdha, që mund ta komprometojnë, në themel, kryerjen e Haxhit, një mënyrë, për të mos e filluar përgatitjen për Haxh edhe njëherë nga e para, pasi është një angazhim relativisht i vështirë.

QETËSIA NËPËRMJET KUR'ANIT GJATË KRYERJES SË HAXHIT

Shpreh dëshirën time të madhe, për t'u rikujtuar haxhinjve të nderuar, të cilët janë drejtuar për të kryer ritualin e Haxhit në vendet e shenjta, të kenë parasysh se gjatë gjithë kohës së qëndrimit të tyre në Mekën e bekuar dhe në Medinen e ndriçuar, të qetësojnë zemrat, shpirtrat dhe qeniet e tyre nëpërmjet leximit të Kur'anit. Ky është Libri i Shenjtë dhe mesazhi Hyjnor i myslimanëve. Të gjitha sukseset e myslimanëve në të shkuarën, në të tashmen dhe në të ardhmen janë pashmangshmërisht të lidhura me Librin e tyre të Shenjtë. Nisur nga ky fakt, shpresoj shumë dhe kërkoj prej dijetarëve tanë të nderuar, prej bijve të Kur'anit Famëlartë dhe prej të gjithë mendimtarëve tanë të famshëm, që të përfitojnë prej këtij rasti dhe prej kësaj mundësie të rëndësishme dhe të mos heqin kurrë dorë prej mësimave dhe këshillave të vyera të tij. Në të vërtetë, ai është sqarues dhe përcaktues për gjithçka. Ai është Libri Hyjnor, që e ka burimin te prania Hyjnore, që transferohet më pas për te zemra e parë, e mbushur me dritë.

Është ai libër, që, më dritën e tij, mund të mbështjellë të gjitha krijesat në tokë. Ky është Libri Hyjnor dhe më i rëndësishëm i myslimanëve, në të cilin gjenden të

përmbledhura mrekullisht të gjitha emrat dhe cilësitë e Krijuesit, bashkë me sqarimet dhe argumentet për gjithçka. Në jemi të paaftë për të përcaktuar pozitat e tij të fshehta dhe askush nuk është i aftë t'i njohë ato pozita përveç burimit të tij të shenjtë dhe atij të cilit i është dërguar zbulesa.

Ai është Libri i Shenjtë, dituritë dhe të fshehtat e të cilit i kanë mësuar njerëzit e dashur të Allahut dhe eulijatë. Ata i kanë marrë dijet e tij të shenjta drejtpërsëdrejti prej të Dërguarit të Allahut, i cili, nga ana e tij, i ka marrë prej burimit të shenjtë të Kur'anit Famëlartë. Dijet dhe fshehtësitë e tij të mëdha janë posaçërisht për eulijatë dhe besimtarët, që e kalojnë jetën e tyre pranë hapësirave të afrimitetit me burimin e shenjtë të Librit të Shenjtë, në varësi të pozitive dhe gradëve të secilit, të cilat varen drejtpërsëdrejti nga sasia dhe cilësia e ushtrimeve të tyre adhuruese e shpirtërore.

Sot, Libri i Shenjtë i myslimanëve gjendet në duart tona në formën e një botimi të përmbledhur me përpikëri, me përkujdesje Hyjnore dhe njerëzore të atillë, sa është e pamundur që dikush t'i shtojë apo t'i heqë qoftë edhe një germë të vetme. Mos e dhëntë Allahu, që Libri i Shenjtë i myslimanëve të lihet pas dore dhe të mos marrë rëndësinë që i takon, pasi në të janë të përfshira dijet, udhëzimet e nevojshme për secilin stad të jetës dhe sigurisht për kategoritë e ndryshme të njerëzve. Aty janë të përfshira udhëzimet e dukshme dhe të padukshme, duke filluar me

njerëzit e thjeshtë, të cilët mund të kuptojnë çështjet sipërfaqësore e deri tek eulijatë dhe adhuruesit e mëdhenj, të cilët i gjejnë shumë prej këshillave dhe dijeve thellësive të padukshme të kuptimit të Tekstit të Shenjtë. Janë dijetarët e ndryshëm, secili sipas fushës në të cilën është specializuar, që të shpjegojnë për njerëzit dhe besimtarët e thjeshtë dimensionet e fshehta dhe dijet e padukshme, të fshehura thellësive të Zbulesës Hyjnore. Nëpërmjet mësimave të shpeshta, hutbeve e ligjëratave të ndryshme, ata u tregojnë njerëzve dhe të interesuarve, mundësinë për t'u njohur me mrekullitë e Librit të Allahut, u tregojnë thesaret e mëdha të dijes dhe të njohurive që fshihen brenda tij. Janë ata, të vetmit, që i kanë mundësitë dhe aftësitë për t'u shpjeguar njerëzve atë det të madh të njohurive Hyjnore, që u zbritën në formën e zbulesës, për më të nderuarin e Profetëve, Muhamedin (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*).

Është detyrë shumë e rëndësishme, gjithashtu, që dijetarët e lëmive të tjera të shkencave, si filozofia dhe logjika, të shpjegojnë për njerëzit llojet e caktuara të dijeve, të përfshira në Zbulesën Hyjnore, qofshin ato të lidhura me gjuhën e kodifikuar në Kur'an, qofshin të lidhur me linja të tjera të shpjegimit dhe të komentimit, të cilat janë të pamundura të zbulohen dhe të zbërthehen prej një syri të lirë, që nuk është i specializuar në të gjitha fushat e interpretimit të fjalës.

Është detyrë e këtyre njerëzve të mençur dhe të ditur, që të sjellin në sipërfaqe dhe për syrin e lirë të lexuesit thellësitë dhe fshehtësitë e mëdha të atij oqeani të madh dijesh e kuptimesh, të Zbulesës Hyjnore dhe të Librit të Shenjtë, që iu zbrit Muhamed Mustafasë (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*).

Nga ana tjetër, është detyrë e madhe dhe po aq e rëndësishme e një tjetër kategorie të njerëzve, që të japin kontributet e tyre në shpjegimin dhe në komentimin e këtij oqeani të madh të Mesazhit Hyjnor. Janë adhuruesit e mëdhenj, arifinët, eulijatë dhe të gjithë ata, që si rezultat i përkushtimit të tyre të madh, për shkak të devocionit, për shkak të adhurimeve të tyre të mëdha dhe të pandërprera, kanë mundur të mbërrijnë në gradën dhe në pozitën e njerëzve që e kanë përfituar dijen me përkujdesjen e posaçme dhe të veçantë të Krijuesit të Gjithësisë, të Allahut të Madhëruar.

Është detyrë e këtyre njerëzve të mëdhenj, të cilët kanë mbërritur pozitën e larta morale dhe shpirtërore, që quhen “më ka mësuar dhe më ka edukuar Zoti im”, t’ua mësojnë njerëzve dijet dhe fshehtësitë e mëdha që gjenden në Mesazhin Hyjnor, të cilat ua ka mësuar Allahu i Madhëruar me përkujdesjen e Tij të veçantë.

Është detyrë e këtyre njerëzve të mëdhenj, që e kanë kaluar jetën e tyre hapësirave të afrimitetit me Krijuesin e tyre, që të njomin fytin e çdo të eturi për dijet e oqeanit dhe t’u mësojnë atyre normat elementare të sjelljes dhe të

edukatës hyjnore, t'u mësojnë atyre normat e sjelljes, që ka vendosur Allahu i Madhëruar. Këta njerëz të devotshëm, të mbuluar me dritë, duhet të ndriçojnë jetët e anëtarëve të njerëzimit me dritën e përkushtimit, të takuasë dhe të adhurimit, që e kanë marrë te burimi i pashtershëm i dijes, që gurgullon mendim, jetë, dritë dhe përjetësi. Kjo duhet të jetë dhurata e tyre për të gjitha zemrat besimtare, zemrat dhe mendjet e të cilave digjen prej dashurisë për t'u njohur me Allahun e Madhëruar dhe me dritën, dijet, njohuritë dhe të fshehtat që Ai i ka dërguar për njerëzimin nëpërmjet Zbulesës Hyjnore, të zbritur rob-it më të dashur të Tij.

Është detyrë e madhe dhe shumë e rëndësishme e secilit grup prej grupimeve të dijetarëve, që i përkasin lëmive të ndryshme të dijeve, të mprehin mirë majat e lapsave dhe t'ia nisin punës për të zbuluar aspekte, dimensione dhe mrekulli të llojeve të ndryshme, që fshihen në atë Libër të Shenjtë.

Është detyrë e secilit prej atyre grupimeve të dijetarëve, që të shpjegojnë, të komentojnë dhe të zbërthejnë për pjesën tjetër të njerëzimit dijet, urtësitë dhe të gjitha llojet e dritës, shpesh të kodifikuara. Është detyrë e këtyre njerëzve të ditur dhe të mençur, që, nëpërmjet punës së tyre të palodhur, të shuajnë etjen e të dashuruarve pas Kur'anit dhe pas dijeve të tij.

Është detyrë e shenjtë e këtyre njerëzve të ditur, që t'u tregojnë njerëzve, secili sipas fushës në të cilën është i specializuar, dimensionet Hyjnore, adhuruese, edukative,

sociale, politike, ekonomike dhe ushtarake të Mesazhit Hyjnor, si e vetmja rrugë dhe mënyrë që ata të mos humbasin kohën, thjesht duke e lexuar, por të kuptojnë atë çfarë janë duke lexuar, në mënyrë që t'i venë në jetë ato mësimet dhe ato udhëzime.

Kjo është mënyra e vetme që ky Kur'an i zbritur Muhamedit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) të japë ndikimet për të cilat është zbritur. Duhet të bëhet e ditur për të gjithë njerëzimin, se në thellësitë e këtij Libri të Shenjtë është e përfshirë gjithçka. Ky është Libri madhështor, në brendësi të të cilit gjenden të gjitha llojet e shkencave. Aty ka fe, njohje, adhurim, filozofi, asketizëm, letërsi, politikë, ekonomi, etj. Ky është një argument rrënues për të gjithë ushtrinë e injorantëve dhe të paditurve, që pretendojnë dhe thonë se njohja (irfani), asketizmi dhe filozofia nuk janë shkencë dhe dije, por janë pjesë e imagjinatës së shthurur dhe jo gjithmonë të qëndrueshme të adhuruesve, asketëve dhe dervishëve, që vijnë si rezultat i ushtrimeve dhe i formave të caktuara të fizkulturës së mendjes dhe të zemrës së atyre njerëzve. Këta injorantë dhe të paditur janë e njëjta kategori njerëzish, që pretendojnë se dijetarët dhe mendimtarët e fesë duhet të merren me çështjet e shpirtit, të zemrës dhe të xhamisë, ndërsa punët e shtetit, të politikës, të ekonomisë dhe të drejtimit të jetës së njerëzve duhet të jenë posaçërisht për kategorinë e ngritur dhe të arsimuar, me ato që i quajnë padrejtësisht shkencat laike.

Politika, sipas pretendimeve të tyre të kota, është punë e presidentëve, e kryeministrave, e mbretërve dhe njerëzit e fesë nuk duhet dhe nuk mund t'i fusin hundët, pasi janë fusha tërësisht të panjohura për ta. Kjo është ajo kategori njerëzish që mendojnë dhe thonë se Islami është fe e zemrës dhe e shpirtit dhe nuk merret me këto punë.

Duhet të informohen të gjithë se urtësia e Zbulesës Hyjnore qëndron në faktin se ajo ka zbritur për udhëzimin dhe udhërrëfimin e të gjitha racave, popujve, fiseve dhe kombësitë e botës dhe do të vazhdojë t'u drejtohet atyre sa të jetë jeta, deri në Ditën e Gjykimit.

Qëllimi i Zbulesës Hyjnore është që të mbajë gjithmonë të gjalla dhe të ndriçuara të gjitha aspektet e jetës, qofshi ato të lidhura me moralin, edukatën dhe gjendjen shpirtërore, por edhe ato që lidhen me çështjet më të rëndësishme të shtetit, formën e qeverisjes, etj. Qëllimi është t'u tregojë njerëzve dhe t'u mësojë atyre se përmbajtja e këtij Libri të Shenjtë nuk është e lidhur me popuj të caktuar, me njerëz të caktuar dhe për kohë të caktuara.

Askush nuk duhet të ketë dyshime se misioni dhe arsyeja se përse është dërguar Ibrahim (Paqja e Zotit qoftë mbi të!), Musai (Paqja e Zotit qoftë mbi të!) dhe Muhamedi (Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!) ka qenë për njerëz apo popuj të caktuar, për kohëra apo segmente të caktuara të historisë.

KAPITULLI I DYTË

DIMENSIONI SHOQËROR I HAXHIT

“Një prej dimensioneve më të rëndësishme shoqërore dhe filozofike të këtij grumbullimi të madh njerëzish, është përforcimi i ndjenjës së unitetit midis të gjithë pasuesve dhe ndjekësve të Profetit të Islamit, Muhamedit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*)”.

UNITETI NË FILOZOFINË E HAXHIT

Është detyrë e të gjithë vëllezërve dhe e motrave tona myslimane, që të përqendrohen, të jenë të vëmendshëm dhe të jenë të vetëdijshëm se, një nga misionet dhe rolet më të rëndësishme të Haxhit, është përforcimi i ndjenjës së vëllazërisë dhe të unitetit midis të gjithë myslimanëve.

Është detyrë e të gjithë njerëzve të mençur, e dijetarëve dhe e hoxhallarëve tanë të nderuar, që të trajtojnë çështjet më të rëndësishme shkencore, fetare, sociale, politike dhe ekonomike dhe t’i konsultojnë ata me

vëllezërit e tyre myslimanë, që mund të vijnë nga vende të ndryshme të botës, sepse ky është një prej qëllimeve madhore të Haxhit.

Është detyrë e të gjithë myslimanëve, që të trajtojnë çështjet e tyre më të rëndësishme me interes të përbashkët, t'i hedhin për diskutim, studim e analizë, me vëllezërit e tyre myslimanë nga e gjithë bota. Të gjejnë zgjidhjet e përshtatshme për secilën prej problematikave dhe, çështjet që mbeten pa u zgjidhur, të transferohen për te dijetarët dhe specialistët e fushave në vendet përkatëse.

Më lejoni të përsërit, duhet të jemi të gjithë të vetëdijshëm se njëra prej filozofive dhe qëllimeve më të rëndësishme të këtij grumbullimi madhështor dhe periodik njerëzish është forcimi i ndjenjës së bashkëpunimit ndërmjet myslimanëve të të gjithë botës. Të gjithë ndjekësit e Islamit dhe pasuesit e Kur'anit Famëlartë duhet të jenë të bashkuar kundër diktaturave, zullumqarëve dhe tiranive të botës. Në rast se ndonjë grupim prej myslimanëve apo individ, do të kryejë punë apo angazhime të tilla, që kanë për qëllim të përçajnë myslimanët dhe ta thyejnë unitetin e tyre, duhet të jenë të bindur se do të përballen shumë shpejt me hidhërimin e Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) dhe njëkohësisht me ndëshkimin e Allahut të Madhëruar. (*Zoti na ruajtë!*)

Të gjithë myslimanët dhe myslimanet, besimtarët dhe besimtares që kanë shkuar apo që do të shkojnë në të ardhmen për të kryer Haxhin, duhet ta dinë dhe ta kenë të

qartë se është prej normave të moralit dhe të fesë, që gjatë ditëve të qëndrimit në ato vende të shenjta dhe jo vetëm, duhet të jenë të edukuar dhe të sjellshëm me të gjitha krijesat e Allahut. Mirësjellja dhe edukata duhet t'i përfshijë të gjithë njerëzit, nguliteni mirë në mendje, pa dallim race, kombësie, gjuhe të folur, lokaliteti gjeografik apo ngjyre të lëkurës. Është e nevojshme dhe kërkohet prej të gjithë myslimanëve në Haxh, që të jenë të bashkuar, si e vetmja rrugë dhe mënyrë për të triumfuar ndaj armiqve të Islamit dhe të njerëzimit, që planet e tyre të dështojnë.

HAXHI ËSHTË QENDËR E NJOHJES SË MYSLIMANËVE ME NJËRI-TJETRIN

Nuk ka dyshim se Haxhi është vendi më i përshtatshëm, ku myslimanët nga e gjithë bota mund të njihen me njëri-tjetrin, mund të njihen më nga afër me vëllezërit dhe me motrat e tyre në Islam, që vijnë nga lokalitete dhe vende të ndryshme të botës. Ky është një takim i mrekullueshëm ndërmjet të gjithë myslimanëve të botës, që zhvillohet në Shtëpinë e Shenjtë dhe në vendin e Shenjtë, ku ka vend për të diskutuar dhe për të trajtuar hallet, problematikat dhe shqetësimet e të gjitha shoqërive myslimane, nga e gjithë bota. Haxhi është vendi më i përshtatshëm, në të cilin mund të takohen pasuesit e fesë së pastër të Ibrahimit (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) dhe më pas secili të kthehet në vendin e tij.

Është detyrë e të gjithë myslimanëve, e besimtarëve dhe e besimtareve, që të jenë të sjellshëm me njëri-tjetrin, të jenë të kulturuar dhe të edukuar, të shmangin debatet dhe konfrontimet e padobishme, që mund të shkaktojnë hidhërim e zemëratë ndërmjet njëri-tjetrit. Kjo është mënyra më e mirë dhe e vetme për të sistemuar me kujdes dhe për të ndërtuar marrëdhënie të forta midis

myslimanëve të ardhur nga e gjithë bota. Kjo është e vetmja mënyrë për të mbrojtur unitetin e pasuesve të Muhamedit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) kudo që gjenden dhe cilado qoftë përkatësia e tyre.

BASHKOHUNI TË GJITHË NË GURËZIMIN E DJALLIT

Është detyrë e të gjithë myslimanëve të botës, pavarësisht përkatësisë së tyre kombëtare apo gjeografike, që t'i nënshtrohen me përkushtim dhe rigorozitet ligjeve të Allahut dhe dispozitave Hyjnore të përcaktuara në Kur'anin Famëlartë. Është detyrë e të gjithë myslimanëve të botës, që të jenë të bashkuar në përpjekjet e tyre për t'u përballur me ushtritë e mëdha dhe të panumërta të djajve, që, në themel të strategjive të tyre për botën, kanë shkuljen nga rrënjët dhe shfarosjen e Islamit prej Lindjes dhe prej Perëndimit. Këto ushtri të panumërta, në bashkëpunim të ngushtë me agjentët dhe me shërbëtorët e tyre nga mesi i myslimanëve, që nuk kanë as fe, as nder, as dinjitet, punojnë natë e ditë për të arritur qëllimet, synimet dhe për të realizuar me sukses planet e tyre të errëta.

Është detyrë e të gjithë myslimanëve, nga e gjithë bota, që të shtrijnë për njëri-tjetrin dorën e bashkëpunimit dhe të vëllazërisë. Është detyrë e tyre, që të jenë të vëmendshëm dhe të kujtojnë në mënyrë të pandërprerë udhëzimet dhe këshillat e vyera kur'anore, që i ftojnë myslimanët të kapen fort pas litarit (udhëzimit) të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, sikurse i ftojnë ata që të heqin dorë prej kundërshtive dhe ndasive, sepse ato mund të bëhen

shkak për dobësimin dhe shkatërrimin e tyre. Është detyrë e myslimanëve, që të përfitojnë sa të munden dhe të gjenerojnë një aksion të mirëfilltë politik prej këtij rituali të lartë dhe të shenjtë të myslimanëve, siç është Haxhi. Ato vende të shenjta, të ndriçuara prej dritës së adhurimit dhe të njehsimit dhe të populluara prej zemrave dhe mendjeve të dashuruara pas Allahut dhe Profetit të Tij (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), janë vendi më i përshtatshëm për të lidhur besën dhe për t'i dhënë jetë aksionit më të madh politik të myslimanëve të bashkuar nga e gjithë bota. Ato vende të shenjta janë vendet më të përshtatshme për të marrë mësimet e duhura dhe të nevojshme, prej frymës së sakrificës ibrahimite dhe ismailite, si dy simbole të mëdha dhe të pazëvendësueshme të përkushtimit, të vetëmohimit, të vetëflijimit dhe të sakrificës. Ata dy Profetë kanë qenë shprehja e shkallës sipërore të vetëflijimit dhe të sakrifikimit të gjithçkaje të shenjtë dhe të shtrenjtë, për hir të Allahut të Madhëruar dhe të fitimit të kënaqësisë së Tij.

Është detyrë e të gjithë myslimanëve të botës, që të përzënë dhe të përjashtojnë prej vendeve të shenjta, prej hapësirave të pastra të Islamit dhe prej Qabesë së Bekuar, të gjitha llojet e djajve, qofshin ata të mëdhenjtë, të mesmit dhe të vegjlit. Është detyrë e të gjithë myslimanëve, që të presin duart e djajve që shtrihen në drejtim të Qabesë, sikurse është detyrë e tyre, që të presin të gjitha duart që shtrihen dhe kanë synime grabitqare në drejtim të vendeve

të myslimanëve, kudo që ata janë. Nuk ka dyshim se shenjtëria e vendeve ku ka myslimanë është e ngjashme me shenjtërinë e Qabesë. Është detyrë e të gjithë myslimanëve, që nëpërmjet këtyre angazhimeve dhe ndërmarrjeve, të plotësojë thirrjen dhe ftesën e Allahut, duke thënë *“Lebejkellahume lebejke!”* - *“Tu përgjigjem, o Allah, t’u përgjigjem!”*

BASHKOHUNI PËR TË KTHYER AUTORITETIN NË BOTË

Është detyrë e të gjithë myslimanëve, që, në ato vende të shenjta, të mbështeten te Allahu i Madhëruar. Ato janë vendet dhe momentet më të përshtatshme për të kërkuar ndihmën, mbështetjen dhe asistencën e Krijuesit të Gjithësisë. Ato vende të shenjta janë vendet më të përshtatshme për të lidhur besën dhe për t'i shpallur luftë djallit të mallkuar dhe ushtrive të tij. Është momenti më i përshtatshëm për të lënë mënjane ndasitë, urrejtjet, përçarjet dhe keqkuptimet ndërmjet njëri-tjetrit. Allahu i Madhëruar, në Kur'anin Famëlartë, thotë:

1 “...وَلَا تَنَازَعُوا فَتَفْشَلُوا وَتَذْهَبَ رِيحُكُمْ...”

“Dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t’ju lërë fuqia.”

Duhet të mbretërojë fryma e bashkimit, e unitetit, e bashkëpunimit dhe e vëllazërisë ndërmjet myslimanëve, sepse ato janë themelet më të rëndësishme të forcës dhe të triumfit. Kjo është e vetmja mënyrë për të sulmuar dhe për të mposhtur të gjitha llojet e përçarjeve dhe të ndasive, të cilat e kanë burimin te fuqitë e errëta të shpirtit, siç është egoja, uni, vetëpëlqimi, mendjemadhësia, etj. Janë këto forca të errëta, të vendosura thellësive të genies, që e

pamundësojnë bashkimin dhe që i kundërshtojnë vazhdimisht urdhëresat e Allahut të Madhëruar.

E vetmja mënyrë dhe mundësi që myslimanët të bashkohen dhe të realizojnë triumfin e tyre, është bashkimi i tyre rreth të vërtetës së madhe, të shpallur prej Allahut të Madhëruar, unifikimit të fjalës, që do të thotë unifikim i qëndrimeve të tyre mbi bazat e mirëfillta të Njehsimit të Allahut, që përbën burimin e pashtershëm të energjive të myslimanëve dhe sekretin e fitoreve të tyre të mëdha.

O ju myslimanë të botës!

Le të kthehemi bashkërisht dhe të shohim gjendjen e myslimanëve në fillimet e Islamit. Edhe pse të pakët në numër, ata kanë arritur të mposhtin dhe të nënshtrojnë fuqitë më të mëdha të kohës. Ata myslimanë, me gjithë dobësitë e tyre, kanë mundur dhe kanë arritur të ofrojnë për njerëzimin modelin e shkëlqyer të shoqërisë islame. Sot myslimanët (në kohën kur ka jetuar autori) janë përafërsisht një miliardë njerëz, nga vende të ndryshme të botës. Ata zotërojnë sot pjesën më të rëndësishme të pasurive të botës, që mund të konsiderohet pa hezitim si themeli i lirisë e megjithatë vuajnë dobësinë, pushtimin dhe nëpërkëmbjen e të drejtave të tyre.

Si është e mundur që një ymet (bashkësi njerëzish) të ketë të gjithë elementet përbërëse të fuqisë e megjithatë të jetë i nënshtruar ndaj armiqve të tyre?! Ku e ka zanafillën një paradoks i këtyre përmasave?! A e dinë myslimanët sot dhe a janë të vetëdijshëm se arsyeja

kryesore e dobësisë dhe e nëpërkëmbjes së tyre është konfliktualiteti, përçarja dhe kundërshtitë që kanë drejtuesit, mbretërit dhe krerët e vendeve myslimane mes veti? Për rrjedhojë, ky konfliktualitet dhe kjo përçarje transmetohet dhe përcillet edhe te popujt dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre.

O ju myslimanë të botës!

Ngrihuni të gjithë në këmbë, zgjohuni dhe bashkohuni të gjithë rreth mësimave dhe udhëzimeve të vyera të Allahut të Madhëruar, të zbritura në Librin e Shenjtë, sepse kjo është e vetmja mënyrë për të rikthyer edhe njëherë krenarinë dhe lavdinë tuaj të dikurshme.

Ejani të gjithë të shihni njërin prej udhëzimeve dhe mësimave më të rëndësishme, të cilin Allahu i Madhëruar e ka përmendur në Kur'anin Famëlartë. Ejani të gjithë të shihni, kur Allahu i Madhëruar thotë:

“ قُلْ إِنَّمَا أَعْظُمُكُمْ بِوَاحِدَةٍ أَنْ تَقُومُوا لِلَّهِ مَتَّئِي وَفُرَادَى ... ”

“Thuaj (o Muhamed): ‘Unë ju këshilloj vetëm një gjë: Ngrihuni sinqerisht për Allahun, dy nga dy ose një nga një.’”⁵

Thirrja e Allahut të Madhëruar është e qartë, veçanërisht në ajetin e sipërpërmendur. Në rrafshin individual dhe personal, ngrihuni në këmbë dhe mobilizoni të gjitha fuqitë tuaja shpirtërore dhe mendore, për të mposhtur, për të rrënuar dhe për të nënshtruar të

⁵ Surja “Sebe”, ajeti 46.

gjitha fuqitë e errëta të djallit të mallkuar, që veprojnë lirisht thellë qenieve tuaja.

Shpalluni luftë të gjitha fuqive të errëta, që veprojnë thellësive të qenieve tuaja, sepse ato janë energji të errëta, që e tërheqin qenien dhe njeriun kah orientimi i djallit të mallkuar. Në thelb, janë fuqi dhe energji të errëta, që prodhojnë demoralizim dhe regres. Ndërsa në rrafshin shoqëror, lipset prej jush të bashkoni qëndrimet, të bashkërendisni strategjitë dhe të ngriheni të gjithë bashkë në fytyrë të Fuqive të Mëdha dhe të strategjive të errëta antinjerëzore. Nëse zgjimi, ngritja, vetëdija dhe revolucioni do të bëhen për hatër të Allahut dhe për të fituar kënaqësinë e Tij, dijeni se triumfi dhe fitorja është në krahun tuaj.

O ju myslimanë dhe ju popuj të shtypur të botës!

Bashkoni energjitë tuaja, zgjatjani dorën njëri-tjetrit dhe rrugëtoni të sigurt në rrugën e Allahut të Madhëruar. Kthehuni te Islami juaj dhe hidhuni në luftë kundër fuqive të errëta, që kanë për synim të sundojnë dhe të poshtërojnë njerëzimin. Është detyrë e juaja që të bëheni të gjithë bashkë dhe të luftoni kundër atyre që i kanë grabitur pasuritë e popujve, kanë sulmuar dinjitetin, të drejtat dhe nderin e tyre.

Haxhinj të nderuar, që keni vërshuar nga e gjithë bota, për të kryer ritualet madhështore të vendet e shenjta. Bashkoni energjitë tuaja nën hijen e kuptimeve të mëdha të adhurimeve tuaja dhe lutjuni Allahut të Madhëruar në

ato vende të shenjta, që të ndihmojë Islamin, myslimanët dhe të gjithë të shtypurit e njerëzimit, kudo që ata gjenden.

BASHKIMI ËSHTË E VETMJA ZGJIDHJE

Haxhinj të nderuar!

E gjithë pjesa tjetër e botës është e bashkuar rreth njëri-tjetrit, ndaj është detyrë e myslimanëve, që të bashkohen dhe të trajtojnë me kujdes problematikat e secilit vend mysliman gjatë periudhës së Haxhit. Është detyrë e të gjithëve, që të përpiqemi të bëjmë më të mirën, për të siguruar, për të mbrojtur dhe për të siguruar interesat e Islamit dhe të myslimanëve kudo që ata gjenden. Është detyrë e të gjithë haxhinjve, në veçanti, por dhe e myslimanëve, në përgjithësi, që të ndihmojnë me mendimet dhe me dijet e tyre për t'i gjetur zgjidhjet më të mira halleve dhe problematikave me të cilat përballen vazhdimisht myslimanët. Kjo është e vetmja mënyrë dhe e vetmja rrugë për të arritur qëllimet e shenjta islame.

Është detyrë e të gjithëve, që të përpiqen dhe të bëjnë sa të munden për të përafruar pikëpamjet, qëndrimet dhe idetë ndërmjet anëtarëve të grupimeve dhe shkollave të ndryshme të juridiksionit islam, si e vetmja rrugë dhe strategji që mund të konkretizohet në fund me bashkimin e madh, aq të dashur dhe aq shumë të ëndërruar të myslimanëve nga e gjithë bota. Është detyrë e

muslimanëve, që të studiojnë me kujdes dhe me imtësi çështjet e përbashkëta politike të muslimanëve të grupimeve dhe të shkollave të ndryshme dhe të përpiqen të takohen te të përpjesëtueshmit e përbashkët ndërmjet tyre, edhe kur e kanë të pamundur të bien dakord për gjithçka. Është detyrë e të gjithë muslimanëve, që të bashkojnë përpjekjet dhe energjitë e tyre për t'u përballur dhe për t'iu kundërvënë në mënyrën më efektive të mundshme planeve të armiqve, që punojnë natë e ditë për të përçarë muslimanët në grupe e sekte nga më të ndryshmet, si e vetmja rrugë për t'i mbajtur ata në konflikt me njëri-tjetrin dhe më pas për t'i sunduar, për t'i poshtëruar dhe për t'ua grabitur pasuritë e tyre sipas agjendave respektive të secilës prej fuqive të errëta.

Cila është zgjidhja sot?! Cila është mënyra e duhur dhe strategjia më e suksesshme, që duhet të ndjekin muslimanët dhe të gjithë popujt e shtypur të botës, për të thyer të gjitha format e putave dhe të zotave të falsifikuar që banojnë thellë qenieve të tyre?!

Ka një rrugë të vetme për t'u përballur me llojet e dhimbjeve dhe të fatkeqësive që kanë pushtuar sot muslimanët dhe mbarë popujt e shtypur të botës. Ka vetëm një rrugë, që mund të ndalë llojet dhe format e komplikuar të shkatërrimit dhe të degjenerimit në botë. Ka vetëm një mënyrë për të rikthyer bashkimin ndërmjet muslimanëve të botës, madje për të shkuar përtej muslimanëve dhe për të kthyer bashkimin ndërmjet të

gjithë popujve të shtypur të botës dhe për t'i shpëtuar ata prej formave të sofistikuara të prangave dhe të skllavërisë. Ky bashkim është i domosdoshëm, mbi të cilin ka hedhur dritë feja e bekuar islame dhe mësimet e Kur'anit Famëlartë. Për të realizuar këtë bashkim, më parë, duhet të bashkojmë energjitë tona, për të përçuar thirrjen tonë për të gjithë njerëzimin, deri te skajet më të largëta të botës. Qendra e kësaj thirrjeje të madhe është padyshim Meka e Madhërishtme, veçanërisht gjatë kohës kur aty mblidhen myslimanët nga e gjithë bota, për të kryer ritualet e shenjta të Haxhit. Ky është një rrugëtim i shenjtë, të cilin e ka nisur i dashuri dhe i shtrenjti i Allahut, Profeti Ibrahim (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*), e ka pasuar më i nderuari i Profetëve dhe krijesa më e dashur e Allahut, Profeti Muhamed (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) dhe do ta plotësojë atë në fund të kohës dhe të historisë i bekuari, i ndershmi dhe i shenjti, Imam Mehdiu (*I qofshim falë!*). Kjo është thirrja e Allahut të Madhëruar, drejtuar Profetit Ibrahim (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) dhe më pas drejtuar mbarë njerëzimit, që t'i përgjigjen thirrjes dhe ftesës së Allahut të Madhëruar, për të kryer ritualin e shenjtë të Haxhit. Kjo është thirrje për mbarë myslimanët, që të vërshojnë prej vendeve të ndryshme të botës dhe të prekin nga afër llojet dhe format e ndryshme të përfitimeve, që i ka rezervuar Allahu i Madhëruar për ta dhe për shoqëritë prej nga vijnë. Pjesë e kësaj pakete hyjnore përfitimesh janë, padyshim, përfitimet sociale,

ekonomike, shoqërore dhe politike. Kjo është një ftesë drejtuar të gjithë myslimanëve të botës, që të vijnë dhe të vizitojnë Profetin e Allahut (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), i cili ka sakrifikuar gjithçka të shenjtë dhe të shtrenjtë, në funksion të ndihmës dhe të përkrahjes së ofruar për Islamin dhe myslimanët. Është detyrë e të gjithë njerëzimit, e të gjithë bijve të Ademit, pa dallim feje, të shohin ty o mysliman se si i thyen, se si i shkatërron dhe i thërrmon të gjitha llojet e putave dhe të gjitha llojet e zotave të falsifikuar, duke mos lënë në zemrën tënde vend për askënd tjetër përpos Allahut të Madhëruar. Haxhi është momenti dhe dëshmia më e sinqertë se si myslimanët ndjekin rrugën e të dashurit të Allahut, Ibrahimit (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*), që shkërmoqi dhe hodhi poshtë të gjithë zotat iluzionarë, si: dielli, hëna dhe llojet e tjera të putave dhe të zotave të rremë, prej njerëzve apo prej kafshëve. Allahu i Madhëruar thotë kështu në Kur'anin Famëlartë:

“...وَجْهَتْ وَجْهِي لِلَّذِي فَطَرَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ حَنِيفًا وَمَا أَنَا مِنَ الْمُشْرِكِينَ”

“Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë dhe nuk jam nga idhujtarët.”⁶

Është detyrë e të gjithë besimtarëve, që të marrin si shembull babain e Profetëve dhe babain e Njehsimit, këtë njeri me pozita aq të larta te Allahu i Madhëruar. Në suren

⁶ Surja “El En’am”, ajeti 79.

“Et Teube” njihemi nga afër me urdhrin e Allahut dhe me thirrjen e Profetit Ibrahim drejtuar mbarë njerëzve. Allahu i Madhëruar na njofton në Kur’anin Famëlartë:

“ وَأَذَانٌ مِّنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ إِلَى النَّاسِ يَوْمَ الْحَجِّ الْأَكْبَرِ أَنَّ اللَّهَ بَرِيءٌ مِّنَ الْمُشْرِكِينَ وَرَسُولُهُ ... ”

“Ja shpallja e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij drejtuar njerëzve në ditën e Haxhit të madh: ‘Allahu dhe i Dërguari i Tij shkëpusin çdo lidhje me idhujtarët dhe çdo detyrim ndaj tyre.’”⁷

⁷ Surja “Et Teube”, ajeti 3.

THEMELONI FRONTIN E TË VUAJTURVE

Prej funksioneve më të rëndësishme të këtyre grupimeve dhe grumbullimeve të shenjta, ashtu siç e kemi përmendur edhe më sipër, është bashkimi i qëndrimeve të myslimanëve dhe i strategjive të tyre për të luftuar të gjitha format e ndasive dhe të kundërshtive ndërmjet shtresave të ndryshme të tyre. Është detyrë e dijetarëve dhe e mendimtarëve myslimanë dhe e të gjithë botës, që të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre të mëdha karshi njerëzimit. Ata duhet të mblidhen të gjithë bashkë dhe duhet të formojnë "Frontin e të shtypurve". Duke bashkuar frontet, mund të bashkohen qëndrimet. Nuk ka dyshim se dëshmia "La Ilaha Ilall'illah" - "Nuk ka Zot tjetër të adhuruar, më të drejtë, përpos Allahut të Madhëruar!" është siguria e madhe për çlirimin prej të gjitha fuqive djallëzore të tokës, sado të mëdha dhe sado të bashkuara qofshin ato. Vetëm nëpërmjet bashkimit dhe vëllazërisë ata do të mund të triumfojnë ndaj qëllimeve dhe planeve grabitqare të armiqve të myslimanëve dhe të mbarë njerëzimit.

KUJDESUNI QË TË MOS PËRÇAHENI

Le ta dëgjojë e gjithë bota, le ta dëgjojë i gjithë njerëzimi këtë të vërtetë:

Nuk ka më asnjë dyshim se armiqtë e Islamit dhe të myslimanëve kanë bërë në të kaluarën, bëjnë sot dhe do të bëjnë edhe në të ardhmen të gjitha përpjekjet për t'i përçarë myslimanët dhe për të mbjellë rrënjët e urrejtjes ndërmjet tyre, qoftë në nivel individual, qoftë në nivel shoqëror. Ata përpiqen vazhdimisht që shoqëritë myslimane të jenë në konflikt me njëra-tjetrën, si e vetmja mënyrë për t'i mbajtur ato të përçara. Nëpërmjet këtyre strategjive, ata arrijnë të sigurojnë epërsinë e tyre të vazhdueshme ndaj shoqërive islame, në të gjitha format dhe dimensionet nëpërmjet të cilave shfaqet kjo epërsi. Kjo është mënyra e vetme që ata të rikthejnë kontrollin e tyre ndaj vendeve islame. Ajo që i ndihmon më shumë synimet e tyre të errëta, është etja e tyre e paepur për të shtënë në dorë pasuritë e myslimanëve dhe për t'i mbajtur ato vazhdimisht nën kontroll. Nisur nga sa u përmend më sipër, lind si detyrë për të gjithë myslimanët, për të gjithë besimtarët dhe besimtaret, që të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të zhdukur të gjitha format e përçarjes dhe të konfliktit ndërmjet tyre, si e vetmja formë për t'u përballur me planet djallëzore të armiqve të tyre dhe për t'i ndaluar ata, që të realizojnë me

sukses planet e tyre, për të shtënë në dorë dhe për të kontrolluar pasuritë me të cilat Allahu i Madhëruar i ka begatuar myslimanët. Askush të mos ketë dyshim se bashkimi midis myslimanëve është një prej detyrave më të mëdha dhe më të rëndësishme hyjnore.

SEKRETI I TRIUMFIT DHE ARSYET E DISFATËS

O ju myslimanë të botës! Është e dhimbshme të vëresh se pasuesit e fesë së Teuhidit (të Njehsimit) janë të ndarë dhe të përçarë. Duhet ta dinë myslimanët e të gjithë botës se sekretet e prapambetjes dhe të gjitha këtyre vështirësive, me të cilat përballen vendet myslimane, është, pikërisht, konflikti dhe përçarja ndërmjet tyre. Askush të mos dyshojë se sekretet e triumfit dhe të fitores, njëkohësisht, është bashkimi ndërmjet myslimanëve, bashkëpunimi ndërmjet tyre. Këtë e sqaron më së miri Allahu i Madhëruar në Kur'anin Famëlartë:

“وَاعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُوا”

“Kapuni të gjithë pas Litarit të Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u përçani.”⁸

E vërteta është se kapja pas Litarit të Allahut është treguesi më i qartë i bashkimit të myslimanëve. Ky është një bashkim dhe një bashkëpunim, që duhet të kryhet për hir të Allahut, për hir të Islamit dhe për hir të interesave të myslimanëve. Për t'i mbërritur këto synime të shenjta, duhet të heqim dorë urgjentisht prej formave të ndryshme të konflikteve, të kundërshtive dhe prej formave të komplikuarra të trysnisë, që e ushtron prirja për besnikëri

⁸ Surja “Ali Imran”, ajeti 103.

ndaj grupacionit apo ndaj partisë, cilado qoftë ajo. Të gjithë duhet të vetëdijesohen dhe të kuptojnë një herë e mirë se këto konflikte janë molla e sherrit, janë origjina e të gjitha fatkeqësive, që kanë pushtuar botën islame dhe vendet e myslimanëve kudo që ata janë.

I lutem Allahut të Madhëruar, që të bashkojë fjalën dhe qëndrimet e myslimanëve në të gjithë botën dhe të lartësojë nëpërmjet bashkimit të tyre fenë tonë të pastër islame.

PËRBALLUNI ME INTELEKTUALËT E SHITUR

O ju besimtarë! Ju njerëz të ndershëm të botës, që e keni besuar Allahun dhe e keni pasuar të Dërguarin e Tij. Ju njerëz të bekuar prej Zotit, që e keni ndjekur të vërtetën e Islamit. Çohuni, ngrihuni dhe bashkohuni të gjithë nën Flamurin e Teuhidit (Njehsimit). Mblidhuni të gjithë bashkë rreth udhëzimeve dhe mësimëve të vyera të Islamit. Bashkohuni dhe largoni duart tradhtare të armiqve të Islamit prej pasurive të mëdha, me të cilat Allahu i Madhëruar i ka begatuar myslimanët. Kthejani edhe një herë krenarinë Islamit. Hiqni dorë prej konflikteve, prej përçarjes dhe prej kundërshtive, sepse ato janë prej fuqive të errëta të qenies, që e ndalojnë bashkëpunimin dhe bashkimin ndërmjet jush. Ju i keni të gjitha mundësitë. Ju i keni të gjitha pasuritë. Ju i keni të gjitha elementet e fuqisë. Është detyra juaj, që t'i vendosni ato në funksion të rikthimit të krenarisë së Islamit. Kapuni fort pas Islamit dhe qytetërimit të tij dhe mbështetuni fort te themelet e tij. Luftoni me të gjitha fuqitë tuaja, Perëndimin dhe të perëndimorizuarit, shërbëtorët e tyre, që kanë synime të errëta ndaj vendeve dhe ndaj pasurive tuaja. Ngrihuni dhe qëndroni mbi këmbët tuaja.

Është detyra juaj të luftoni dhe të përballeni me intelektualët e perëndimorizuar dhe me orientalistët

qëllimligj. Është detyra juaj, që t'i jepni formë identitetit tuaj dhe të mos i lejoni intelektualët e shitur, që punojnë për llogari të fuqive të errëta, të përhapin fatkeqësitë dhe të mbjellin përçarjen ndërmjet myslimanëve, ashtu siç kanë bërë historikisht. Kjo farë e keqe të vetëquajturish intelektualë, ka mbjellë urrejtje dhe përçarje ndërmjet myslimanëve, madje dhe ndaj anëtarëve të të njëjtit popull, për të siguruar përçarjen dhe dobësimin e tyre. Kanë bërë gjithçka kanë pasur në dorë dhe kanë mundur të ndalojnë myslimanët të mbështeten te feja e tyre, te feja që Allahu i Madhëruar ka zgjedhur për mbarë njerëzimin.

Të gjithë myslimanët e botës duhet ta dinë mirë dhe ta kenë të qartë një çështje shumë të rëndësishme: Për sa kohë që do të jenë të përçarë, të luftuar dhe të konfliktuar mes veti; për sa kohë nuk do të mbështeten te Islami i drejtë dhe i vërtetë, si rruga e vetme për të arritur suksesin, krenarinë dhe shpëtimin në këtë botë dhe në Botën Tjetër, kanë për të vuajtur edhe për një kohë të papërcaktuar të gjitha dhimbjet, humbjet dhe fatkeqësitë, me të cilat janë përballur deri tani.

Është detyrë e të gjithë popujve myslimanë, sot, që të ndriçojnë rrugën e dijetarëve dhe të mendimtarëve të tyre, t'i mbështesin fort ata dhe të mos lejojnë që t'i nënshtrohen të dobët, të përlulur dhe të dorëzuar ndikimeve të huaja, herë në Lindje e herë në Perëndim. Sot është dita e organizmit të popujve të botës, për t'u përballur me zullumin, diktaturat dhe tiranitë. Kjo është

dita që ka frymëzuar shumë njerëz të botës. Duhet të jeni të vetëdijshëm se fuqia juaj morale është fuqia më e madhe që keni. Ju jeni sot afërsisht një miliard banorë dhe njëkohësisht jeni pronarë të pasurive të mëdha, që është e vështirë të maten dhe të numërohen. Ju o myslimanë, i keni të gjitha elementet përbërëse të fuqisë, nëpërmjet të cilave mund të përballeni dhe mund të mposhtni të gjitha fuqitë e botës.

O ti oqean i madh dhe i pafund myslimanësh!

Mbështetuni te Allahu dhe nënshtrojuuni Atij, sepse kjo është mënyra e vetme që Allahu t'ju ndihmojë. Ngrihuni të gjithë bashkë dhe shkatërrojini armiqtë e njerëzimit. Për sa kohë do të ndiqni rrugën e drejtë të Allahut dhe mësimet e Kur'anit Famëlartë, nuk ka fuqi në botë t'ju nënshtrojë dhe pa më të voglin dyshim, llojet dhe format e ndryshme të ushtrive të Allahut do të jenë në krahun tuaj.

BASHKIMI NË NAMAZIN ME XHEMAT, ME VËLLEZËRIT SYNITË

Kryeni tauafin (rrotullimin) rreth Qabesë sipas rregullave dhe normave të mirënjohura të tauafit. Hiqni dorë prej disa llojeve të tauafit apo prej disa punëve përçarëse, që i kryejnë një pjesë e të paditurve dhe e injorantëve. Hiqni dorë prej punëve, që kanë për synim të tregojnë se ju i përkisni një shkollë të veçantë të Islamit. Hiqni dorë prej atyre veprave që e dobësojnë Islamin dhe bashkë me të edhe medh'hebin tuaj. Ndjekja e gjykimit dhe e dispozitës së lidhur me medh'hebin e Ehli Synetit është e pranueshme, për sa kohë nuk ka për këtë një ndalesë të dukshme, të prerë dhe të qartë.

Është e nevojshme dhe kërkohet prej vëllezërve tanë iranianë dhe pasues të Shi'izmit, që të shmangin të gjitha punët dhe veprat e kohës së injorancës, që mund të shkaktojnë konflikte, tensione dhe përçarje me vëllezërit tanë të Ehli Synetit. Duhet të jeni të pranishëm në rituale, në krah të Ehli Synetit. Duhet të faleni bashkë, me të gjithë myslimanët e tjerë dhe të shmangni faljen me xhemat nëpër shtëpitë dhe vendbanimet tuaja në tokat e shenjta. Duhet të shmanget përdorimi i altoparlantëve, me qëllim

ngritjen e zërit, në kundërshti me rregullat e mirënjohura dhe të mirëpërcaktuara të vendit. Kërkohet prej të gjithë haxhinjve të nderuar, që të shmangin hedhjen përmbi varre nëpërmjet formave të papranueshme dhe të shëmtuara, të cilat nuk i lejon feja jonë e pastër.

KAPITULLI I TRETË

DIMENSIONI POLITIK I HAXHIT

“Prej ngarkesave më të mëdha filozofike të Haxhit, është dimensionimi politik i tij.”
Imam Khomeini (Zoti qoftë i kënaqur me të!)

RËNDËSIA E DIMENSIONIT POLITIK TË HAXHIT

Nuk ka dyshim se njëri prej dimensioneve më të rëndësishme të Haxhit, është dimensionimi politik i tij. Kjo është një çështje shumë e rëndësishme, kundër të cilës armiqtë e Islamit kanë punuar shumë dhe janë përpjekur që ta fshijnë, ta shuajnë, ta zbehin sa më shumë dhe ta shkulin nga rrënjët. Fatkeqësisht, propaganda e tyre ka gjetur praninë të një shtresë e gjerë e masave myslimane, pasi shumë prej tyre janë të mendimit se, të udhëtosh për në Haxh, është një vizitë apo një udhëtim adhurimi rutinë, i lidhur me disa rituale të thata, jo gjithmonë të kuptueshme, hera-herës shumë të vështira, që nuk kanë kurrfarë lidhje me interesat e myslimanëve dhe me format e bashkëpunimit dhe të bashkimit midis tyre. Shumë

muslimanë nuk mund ta përfytyrojnë dhe nuk mund ta imagjinojnë se si Haxhi mund të jetë i lidhur me interesat e muslimanëve. Nuk ka dyshim se, që prej ditës në të cilën Allahu e ka bërë Haxhin një obligim për të gjithë muslimanët, dimensionit i tij politik nuk ka qenë kurrë i shkëputur prej dimensionit të tij adhures dhe njëkohësisht nuk mund të ketë qenë më pak i rëndësishëm se ai. Referuar këtij pohimi, mund të themi pa pasur drojë se, përveç dimensionit të pastër politik, që përfaqëson Haxhi, politika, në vetvete, kur ndërtohet mbi të tilla themele dhe qëllime të shenjta, është në vetvete adhurim.

Po të analizojmë me vëmendje gjendjen e muslimanëve në mbarë botën, do të konstatojmë me dhimbje se dimensionit politik i Haxhit është prej dimensioneve më të nëpërkëmbura dhe më të braktisura prej të gjithë muslimanëve. Duart e injorantëve dhe të armiqve të Islamit, në bashkëpunim me shërbëtorët e tyre në mesin e muslimanëve, kanë punuar vazhdimisht dhe vazhdojnë të punojnë edhe në ditët tona, për ta lënë të braktisur këtë dimension të Haxhit, për ta lënë të mbuluar prej pluhurit të nënvlerësimit dhe të harresës.

Është detyrë e të gjithë muslimanëve të ndershëm, që, në këto ditë të vështira, nëpër të cilat është duke kaluar Islami, në këto ditë, që me të drejtë mund të cilësohen si shekulli i ligjeve të pyllit, të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre dhe t'i kthejnë Islamit dhe, në veçanti Haxhit, një

dimension kaq të rëndësishëm dhe kaq me vlerë, që është dimensionin politik.

Myslimanët sot, kanë si detyrë, më shumë se në çdo kohë tjetër, që t'i kthejnë Haxhit dimensionin politik, si paradhomë dhe parakusht për të ringjallur thellë mendjeve dhe qenieve të tyre vetëdijen politike. Duhet të jemi të vetëdijshëm sot, më shumë se kurrë, se lojtarët e mëdhenj të politikave botërore shpenzojnë të gjitha mundësitë dhe energjitë e tyre, që të zhveshin myslimanët dhe ritualin e rëndësishëm të Haxhit prej dimensionit politik. Është prej interesave të tyre të mëdha, që t'i lenë myslimanët të mënjanuar dhe të zhytur në injorancë, si mënyra më e mirë dhe më e lehtë për t'i sunduar ata. Kjo, nga njëra anë.

Nga ana tjetër, jo më pak të rrezikshëm se të parët, janë edhe bashkëpunëtorët e tyre interesaxhinj në mesin e myslimanëve, të cilët janë të gatshëm të shesin fenë e tyre për interesa të ngushta personale, qofshi këto interesa materiale apo interesa të lidhura me karrierën dhe çështje të ngjashme me këto. Përveç elementeve të mësipërme vëmë re, njëkohësisht, një padituri të theksuar në mesin e masave të myslimanëve.

Nga ana tjetër, prekim dhe konstatojmë me dhimbje rolin manipulues të dijetarëve të pushtetit (dijetarët që e manipulojnë fenë sipas interesave të pushtetarëve), të cilët janë përpjekur vazhdimisht ta zhveshin Haxhin prej këtij dimensionin kaq të rëndësishëm. Grupimeve të mësipërme mund t'u bashkëngjisim njëkohësisht edhe

keqinterpretuesit e fesë dhe padronet e mendjeve të liga, të cilët janë të specializuar për të manipuluar masat dhe për të deformuar kuptimet e vërteta të tekstit që duket qartë dhe nuk ka hapësira për manipulim. Këtyre kategorive u bashkëngjitet, gjithashtu, edhe një masë shumë e madhe dhe shumë e paditur e vetë adhuruesve, që i kryejnë këto rituale të shenjta. Kjo masë e gjerë njerëzish, fatkeqësisht, e ka shumë të vështirë të kuptojë dhe të perceptojë të tilla dimensione politike. Si mund të jenë ato të lidhura me një ritual të pastër adhurimi?

Të gjitha këto kategori kanë ndihmuar njëra-tjetrën për të fshirë, për të zbehur dhe për të zhdukur përfundimisht dimensionin politik të Haxhit dhe, më pas, janë po të njëjtat kategori që përpiqen të japin leksione rreth të ardhmes së popujve të shtypur dhe mënyrat e çlirimit prej prangave të nënshtrimit, të pushtimit dhe të skllavërisë ndërkombëtare.

Është detyrë e të gjithë myslimanëve të ndershëm dhe e besimtarëve të devotshëm, të cilëve u djeg zemra për këtë Islam për prapambetjen dhe për boshllëqet e mëdha që myslimanët kanë, në raport me zhvillimin dhe historinë, që të mobilizohen, të koordinojnë energjitë e tyre dhe të ringjallin edhe njëherë këtë dimension kaq të rëndësishëm të Haxhit, sepse dimensionin politik është përfaqësues i dimensionit më të rëndësishëm dhe më ndikues të këtij rituali të shenjtë.

Është detyrë madhore e këtyre njerëzve të ndershëm, që të ngrihen në këmbë dhe të mobilizojnë masat e myslimanëve nëpërmjet fjalimeve të tyre, nëpërmjet ligjëratave, shkrimeve, librave dhe gjithçkaje tjetër që ka ndikim të mendjet dhe të zemrat e njerëzve. Ky angazhim është mirë të ndodhë gjatë kohës kur myslimanët janë duke e kryer Haxhin, ose menjëherë pas kthimit të tyre prej vendeve të shenjta të vendet e tyre, pasi në këto momente gjendja e tyre shpirtërore dhe mendore është e prirur të jetë më e hapur dhe më pranuese e këtyre kuptimeve të rëndësishme.

Duke e ngjallur këtë dimension kaq të rëndësishëm të Haxhit të masat e myslimanëve, do të jetë një hap shumë i madh dhe shumë i rëndësishëm në drejtim të mobilizimit të popujve të tjerë të shtypur të botës dhe çlirimit të tyre prej prangave të pamëshirshme të pretenduesve të paqes, të zhvillimit, të modernitetit të lirisë dhe të demokracisë, trysnia dhe pesha e të cilave shtohet çdo ditë e më shumë.

Është më shumë se i qartë fakti se, nëse myslimanët nuk do të arrijnë të mobilizojnë ndërgjegjen e pjesës së shtypur, të pushtuar dhe të nëpërkëmbur të tyre në këtë organizim dhe tubim kaq madhështor adhurimi sa është Haxhi, asnjë mënyrë tjetër nuk do të jetë e suksesshme. Nëse myslimanët nuk do të arrijnë të bashkojnë, të ndërgjegjësojnë dhe të mobilizojnë në këtë tubim madhështor, pjesën tjetër të myslimanëve të shtypur të botës, pavarësisht përkatësisë së tyre etnike, kombëtare,

gjuhësore apo gjeografike, nëse ata nuk do të arrijnë t'i ftojnë këta popuj të shtypur e të poshtëruar, që të ngrihen kundër padrejtësive dhe të zëvendësojnë zullumqarët dhe pushtetarët grabitqarë e gënjeshtarë, nëse nuk do të arrijnë të ngrenë në këmbë vullnetet e myslimanëve të botës në ato vende të shenjta, ku janë mbledhur të gjithë bashkë për t'iu përgjigjur thirrjes së unitetit dhe të Teuhidit, ku të gjithë ndihen të barabartë, brenda të njëjtës Shtëpi, brenda të njëjtës gosti dhe të veshur të gjithë njëlloj, sigurisht që nuk do të arrijnë ta realizojnë këtë nëpërmjet mbledhjeve e takimeve në vendet e tyre, sado të mëdha dhe të organizuara qofshin ato mbledhje. Nëse këto qëllime të mëdha nuk arrihen gjatë kohës së Haxhit, është thuajse e pamundur të realizohen në ndonjë kohë tjetër. Rrjedhimisht, nuk do të mundemi të japim zgjidhje për asnjë prej halleve tona dhe halleve të myslimanëve.

Shtëpia e Shenjtë e Allahut është shtëpia e parë e njerëzimit. Ajo është Shtëpi që i përket të gjithë anëtarëve të njerëzimit dhe asnjë fis, asnjë komb, asnjë racë dhe asnjë sistem politik nuk ka përparësi ndaj pjesës tjetër të njerëzve. Të gjithë njerëzit atje janë të barabartë. Banorët e shkretëtirave, të cilët janë vazhdimisht në lëvizje dhe mbartin mbi supet e tyre shtëpitë portative, janë të barabartë në Shtëpinë e Allahut, me banorët e qyteteve, me shtresat e ngritura dhe me mbretër, qeveritarë dhe pushtetarë. Kjo Shtëpi është për të gjithë njerëzit dhe në interes të të gjithëve.

Kjo Shtëpi është gjendur dhe është ndërtuar në funksion të zhvillimit të gjithë njerëzimit, pa asnjë dallim. Ndaj të gjithë njerëzit duhet të përfitojnë prej saj.

Cili mund të jetë ai përfitim më i madh, më i lartë dhe më i shenjtë, se sa të mundemi të shpëtojmë popujt e shtypur, të pushtuar dhe të nënshtruar dhe t'i çlirojmë ata prej kthetrave të fuqive të errëta, që nuk ngopen duke i shtypur e duke i skllavëruar popujt?! Cili mund të jetë ai triumf më i madh, se sa t'u kthejmë mundësinë popujve dhe shteteve të nënshtruara të botës, që të jenë vetëadministratorë të burimeve dhe të pasurive të tyre?!

Qëllimi i ndërtimit të kësaj Shtëpie të Shenjtë është për të ngritur popujt, për t'i mësuar si t'i nënshtrohen vetëm Krijuesit të botëve dhe asnjë fuqie tjetër përveç Atij, si dhe për t'i zhvilluar ata. Referuar pohimeve të mësipërme, ky grumbullim i madh njerëzish në Haxh duhet të vihet në funksion të realizimit të qëllimit madhor kryesor për të cilin u gjend edhe Shtëpia e Shenjtë e Allahut të Madhëruar. Kjo është e vetmja mënyrë nëpërmjet të cilës mund të realizohen interesat e mëdha të njerëzve, për të cilat Allahu i Madhëruar i ka lidhur me kryerjen e Haxhit. Kjo është e vetmja mënyrë për të gurëzuar llojet dhe format e ndryshme, nëpërmjet të cilave shfaqen djajtë, qofshin këta të vegjël apo të mëdhenj. Të ndërtosh Shtëpinë e Shenjtë të Allahut, ta zbukurosh atë, ta mirëmbash dhe të shuash etjen e haxhinjve, duke i dhënë

ujë për të pirë, nuk ka asnjë lidhje me qëllimin kryesor për të cilin është ndërtuar Shtëpia e Allahut.

Që Shtëpia e Shenjtë e Allahut të mbetet ashtu siç ka qenë në kohën e Ibrahimit (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*), me kushtin që haxhinjtë e të gjithë botës të takohen me njëri-tjetrin, të diskutojnë dhe të trajtojnë çështjet më të rëndësishme të ymetit dhe të vihen në kërkim të zgjidhjeve të tyre, është mijëra herë më e mirë, se sa të zbukurohet Qabeja, të ndërtohet, të zgjerohet, të zmadhohet dhe të mbulohet prej floririt, argjendit dhe formave të tjera të luksit.

Cila është vlera e këtyre zbukurimeve dhe e këtyre investimeve, për sa kohë kemi mbuluar, kemi zbehur me vetëdije dhe kemi lënë të mbuluar prej pluhurave të harresës, dimensionet e tjera më të rëndësishme të Haxhit, për të cilat është ndërtuar Shtëpia e Shenjtë?!

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlratë:

“أَجَعَلْتُمْ سِقَايَةَ الْحَاجِّ وَعِمَارَةَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ كَمَنْ أَمَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَحَاهَدَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ

لَا يَسْتَوْوُونَ عِنْدَ اللَّهِ وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ

“Vërtet mendoni se ai që u jep ujë haxhinjve dhe mirëmban Xhaminë e Shenjtë është njësoj me atë që beson në Allahun dhe Ditën e Fundit dhe që lufton në rrugën e Allahut?! Këta nuk janë të njëjtë para Allahut. Ai nuk i udhëzon në rrugë të drejtë njerëzit keqbërës.”⁹

⁹ Surja “Et Teube”, ajeti 19.

I lartësuar qoftë Allahu! Ajeti i sipërpërmendur kur'anor duket sikur të ketë zbritur posaçërisht për ditët tona. Duket shumë realist në përshkrimin e gjendjes në të cilën ndodhen myslimanët në ditët tona. Kjo është situata në të cilën gjendet sot Qabeja e Shenjtë. Ka një interesim të madh për ta ndërtuar, për ta zbukuruar, për të investuar në pamjen e saj të jashtme, për t'u dhënë për të pirë ujë të freskët haxhinjve, por, në të njëjtën kohë, ka një harresë dhe nënvlerësim të plotë lidhur me besimin te Allahu i Madhëruar dhe te Dita e Fundit. Kemi një interesim shumë të madh për dimensionet sipërfaqësore të Haxhit, por kemi njëkohësisht një harresë të plotë lidhur me dimensionin e luftës dhe të përpjekjeve për të rikthyer dinjitetin e myslimanëve në botë.

Në fakt, kjo mund të konsiderohet prej padrejtësive më të mëdha. Të gjithë ata që, me ose pa dashje, investojnë në zbehjen e këtyre dimensioneve të shenjta të Haxhit, mund të konsiderohen prej zullumqarëve dhe njerëzve që kanë kryer padrejtësi të mëdha. Të besosh Allahun dhe Ditën e Fundit, do të thotë të luftosh dhe të sakrifikosh gjatë gjithë jetës tënde për hir të Allahut dhe ditës së Fundit. Të besosh Allahun dhe Ditën e Fundit, do të thotë të vlijë mendja, gjaku, trupi dhe shpirti për hir të fesë së Allahut dhe qëllimeve madhore të saj. Të besosh, do të thotë të mbulosh tokën me mirësi dhe drejtësi. Përfundimisht, Allahu i Madhëruar nuk mund t'i ndihmojë dhe nuk mund t'i orientojë kah udha e mbarë

njerëzit që kanë hequr dorë me vetëdije prej këtyre kuptimeve dhe dimensioneve të shenjta, pasi ata konsiderohen prej zullumqarëve.

Këto ditë janë ditë të shenjta të Haxhit dhe Shtëpia e Allahut vizitohet prej myslimanëve, që vijnë nga skajet e ndryshme të botës. Për këtë arsye, të gjithë myslimanët janë të ftuar dhe janë të lutur që, përveç dimensioneve adhuresë të këtij rituali të rëndësishëm dhe të shenjtë, të përpiqen sa të munden të realizojnë edhe disa prej dimensioneve filozofike dhe politike, më të rëndësishme të këtij tubimi madhështor.

Një prej detyrave më të rëndësishme, që bie mbi supet e haxhinjve të nderuar, është që të konsultojnë ndërmjet tyre, të studiojnë dhe të analizojnë gjendjen shoqërore dhe politike të myslimanëve në vende të ndryshme të botës. Është detyrë që të njihen nga afër me vështirësitë, vuajtjet dhe sakrificat e vëllezërve të tyre në besim, të vendeve të tjera të botës. Është prej detyrave më të rëndësishme të vizitorëve të vendeve të shenjta, që të angazhojnë të gjitha burimet morale, shpirtërore dhe materiale që kanë në dispozicion, për të ndihmuar vëllezërit e tyre myslimanë të vendeve të tjera, pasi kjo është një detyrë parësore dhe madhore islame, përpara se të jetë përpjekje humane dhe njerëzore.

Të interesohesh për gjendjen e myslimanëve në botë është prej çështjeve parësore, për të cilat duhet të interesohet çdo mysliman dhe besimtar i sinqertë në botë.

HAXHI ËSHTË MUNDËSI PËR VETËDIJESIM POLITIK

Pas përshëndetjes dhe selamit për haxhinjtë tanë të nderuar, Allahu i ndihmoftë dhe i begatoftë, kam dëshirë të theksoj se, për shkak të mosinteresimit dhe të nënvlerësimit të popujve myslimanë, në ditët e sotme, pushtuesit dhe fuqitë e errëta kanë mundur të shtrijnë duart e tyre të poshtra te hapësirat dhe sipërfaqet e pafundme të popullit të Kur'anit, në mbarë botën. Nëpërmjet hileve, intrigave dhe planeve të tyre djallëzore, ata kanë mundur të kenë tashmë në zotërimin e tyre të plotë pasuritë e jashtëzakonshme të myslimanëve.

Sot jemi të gjithë të vetëdijshëm se kultura e pushtuesve dhe e armiqve të ymetit është shtrirë shumë dhe ka depërtuar thellë mendësive dhe shoqërive myslimane, në mbarë botën. Nëpërmjet strategjive të sofistikuar, armiqtë e Islamit dhe të ymetit mysliman kanë mundur të depërtojnë deri te thellësitë ekstreme të qyteteve dhe të fshatrave tona. Nëpërmjet planeve të tyre të errëta, ata kanë mundur ta përjashtojnë Kur'anin prej jetëve të njerëzve, duke mos lejuar që ai të ketë rol qendror në jetët e njerëzve. Kësisoj, ata kanë mundur të përgatisin brezat e njëpasnjëshëm të myslimanëve, duke i programuar ata sipas formatit që dëshirojnë, si dhe duke i

vënë në shërbim të planeve dhe strategjive të tyre për vendet dhe popujt myslimanë.

Çdo ditë që kalon, ata sajojnë forma, melodi dhe mënyra nga më të përsosurat, për të gënjyer dhe për të mashtruar rininë tonë. Është detyra juaj, besimtarë dhe besimtare, myslimanë dhe myslimane, që të mblidheni në tokat e shenjta për të kryer ritualet e shenjta, që të diskutoni, të analizoni dhe të përpiqeni të dilni me zgjidhjet dhe rekomandimet përkatëse për ymetin, në mënyrë që gjendja e tyre dhe veçanërisht e rinisë myslimane të ndryshojë. Është prej detyrave më të rëndësishme të myslimanëve të mbledhur nga e gjithë bota, të bashkërendojnë problematikat e secilit vend mysliman dhe të përpiqen të japin për to zgjidhjet dhe rekomandimet e nevojshme.

O ju popull i shtrenjtë mysliman!

Duhet të jeni të kujdesshëm dhe të mos harroni kurrë, se prej detyrave më të rëndësishme të myslimanëve, në këto ditë të shenjta, në këto toka të shenjta, vizitën e të cilave Allahu i Madhëruar e ka bërë obligim një herë në vit, është padyshim angazhimi dhe mobilizimi i plotë për të realizuar qëllimet më të larta islame dhe synimet kryesore të Sheriatit të pastër Islam. Kjo është mënyra e vetme për të realizuar ngritjen e myslimanëve dhe bashkimin ndërmjet të gjitha shoqërive islame.

Jeni të gjithë të ftuar të bëheni një dorë e vetme, të bashkuar, rreth qëllimeve dhe idealeve të shenjta të

përbashkëta, si e vetmja rrugë dhe mundësi për të shkukur prej trupit të ymetit kancerin e pushtimit, të nënshtrimit dhe të skllavërisë. Pasi të jeni njohur nga afër me hallet, problematikat dhe me dhimbjet e secilit popull mysliman, jeni të gjithë të detyruar të përpiqeni dhe të bëni gjithçka është e mundur për të gjetur zgjidhjet e përshtatshme për problematikat e vëllezërve tuaj.

Mos i nënvlerësoni dhe mos u tregoni të ngathët dhe pasivë, në raport me hallet e vëllezërve tuaj. Është detyra juaj, që të mendoni në mënyrë të pandërprerë, për zgjidhjen e skamjes dhe të varfërisë së vëllezërve tuaj. Është detyra juaj, që të mendoni në mënyrë të pandërprerë për të zgjidhur hallet e nevojtarëve të tyre. Është detyra juaj, të mendoni seriozisht se çfarë duhet bërë dhe si mund të realizohet kthimi i tokave të shenjta islame të Palestinës sonë të dashur. Është detyra juaj, që të mendoni si do ta shpëtojmë Palestinën tonë të shtrenjtë prej pushtimit gjakatar të sionistëve, si përfaqësuesit e armikut më të madh të myslimanëve dhe të mbarë njerëzimit.

Është detyra juaj, që të gjeni format dhe mënyrat e përshtatshme për të ndihmuar heronjtë e atij populli qëndrestar, që ka sakrifikuar dhe vazhdon të sakrifikojë pa u ndalur gjithçka të shtrenjtë për çlirimin e Palestinë. Mos i lini kurrë vetëm ata luftëtarë të mëdhenj! Mos i lini kurrë vetëm ata heronj!

Është detyrë e të gjithë mendimtarëve dhe e dijetarëve të ymetit, që marrin pjesë në këtë tubim

madhështor të përvitshëm të myslimanëve, që të diskutojnë me njëri-tjetrin mënyrat e zgjidhjes së kësaj çështjeje kaq të rëndësishme të ymetit. Është detyrë e tyre, që në përfundim të ritualeve të shenjta, të dalin me deklarata dhe qëndrime të përbashkëta, lidhur me këtë problematikë dhe më pas t'i transferojnë ato qëndrime, ato vendime dhe ato deklarata te popujt e tyre, kur të kthehen te ata.

PËRGATITNI RAPORTE

Në këtë tubim të madh dhe të shenjtë të myslimanëve, është e nevojshme, pikësëpari, që të trajtohen çështjet kryesore dhe më të rëndësishme të myslimanëve. Më pas duhet të zhvillohen konsultime rreth problematikave të lidhura me specifikat e secilit vend mysliman. Është detyra juaj të ndaleni dhe të analizoni me kujdes se cili është aktiviteti i imperializmit dhe natyra e tij te secili vend islam. Është shumë e nevojshme, gjithashtu, që myslimanët e secilit vend të botës të paraqesin raporte të qarta dhe të përgatitura me kujdes, nëpërmjet të cilave të venë në dijeni dhe të informojnë pjesën tjetër të myslimanëve të botës, rreth gjendjes në të cilën ndodhen. Është e rëndësishme që myslimanët në mbarë botën, të njihen nga afër me hallet, vuajtjet dhe vështirësitë e vëllezërve të tyre, kudo që ata janë.

IMPERIALIZMI I DRUHET BASHKIMIT TUAJ

Shumë të dashurit dhe shumë të nderuarit haxhinj!

Jeni mbledhur nga të katra anët e botës, për të diskutuar krah për krah njëri-tjetrit. Jeni mbledhur për të diskutuar, për të shkëmbyer këndvështrimet e ndryshme, në kërkim të zgjidhjeve më të përshtatshme për problemet dhe hallet e myslimanëve në vendet nga vini. Është detyrë madhore e juaja, që të ndërmerrni hapat e nevojshme, në funksion të zgjidhjes së atyre problemeve dhe në funksion të realizimit të qëllimeve të shenjta dhe madhore të Islamit.

Është detyrë e juaja, vëllezërit e mi të dashur, që të bëni gjithçka është e mundur për të arritur bashkimin ndërmjet shkollave të ndryshme të juridiksionit islam. Është detyra juaj, që të gjeni format e përshtatshme për t'i bashkuar myslimanët me njëri-tjetrin, pavarësisht përkatësive dhe shkollave që u përkasin.

Një prej punëve dhe angazhimeve më të rëndësishme, që duhet të ndërmerrni gjatë atyre ditëve të shenjta, është të diskutoni dhe të përpiqeni maksimalisht në gjetjen e formulave të përshtatshme të bashkëpunimit, lidhur me çështjet e përbashkëta politike të grupimeve dhe sekteve të ndryshme të myslimanëve.

Vihuni në kërkim të zgjidhjeve të problemeve, që i kanë shkaktuar armiqtë e Islamit myslimanëve në mbarë

botën. Më e rëndësishmja, është padyshim përçarja dhe nxitja e urrejtjes ndërmjet grupeve të ndryshme të myslimanëve. Është në dijeninë e të gjithëve se fuqitë e errëta, në Lindje dhe në Perëndim, që kanë për synim të gllabërojnë pasuritë e popujve dhe t'i skllavërojnë ata, kanë kohë që përgatisin planet dhe strategjitë e tyre të errëta, me qëllim ndezjen e flakëve të përçarjes dhe të urrejtjes ndërmjet myslimanëve, si e vetmja mënyrë për të mbajtur të ndarë, të dobët dhe të përçarë një miliard njerëz që i përkasin një besimi të vetëm.

Është në dijeninë e të gjithëve se këto forca të errëta janë duke bërë të pamundurën dhe, në funksion të realizimit të planeve të tyre djallëzore, janë duke përdorur shërbëtorët e tyre nga mesi i myslimanëve. Janë këto duar të poshtra, që investojnë fuqimisht dhe punojnë natë e ditë për të mbajtur të ndezur zjarrin e urrejtjes, të ndasive dhe të përçarjes ndërmjet myslimanëve. Kjo është e vetmja rrugë dhe mënyrë për të mbajtur nën kontroll dhe për të grabitur pasuritë e vyera dhe të pafundme të myslimanëve në mbarë botën.

Këto takime dhe këto tubime të shenjta, nuk janë rastësi adhuruese, por janë të gjendura me përkujdesjen e drejtpërdrejtë të Allahut të Madhëruar, në mënyrë që t'i shërbejnë myslimanëve për zgjidhjen e problematikave dhe çështjeve të tyre delikate.

Është vendimi i Allahut të Madhëruar dhe prej planeve madhështore të Tij, që t'i detyrojë të gjithë

muslimanët e botës, që i kanë mundësitë fizike dhe financiare, të shkojnë dhe të mblidhen në Mekën e bekuar dhe në tokat e shenjta.

Tubime të këtyre përmasave, në vendet e shenjta dhe në toka të bekuara, nuk mund të jenë rastësore dhe pa asnjë qëllim. Është prej punëve të pëlqyeshme dhe të dashura të Allahut, që edhe ata muslimanë, që nuk i kanë mundësitë për të kryer Haxhin, të mblidhen herë pas here në vende të caktuara dhe të veçuara, larg formave dhe normave protokollare dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin problematikat dhe çështjet më të rëndësishme të muslimanëve. E ku ka më bukur, se të mblidhemi herë pas here në vende të tilla, edhe në ato raste kur nuk e kemi mundësinë të kryejmë Haxhin, të mblidhemi, të vishemi vetëm me çarçafë të bardhë, t'i kujtojmë njëri-tjetrit se nuk do të marrim asgjë nga kjo botë mashtruese dhe të diskutojmë problematikat e vendeve muslimane dhe zhvillimet e tyre më të rëndësishme në vitet që kanë kaluar. Këto grumbullime, tubime e takime i kanë ngarkesat e nevojshme shpirtërore e morale, për të diskutuar dhe për t'u vënë në kërkim të zgjidhjeve për hallet e muslimanëve. Të gjithë muslimanët e botës duhet të jenë të bindur se, përveç adhurimeve, këto janë qëllimet më të shenjta, që synohen të realizohen prej tubimit madhështor të Haxhit në vendet e Hixhazit.

MUNGESA E VETËDIJES SË TË MËDHENJVE

Fatkeqësia më e madhe është se myslimanët janë larguar prej fesë së tyre dhe kanë harruar detyrat e tyre më të rëndësishme. Mendimet dhe angazhimet tona më të mëdha duhet të përqendrohen, pikësëpari, në një çështje shumë të rëndësishme. Është e nevojshme, që të gjithë myslimanët, që i kanë mundësitë, të shkojnë për të kryer ritualin e Haxhit dhe të vizitojnë Shtëpinë e Shenjtë të Zotit dhe bashkë me ta, mendimtarët, dijetarët, shkrimtarët dhe intelektualët e fushave dhe të specialiteteve të ndryshme, që të mblidhen të gjithë së bashku dhe të përpiqen të ofrojnë zgjidhje konkrete për hallet dhe problematikat e myslimanëve, kudo që ata gjenden në botë. Është detyrë po aq e shenjtë sa kryerja e Haxhit, që të zgjidhin sa të mundin prej atyre problematikave.

Në ditët e sotme vërejmë, fatkeqësisht, se pjesa më e madhe e atyre që shkojnë për të kryer ritualet e shenjta të Haxhit, i përkasin shtresave të thjeshta dhe jo shumë të shkolluara të popullsisë së myslimanëve. Edhe ata pak mendimtarë e dijetarë që shkojnë herë pas here për të kryer detyrimin e tyre fetar, janë, në më të shumtën e rasteve, të paineduar për të realizuar apo për të plotësuar këtë dimension po kaq të shenjtë dhe po kaq të rëndësishëm të këtij tubimi madhështor.

HAXHI ËSHTË MBLEDHJA E MADHE

Është shumë e rëndësishme ta dimë dhe të jemi të informuar se tubime dhe takime të tilla duhet të organizohen periodikisht edhe jashtë periudhës së Haxhit, në secilin vend islam. Këto tubime dhe takime të rëndësishme duhet të shërbejnë për të trajtuar dhe për të analizuar çështjet më të rëndësishme të myslimanëve, ku ata jetojnë. Këto takime të rëndësishme duhet të organizohen në çdo qytet dhe në çdo fshat dhe duhet të shërbejnë për të analizuar dhe për të trajtuar imtësisht të gjitha problematikat politike, shoqërore, fetare dhe ekonomike të myslimanëve. Banorët e secilit vend mysliman duhet të mblidhen nëpër xhamitë e tyre, të diskutojnë problematikat e vëllezërve të tyre dhe të përpiqen të gjejnë për to zgjidhjet e përshtatshme dhe të mundura, në varësi të llojit të problematikës dhe në varësi të specifikave kulturore, sociale dhe politike të secilit vend.

Nuk ka asnjë dyshim se namazi i xhumasë është një obligim i rëndësishëm javor i myslimanëve. Namazi i xhumasë është përfaqësuesi i njërit prej ritualeve më të rëndësishme adhuruese të javës, sikurse është njëkohësisht njëri prej tubimeve më të rëndësishme, shoqërore dhe politike të javës ndër myslimanët. Ky takim, ky tubim dhe kjo mbledhje e shenjtë e myslimanëve, që ndodh një herë

në javë, me urdhër të Allahut të Madhëruar, duhet të shërbejë për të zgjidhur hallet, problematikat dhe çështjet më të rëndësishme të myslimanëve.

Një tubim i ngjashëm me atë të xhumasë, por në përmasa më të mëdha është edhe tubimi i shenjtë i Haxhit. Takimi periodik i myslimanëve në Qabenë e Bekuar është tubimi shoqëror më i madh i të gjitha kohërave, të cilin do ta kishin të pamundur ta organizonin me këtë lehtësi dhe natyrshmëri edhe shtetet më të forta të globit. Është vullneti i Allahut të Madhëruar, sikurse është prej planeve të Tij madhështore, që t'i organizojë myslimanët me një formulë tubuese kaq të thjeshtë, njëkohësisht kaq të rëndësishme dhe kaq të dashur sa kjo. E gjitha kjo ndodh aq natyrshëm, aq thjeshtë dhe pa u nevojitur buxhete të mëdha shtetesh. Nuk nevojiten përgatitje të mëdha për një tubim të këtyre përmasave, por, fatkeqësisht, myslimanët nuk e llogarisin atë dhe nuk përfitojnë prej tij aq sa duhet.

Është e nevojshme dhe shumë e rëndësishme që myslimanët e ardhur prej vendeve të ndryshme të botës, të mblidhen në Mekë dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin gjendjet e tyre në vendet respektive. Është e rëndësishme të njoftojnë njëri-tjetrin se si i kanë marrëdhëniet dhe raportet me qeveritë dhe me pushtetarët e vendeve respektive. Është e nevojshme të studiojnë dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin se si janë raportet e qeverive të tyre me fuqitë dhe qeveritë e tjera të djallit. Është po aq e rëndësishme, të diskutojnë me njëri-tjetrin se si janë

raportet e myslimanëve me njëri-tjetrin në vendet respektive. Cila është natyra e raporteve të myslimanëve me popujt e tjerë?

Është e rëndësishme të diskutojnë natyrën e raporteve të dijetarëve të myslimanëve në vendet respektive me haxhinj të nderuar dhe dimensionet e Haxhit në përgjithësi. Të gjitha këto çështje duhet të trajtohen me vëmendjen që meritojnë, sepse kjo është arsyeja dhe qëllimi madhor i Haxhit. Dispozita e Haxhit ka pikërisht këtë qëllim. Të mblidhen myslimanët nga e gjithë bota një herë në vit, në vendet e shenjta, të diskutojnë dhe të përpiqen të gjejnë zgjidhje për problematikat dhe çështjet më të rëndësishme, që i përkasin të tashmes dhe të ardhmes së tyre.

Të gjithë myslimanët duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të kuptojnë mirë se të gjithë ata dijetarë dhe çallmamëdhenj, të shpërndarë në skajet e ndryshme të vendeve myslimane, i mësojnë myslimanët gabim dhe u tregojnë atyre se kryerja e ritualeve të Haxhit është e lidhur vetëm me dimensionet adhuruese e shpirtërore.

Të gjithë padronët e çallmave, që u thonë myslimanëve se Haxhi është i zhveshur prej dimensionit të tij politik, duhet ta dinë mirë se, nëpërmjet këtij pohimi, kanë kundërshtuar dhe kanë dëmtuar të Dërguarin e Allahut (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen tij të nderuar!*), kanë kundërshtuar traditën e kalifëve dhe pasuesve të tij, kanë kundërshtuar dhe kanë

dëmtuar traditën e imamëve tanë të ndershëm. Këta njerëz nuk e dinë dhe nuk e kanë ende të qartë se qëllimi më i madh prej udhëtimit në Haxh është pikërisht diskutimi dhe trajtimi i çështjeve të myslimanëve. Nuk ka dyshim se qëllimi madhor i këtij tubimi të shenjtë, është pikërisht njohja e myslimanëve nga e gjithë bota me vështirësitë dhe problematikat e vëllezërve të tyre myslimanë nga vendet e ndryshme të botës, duke i shndërruar përpjekjet e tyre, që synojnë të ofrojnë zgjidhje për ato problematika dhe vështirësi, si shprehjen më të lartë të solidaritetit dhe të ndjenjës së tyre vëllazërore për ta.

ARMIKU I PËRBASHKËT

Me modestinë më të madhe, më lejoni t'u drejtohem bijve dhe bijave të Islamit, që janë mbledhur për të kryer ritualet e shenjta të Haxhit në Mekën e Bekuar dhe t'u them dy fjalë:

Të gjithë ju jeni pjesë e bashkësisë njerëzore të myslimanëve, pasues dhe ndjekës të Profetit të Islamit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) dhe të udhëzimit të Kur'anit Famëlartë. Të gjithë ju keni një armik të madh, të pabesë, të përbashkët. Ky armik i madh dhe i tmerrshëm ka mundur që, nëpërmjet bashkëpunëtorëve të tij të shumtë prej gjirit të myslimanëve, nëpërmjet llojeve dhe formave më të sofistikuara mediatike, nëpërmjet shpërndarjes dhe përhapjes ndër masat e myslimanëve të gënjeshtrove dhe të shpifjeve të ndryshme, veçanërisht në kohët që po jetojmë, të pushtojë, të rrënojë, të grabisë pasuritë dhe të skllavërojë të gjitha vendet myslimane të botës. Ky armik i pabesë, i përbashkët, ka mundur të kontrollojë sot pothuajse tërësisht të gjitha pasuritë e jashtëzakonshme të myslimanëve, sikurse ka arritur të nënshtrojë të gjithë anëtarësinë e ymetit, duke e shndërruar atë, me miratimin e qeveritarëve myslimanë, thjesht në tregje, të cilat

shërbejnë për të shitur dhe për të konsumuar mallrat që i prodhojnë ata. Nëpërmjet intrigave të tyre të mëdha dhe nëpërmjet kurtheve të tyre djallëzore, fuqitë e errëta antinjerëzore kanë arritur t'i skllavërojnë plotësisht popujt myslimanë, duke ndaluar, duke shkatërruar që në gjenezë, duke manipuluar dhe duke sabotuar të gjitha përpjekjet e popujve të vuajtur për t'u zhvilluar, për t'u ngritur, për t'u qytetëruar dhe për të çuar përpara përpjekjet e tyre për të qenë vende prodhuese. Të gjitha planet e tyre të errëta vihen në funksion të gjetjes së klimës së vartësisë së myslimanëve prej Lindjes ose prej Perëndimit.

Është e ndaluar që ata të jenë të pavarur. Është e ndaluar që ata të zhvillojnë vendet dhe industrinë e tyre të llojeve të ndryshme. Është e ndaluar që ata të zhvillohen e të qytetërohen. Është e ndaluar të kenë mendimet e tyre të pavarura. Punohet me të gjitha mënyrat dhe mjetet, që edhe mendimi të jetë njëlloj me Lindjen ose me Perëndimin. Nuk është e mundur që të mendosh ndryshe nga ata. Nuk lejohet për shpirtat e lirë dhe krijues, që kanë dëshirë të zgjojnë popujt e tyre, që të shprehen. Mendimet dhe idetë e tyre duhet t'i fshehin në kraharorë, sepse është e ndaluar që populli të njihet me to.

Ju të gjithë jeni dëshmitarë të gjendjes së popujve myslimanë në mbarë botën. Gjendja e tyre është njëlloj kudo. E, pra, ky është rezultati i natyrshëm i kurtheve dhe i intrigave të ngritura prej armiqve tanë të përbashkët.

Të gjithë bashkë jeni mbledhur sot në qendrën më të rëndësishme të myslimanëve në botë, duke iu përgjigjur ftesës së Allahut dhe të Dërguarit të tij. Jeni mbledhur sot, të gjithë bashkë, pavarësisht racave, kombeve, gjuhëve dhe ngjyrave të lëkurës, në vendin më të shenjtë të myslimanëve dhe detyra më e madhe për të gjithë ju është pikërisht kjo: Të shkulni këtë kancer prej trupit të ymetit, që të shpëtojme njëherë e përgjithmonë prej vuajtjeve dhe prej dhimbjeve që na shkakton ai.

PËRMIRËSONI GJENDJEN E QEVERTARËVE TUAJ

Është prej detyrave më të rëndësishme të myslimanëve, që të punojnë fort dhe të vihen në kërkim të mënyrave dhe të formave më të përshtatshme për të ushtruar trysinë e duhur, me qëllim përmirësimin e drejtuesve dhe qeveritarëve të vendeve islame. Pjesa më e madhe e tyre, janë, fatkeqësisht, të shitur dhe janë vënë pa kushte në shërbim të interesave të armiqve të Islamit dhe të myslimanëve. Kërkohet prej myslimanëve, në të gjithë botën, që të këshillojnë liderët e tyre dhe, nëse këshilla është e pafuqishme për të ndryshuar gjendjen, të ushtrojnë format e tjera të trysisë dhe të kërcënimit popullor, në mënyrë që të zgjohen prej gjumit të thellë në të cilin kanë rënë. Kjo është e vetmja mënyrë për të mbrojtur interesat e vendeve dhe të popujve tuaj prej shkatërrimit. Është detyrë e popujve myslimanë, që t'i kërcënojnë hapur këta qeveritarë të shitur te interesat e fuqive të errëta. Duhet bërë gjithçka është e mundur, që këta qeveritarë të zgjohen prej gjumit të tyre dhe të bëjnë kujdes nga bashkëpunëtorët e tyre hipokritë, që i rrethojnë, pasi ata janë tregtarët më të mëdhenj dhe sekserët më të rrezikshëm të interesave të myslimanëve te fuqitë grabitqare të Lindjes dhe të Perëndimit.

Është detyrë e shenjtë e myslimanëve, që të lidhin besën me njëri-tjetrin dhe të bashkëpunojnë ngushtë për ta përmirësuar gjendjen e rënduar në të cilën ndodhen në ditët tona. Situata është e vështirë, Islami po dobësohet dita-ditës dhe armiqtë e Islamit dhe të myslimanëve sulmojnë nga të katra anët, me qëllim grabitjen e pasurive të myslimanëve, vjedhjen e kapitaleve dhe poshtërimin e nderit të tyre.

PËRGATITUNI PËR TË LUFTUAR IZRAELIN

Kibla (vendi i drejtimit gjatë namazit) e parë myslimanëve ka rënë sot në duart e Izraelit, kjo qendër kanceroze në zemër të Lindjes së Mesme. Janë vëllezërit tanë libanezë dhe palestinezë ata që luftojnë sot me trimëri të pashembullt në mbrojtje të Palestinës dhe ujisin me gjakun e tyre tokat e shenjta. Për të ndaluar ata trima e heronj, Izraeli bën sot të gjitha përpjekjet për të mbjellë përçarjen ndërmjet myslimanëve. Është detyrë e çdo myslimani, që të përgatitet për t'u përballur dhe për të luftuar me Izraelin.

Filozofia e Haxhit duhet të ofrojë një përgjigje për thirrjet dhe ulërimat e atij popullit të shtypur dhe të gjithë popujve të tjerë të vuajtur dhe të pushtuar të botës. Tauafi (rrotullim) rreth e rrotull Qabesë do të thotë që t'i nënshtrohesh vetëm Allahut të Madhërisëm dhe të heqësh dorë prej të gjitha formave të tjera të adhurimit dhe të nënshtrimit përveç Krijuesit të Gjithësisë. Nga ana tjetër, riti i hedhjes së gurëve është, në vetvete, përfaqësuesi i gatishmërisë së qenies dhe të shpirtit për të gurëzuar të gjitha format nëpërmjet të cilave shfaqet djalli i mallkuar, qofshin këta njerëz apo xhinde.

Gjatë momentit kur jeni duke kryer procesin e gurëzimit të shejtanit në Haxh, ju jeni duke i dhënë besën Allahut të Madhëruar dhe jeni duke i premtuar Atij se do të gurëzoni, do të mposhtni dhe do të luftoni me vendosmërinë më të madhe llojet e ndryshme të djajve dhe do të nxirrni dhe do të përjashtoni prej vendeve të myslimanëve fuqitë e errëta dhe zullumqare, si përfaqësueset më të sinqerta dhe më të drejtpërdrejta të djallit të mallkuar. Bota islame, sot, është e kapur dhe mbahet peng prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Mesazhi që ju përcillni prej Tokave të Shenjta për të gjithë myslimanët e tjerë të botës, është se adhurimi, përulja dhe nënshtrimi i takojnë vetëm Allahut të Madhëruar dhe askujt tjetër përveç Tij, sado i madh dhe i fuqishëm qoftë.

Duhet të mendoni dhe më pas të veproni për të gjetur një zgjidhje për çështjen palestineze. Duhet të gjeni patjetër një mënyrë si t'i shpëtoni ato vende të shenjta të myslimanëve prej sundimit të papastërtive izraelite. Duhet të gjeni një formë dhe një mënyrë për t'i shpëtuar ato vende të dashura për zemrën e çdo myslimani prej prangave të sionizmit ndërkombëtar, si armiku më i madh i Islamit dhe i racës njerëzore.

Mos i lini kurrë vetëm. Është detyrë e të gjithë myslimanëve, që të ofrojnë llojet e ndryshme të ndihmës dhe të asistencës për të gjithë ata trima e heronj, që luftojnë në mbrojtje të Palestinës në emër të të gjithë myslimanëve të botës.

Prej detyrave më të rëndësishme të popujve myslimanë në mbarë botën është të mendojnë vazhdimisht për të gjetur format dhe mënyrat e përshtatshme për të çliruar Palestinën. Është detyrë e të gjithë popujve myslimanë, që të ushtrojnë trysninë e nevojshme dhe të demonstrojnë revoltën e tyre të madhe kundrejt të gjithë liderëve të turpit, të cilët shkojnë të nënshkruajnë paqe me Izraelin. Është detyrë e të gjithë myslimanëve të botës, që të shprehin hidhërimin dhe zemëratën e tyre të madhe në fytyrë të liderëve të turpit e të tradhtisë, të cilët i kanë shitur paturpësisht interesat e myslimanëve dhe të Palestinës, në emër të mbrojtjes së Palestinës. Është detyrë madhore e popujve myslimanë të botës, që të mos lejojnë, në asnjë mënyrë, negociatorët e turpit dhe të tradhtisë, që kryejnë prej vitesh një maratonë të gjatë udhëtimesh, pritjesh e përcjelljesh plot shtirje e falsitet, që kanë për qëllim goditjen e nderit dhe të interesave të larta të myslimanëve dhe të popullit palestinez.

Nuk ka dyshim se këta njerëz, që në pamje të jashtme shfaqen si luftëtarë dhe revolucionarë të mëdhenj, janë pikërisht njerëzit më të dobët dhe tradhtarët më të mëdhenj, të cilët e kanë shitur veten gjoja në emër të çlirimit të Kudsit dhe të Palestinës. Këta janë njerëzit që i përulen të poshtëruar Izraelit dhe Amerikës. Këta njerëz të dobët duhet ta kenë të qartë se skema e Izraelit dhe e planeve të tij gjakatare nuk ndryshon aspak me kalimin e kohës. Këta negociatorë të dobët duhet ta kenë të qartë se

gjakpirësit sionistë, si armiqtë më të mëdhenj të myslimanëve dhe të mbarë njerëzimit, nuk kanë hequr dorë për asnjë minutë nga ëndrrat dhe planet e tyre për të gllabëruar vendet e myslimanëve, të shtrira nga lumi Nil deri në lumin Euftrat.

Këta njerëz të ulët dhe të dobët, duhet ta kenë të qartë dhe duhet ta ngulisin mirë në mendje, se drejtuesit e Republikës Islamike të Iranit nuk kanë për t'u ndalur kurrë në përballjen dhe në luftën e tyre me shtetin sionist. Drejtuesit dhe liderët e Revolucionit Islamik të Iranit do të venë të gjitha energjitë e tyre në dispozicion të shkulljes prej rrënjëve të kësaj peme të fëlliqur dhe të zhdukjes së saj prej ekzistencës.

Me ndihmën e Allahut të Madhëruar, me ndihmën e myslimanëve të ndershëm nga e gjithë bota dhe me ndihmën e arsenalit të madh moral të pasuesve të Muhamed Mustafasë (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), me ndihmën e mundësive të shumëllojshme të vendeve të ndryshme islame, si dhe me ndihmën e forcave të shumta të formuara në të gjithë botën, do të mundemi ta nxjerrim Palestinën, me tokat e shenjta dhe t'i shpëtojmë ato prej kthetrave të sionistëve gjakpirës dhe të pabesë. Të gjithë bashkë do ta bëjmë Izraelin të pendohet rëndë për të gjitha krimet që ka kryer në të shkuarën.

Nga pozicioni im, ashtu siç kam paralajmëruar edhe në të shkuarën, para dhe pas Revolucionit, përsëris

paralajmërimin tim të drejtpërdrejtë, sot, rreth rrezikut të madh që i kanoset mbarë botës islame, përhapja dhe shtrirja e influencës së kësaj gjëndre kanceroze në zemrën dhe në trupin e ymetit islam.

Jam sot përpara jush për të njoftuar mbështetjen time të plotë dhe të Republikës Islamike të Iranit, e përfaqësuar me popullin dhe qeverinë e tij, për të gjithë popujt myslimanë, që luftojnë dhe bëjnë rezistencë, si dhe për të gjithë ata të rinj myslimanë të ndershëm, të cilët luftojnë për çështjen e Palestinës dhe të Kudsit. Një falënderim i veçantë shkon për të gjithë ata të rinj libanezë, të cilët kanë luftuar me trimëri të pashembullt dhe kanë mundur që me luftën, sakrificat e mëdha dhe me rezistencën e tyre heroike, të ulin në tokë hundët e pushtuesve gjakpirës të botës dhe të njerëzimit.

Thirrja ime e sinqertë shkon, gjithashtu, për vëllezërit e mi të shtrenjtë, që jetojnë dhe banojnë te territoret e pushtuara palestineze dhe te vendet kufitare, të cilët luftojnë pa u ndalur me një trimëri të pashembullt kundër pushtuesit sionist dhe i adresojnë atij goditje të dhimbshme, të njëpasnjëshme të mbështetur kryesisht në armën e besimit. Jam këtu për t'i siguruar dhe për t'i qetësuar zemrat e atyre luftëtarëve të paepur se Republika Islamike e Iranit do të jetë gjithmonë pranë jush, për t'ju ofruar, pa u kursyer, të gjitha format e ndihmës dhe të asistencës. Jam këtu për të dhënë fjalën time të nderit, se nuk keni për të qenë kurrë vetëm. Mbështetuni te Allahu i

Madhëruar dhe thirrni që t'ju vijë në ndihmë prej thellësive të qenieve tuaja, moralin e lartë islam, me të cilin janë të pajisur të gjithë pasuesit e Profetit të Islamit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). Hidhuni në sulm kundër armiqve tuaj dhe të mbarë njerëzimit dhe, krahas armëve luftarake, përdorini me mençuri armët e fuqishme të besimit, të devocionit të rezistencës dhe të devotshmërisë.

Allahu i Madhëruar ka premtuar në Kur'anin Famëlartë:

“...إِن تَنْصُرُوا اللَّهَ يَنْصُرْكُمْ وَيُثَبِّتْ أَقْدَامَكُمْ”

“O besimtarë! Nëse ndihmoni Allahun (pra çështjen e Tij), edhe Ai do t'ju ndihmojë dhe do t'ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja.”¹⁰

¹⁰ Surja “Muhamed”, ajeti 7.

ROLI I DIJETARËVE DHE I MENDIMTARËVE

Prej detyrave më të rëndësishme të dijetarëve dhe të mendimtarëve myslimanë, që marrin pjesë në kryerjen e ritualeve të Haxhit është pikërisht diskutimi mes veti dhe trajtimi i çështjeve më të rëndësishme dhe më delikate të myslimanëve. Pasi të kenë studiuar deri në detaje të gjitha këto problematika dhe të jenë konsultuar mirë me njëri-tjetrin, kërkohet të dalin me qëndrime të përbashkëta dhe në formën e përfundimeve të shtrydhura prej kuptimeve dhe frymës së Zbulesës Hyjnore, të shpërndahen në formën e rekomandimeve për të gjithë myslimanët e botës, sapo të kthehen në vendet e tyre.

Është detyrë e këtyre mendimtarëve, intelektualëve, shkencëtarëve dhe dijetarëve, që t'i paraqesin përfundimet që kanë arritur, në formën e rekomandimeve të krerëve të shteteve të tyre, kur të kthehen. Është detyrë e tyre, që të kërkojnë prej krerëve të atyre shteteve, që të bëjnë gjithçka është e mundur, për t'i dhënë zgjidhjet e mundshme problematikave të myslimanëve dhe më pas t'i çlirojnë ata dhe popujt e shtypur të botës prej shtypjes, mjerimit dhe robërisë ndaj imperializmit dhe Fuqive të Mëdha.

Prej elementeve dhe mundësive më të rëndësishme që krijohen në Haxh është bashkëpunimi i mendimeve dhe i ideve me dijetarët, mendimtarët dhe intelektualët e

vendeve të tjera islame, sepse, ashtu siç është e mirënjohur prej të gjithëve, shumë prej atyre që quhen fuqitë e mëdha, në bashkëpunim me krerët e shteteve të ndryshme, bëjnë të pamundurën që takime apo bashkëpunime të kësaj natyre, të pengohen dhe të sabotohen që në gjenezë.

Në ato raste kur nuk arrijnë t'i ndalojnë plotësisht apo t'i sabotojnë, i ndjekin nga afër me kujdes për të parë se cilat janë synimet dhe qëllimet e vërteta të takimeve të tyre. Prej pikave më të rëndësishme të programit themelor të Republikës Islamike të Iranit ka qenë pikërisht kjo: Mbledhjet, takimet dhe bashkëpunimet periodike ndërmjet dijetarëve, mendimtarëve, shkencëtarëve dhe intelektualëve të botës islame, për të studiuar nga afër problematikat e myslimanëve në të gjithë botën, që nëpërmjet një programi të qartë dhe sipas një agjende të mirëstudiuar dhe të mirëpërcaktuar, të bëhet gjithçka është e mundur për të ofruar zgjidhjet dhe përfundimet më të mira të mundshme për zgjidhjen e atyre çështjeve dhe problematikave të shoqërive islame.

MUNGESA E VETËDIJES TE DIJETARËT

Është vërtet për t'u habitur shumë se si është e mundur që shumë prej dijetarëve dhe liderëve shpirtërorë të botës islame, e kanë të pamundur të vetëdijesohen për rolin e tyre të jashtëzakonshëm, hyjnor dhe historik, në këto kohëra të rrezikshme dhe shumë të vështira, me të cilat është duke u përballur bota islame. Është vërtet i çuditshëm dhe i pashpjegueshëm pasiviteti dhe plogështia e dijetarëve myslimanë, në këto kohë, ku njerëzimi është më i etur se kurrë për dritën dhe ngrohtësinë që përcjell morali i lartë islam dhe fryma e Zbulesës Hyjnore.

Si është e mundur, që dijetarët dhe mendimtarët tanë të nderuar ta kenë të pamundur të identifikojnë etjen dhe nevojën e madhe të popujve të ndryshëm të botës, për dritën e Islamit, edhe pse ata nuk dinë asgjë dhe nuk kanë asnjë informacion për Zbulesën Hyjnore?! Si është e mundur, që të nderuarit dijetarë të mos i vlerësojnë ashtu siç duhet mundësitë e tyre ndikuese?! Dijetarët tanë të nderuar, mendimtarët, ligjëruesit dhe imamët e nderuar, duhet ta kenë të qartë dhe të jenë të ndërgjegjshëm se i kanë të gjitha mundësitë që në shekullin e përhapjes me shpejtësi të dijeve të ndryshme dhe të qytetërimit të materializmit vrastar, të mbledhin energjitë e tyre, t'i bashkërendojnë ato, të marrin mbi supet e tyre

përgjegjësitë e mëdha hyjnore, që kanë karshi njerëzimit dhe t'i drejtojnë ata kah rruga e mbarë, kah rruga e udhëzimit dhe e shpëtimit. Dijetarët tanë të nderuar kanë sot rastin më të volitshëm për t'ia nënshtruar botën rregullave, frymës dhe dispozitave të Kur'anit Famëlartë. Është detyrë madhore e tyre, që të ndalojnë dhe t'u tregojnë kufijtë të gjitha formave të padrejtësisë, të korrupsionit, të shkatërrimit, të pushtimit dhe të skllavërisë së myslimanëve dhe popujve të shtypur të botës. Është detyrë e tyre, që të ndalojnë ndikimin dhe shtrirjen e Amerikës, të djajve të mëdhenj dhe të vegjël, te popujt dhe shoqëritë myslimane. Është obligim hyjnor i dijetarëve të nderuar, që të përveshin mëngët dhe të nisin përhapjen e dritës islame në mbarë botën, sepse i gjithë njerëzimi është i etur për dritën e Kur'anit dhe të heqin dorë prej shkrimeve lodhëse, prej deklaratave përçarëse ndërmjet myslimanëve dhe prej lëvdatave dhe poezive të bukura, që ua thurin liderëve dhe krerëve të shthurur të vendeve të tyre. Ata duhet të heqin dorë urgjentisht prej këtyre sjelljeve dhe prej kësaj norme të të jetuarit, sepse kështu bëhen shkak për largimin e njerëzve të vuajtur dhe shtresave të shtypura dhe mënjanimin e tyre prej luftës dhe betejave tona të përbashkëta, për të ndihmuar Islamin, myslimanët dhe drejtësinë njerëzore.

Vëllezërit e mi, dijetarë dhe hoxhallarë!

Është detyrë madhore e juaja dhe për më tepër obligim hyjnor, që të ushtroni të gjithë ndikimin tuaj dhe të

shpenzoni të gjitha energjitë tuaja për t'i kthyer dinjitetin, nderin dhe pozitat e larta të gjithë ymetit islam dhe pasuesve të Muhamedit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*).

Më gjithë këtë oqean të madh myslimanësh që gjenden në botë, me gjithë praninë e dritës së pashtershme hyjnore, të përfaqësuar në Kur'anin Famëlartë dhe në traditën e trashëguar prej Profetit Muhamed (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), me gjithë traditën e mrekullueshme të Imamëve tanë të ndershëm dhe të pagabueshëm (*Paqja e Zotit qoftë mbi të gjithë ata!*), a nuk është turp për dijetarët, mendimtarët dhe shkencëtarët myslimanë, që vendet islame të vazhdojnë të udhëhiqen dhe të gjykohen prej ligjeve të kufrit, të mohimit dhe të padrejtësisë? A nuk është turp për këta dijetarë, që vendet islame të vazhdojnë të jenë nën sundimin dhe nën ndikimin e drejtpërdrejtë të këtyre ligjeve dhe të autorëve të tyre idhujtarë e femohues?! A nuk është turp për myslimanët, që të vazhdojnë deri në ditët e sotme, që të jenë nën ndikimin e hipokritëve, të cilët përpiqen vazhdimisht të falsifikojnë Islamin dhe dispozitat e tij, duke i vënë ato në shërbim të interesave të tyre të ulëta dhe të armiqve të myslimanëve?! Është detyrë e dijetarëve tanë të nderuar, që të paralajmërojnë dhe t'u kujtojnë vazhdimisht popujve dhe ndjekësve të tyre për pasojat e tmerrshme dhe të dhimbshme që ka rënia preh e joshjeve të llojeve të ndryshme, që u vijnë prej Lindjes dhe

prej Perëndimit. Është detyrë e dijetarëve tanë të ndershëm, që t'i njoftojnë popujt myslimanë për rreziqet e mëdha që mbartin format e reja të pushtimit. Është misioni i tyre i shenjtë t'u shpjegojnë popujve myslimanë planet djallëzore të armiqve të Islamit, për t'i hedhur myslimanët në luftë kundër njëri-tjetrit, sepse përçarja është mënyra më e mirë për të sunduar.

Jam i vendosur t'ju rikujtoj edhe njëherë se mbarë bota dhe mbarë njerëzimi është sot më i etur se kurrë për dritën e Islamit dhe të Kur'anit.

Zoti im! Dëshmo se unë e kam përcjellë mesazhin tim dhe argumenti është bërë detyrues për të gjithë dijetarët e Islamit dhe mendimtarët e tij.

Ashtu siç jeni në dijeni të gjithë, shumë prej vëllezërve tanë të shtrenjtë prej hezbollahëve në Liban dhe në vende të tjera islame, luftojnë dhe përpiqen me heroizëm të rrallë, me trimëri dhe vendosmëri të madhe, kundër armiqve të ymetit dhe të Islamit. Duke parë këtë situatë dhe duke iu referuar këtyre skenave të lavdishme, çfarë u mbetet justifikimeve të atyre, që vazhdojnë të mos e prishin qetësinë dhe rehatinë e tyre duke qëndruar në shtëpi, duke u marrë më fjalë boshe dhe me çështje tërësisht të pavlera?

Duhet të bëhet i ditur për të gjithë fakti se, nëse dijetarët tanë të nderuar dhe bashkë me ta njerëzit e ndershëm, të cilët i kanë zemrat dhe shpirtat e tyre të lidhura fort me Islamin, do të qëndrojnë pasivë dhe

palëvizur, koha do të na tradhtojë dhe nuk do të jetë më në anën tonë.

Sigurisht, në jemi të vetëdijshëm dhe shprehim solidarizimin tonë të plotë me dhimbjet e disa vëllezërve tanë prej dijetarëve të ndershëm dhe të devotshëm, që gjenden të bllokuar, të shtypur dhe të rrethuar nga katër anët prej armiqve të Islamit. Jemi të vetëdijshëm dhe ndiejmë bashkë me ta dhimbjen e tyre, kur përballen me llojet e ndryshme të presioneve dhe të kërcënimeve prej tiranëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre prej dijetarëve të djallit, por jemi këtu për t'u kujtuar edhe njëherë vëllezërve tanë të ndershëm këshillën e vyer të Allahut të Madhëruar, i cili thotë kështu në Kur'anin Famëlartë: *أَلَمْ تَقُومُوا لِلَّهِ مِثْلَ خِيَارِكُمْ أَيُّ صَاحِبِ الْمَعْنَىٰ أَلَمْ يَأْتِكُمْ نُبُوءٌ مِنْ أَنْبِيَاءِكُمْ فَأَنْرَا لَهُمْ صُلُوْبَهُمْ وَلَيَالِيَهُمْ هَٰذَا صِرَاطٌ مُسْتَقِيمٌ...؟*

“...ngrihuni sinqerisht për Allahun, dy e nga dy, ose një e nga një...”¹¹

Ngrihuni në këmbë për hir të Allahut dhe mos iu druani vetmisë. Mos i kini frikë armiqtë e Allahut, sepse xhamitë tuaja janë mburojat tuaja më të fortifikuara dhe se namazi i xhumasë me xhemat është tubimi dhe vendtakimi më i madh dhe më i rëndësishëm, që shërben për të diskutuar, për të shqyrtuar dhe për të piketuar me kujdes interesat madhore të myslimanëve.

¹¹ Surja “Sebe”, ajeti 46.

HAXHI I ÇUDITSHËM IBRAHIMIT

Prej çështjeve më të rëndësishme, të cilat nuk pranojnë asnjë keqinterpretim, është fakti se Islami është feja e Teuhidit (e Njehsimit), feja e shkatërrimi të formave dhe e llojeve të ndryshme të idhujtarisë. Feja madhështore islame është feja që ka në themel të dispozitave të saj shkatërrimin e të gjitha formave të idhujtarisë dhe të kufrit. Islami i ndalon rreptësisht të gjitha format e adhurimit të putave apo të egos. Ajo është feja e pastër dhe e natyrshmërisë njerëzore, që ka në themelet e saj pastrimin e qenies, të shpirtit dhe të mendjes prej të gjitha interferencave të djallit të mallkuar, edhe kur shfaqen në formën e njeriut, edhe kur shfaqen në formën e xhindeve, edhe kur shfaqen në mënyrë të hapur, edhe kur shfaqen në mënyrë të fshehur.

Feja islame është feja e politikave qytetëruese dhe e zhvillimit, që e udhëzon njerëzimin në udhën e drejtë, nën thirrjen e vërtetë "As Lindje, as Perëndim". Feja islame është ajo bashkësi normash dhe rregullash të shenjta hyjnore, në të cilat adhurimi është në vetvete politikë dhe politika është në vetvete adhurim.

Në këto ditë të shenjta, në të cilat mblidhen myslimanët nga e gjithë bota, në Qabënë e Shenjtë, për të kryer këtë ritual, këtë detyrë të madhe Hyjnore dhe për të

prezantuar në këtë kongres të madh të përvitshëm, të cilin Allahu e ka obliguar për mbarë myslimanët, në këto ditë të shenjta dhe të bekuara, një detyrë madhore lind për të gjithë ata myslimanë dhe myslimane, besimtarë dhe besimtare, të cilët mbajnë mbi supet e tyre përgjegjësitë e përcjelljes së fesë për mbarë njerëzimin dhe të përhapjes së saj në të gjitha anët e botës. Detyra e tyre madhore dhe e shenjtë është që, përveç dimensioneve adhuruese të Haxhit, të përfitojnë sa të munden prej dimensioneve politike të tij. Është detyrë e tyre të mos merren vetëm me pjesën sipërfaqësore të këtij rituali madhor dhe të shenjtë, por të hyjnë thellësive të ndritura, që i përfaqëson thelbi i tij.

Është e ditur prej të gjithëve dhe lehtësisht i kuptueshëm fakti se tubime dhe kongrese të këtyre përmasave, ashtu siç e kemi përmendur, në mënyrë të përsëritur, e kanë të pamundur ta organizojnë edhe shtetet më të mëdha dhe më të fuqishme të botës. Asnjë fuqi mbi tokë, përveç Allahut të Madhëruar, nuk mund të bëjë organizime të përvitshme të këtyre përmasave, me lehtësinë me të cilën organizohet çdo vit ky tubim madhështor i myslimanëve. Megjithatë, është për të ardhur keq se myslimanët nuk kanë mundur kurrë përgjatë historisë që ta venë në funksion të zgjidhjes së problematikave dhe çështjeve të tyre të mëdha, këtë obligim madhështor dhe të shenjtë të myslimanëve.

Në këto ditë të shenjta dhe në këto momente të shenjta, në të cilat myslimanët zhvishen prej ndikimeve dhe cytjeve të ndryshme të djallit të mallkuar, në këto çaste hyjnore, në të cilat besimtari dhe besimtarja zhvishen prej joshjeve të kësaj bote kalimtare dhe mashtruese dhe nisin rrugëtimin e shpirtit dhe të qenies për te Allahu i Madhëruar dhe i Dërguari i tij (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*); në këto ditë të mrekullueshme, në të cilat zemra e besimtarit dhe e besimtares është si një shtëpi e boshatisur dhe e braktisur prej gjithçkaje tjetër, përveç dashurisë së saj të madhe; në këto ditë, kur zemrat e tyre të pastra shkelen vetëm prej dashurisë së Krijuesit, janë ditë dhe momentet e përshtatshme për të kuptuar se Haxhi i shenjtë i Ibrahimit dhe ai i Muhamedit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi ata të dy dhe mbi familjet e tyre të nderuara!*) është braktisur dhe fatkeqësisht nuk praktikohet më prej shumë vitesh.

E vërteta tjetër e dhimbshme është se ky ritual i shenjtë është plotësisht i zhveshur jo vetëm prej dimensioneve shpirtërore, por edhe prej dimensioneve politike e shoqërore. Është detyrë e haxhinjve të shtrenjtë, që vijnë prej vendeve të ndryshme të botës, që t'i japin fund roleve dhe funksioneve jetike të Haxhit, duke i kthyer Shtëpisë së Allahut dhe Qabesë së Bekuar rolin e saj qendror në organizmin shoqëror, shpirtëror, kulturor dhe politik të jetëve të myslimanëve.

Është detyrë e adhuruesve të mëdhenj, e arifinëve dhe e eulijave të Zotit, që të shpjegojnë dhe të sqarojnë myslimanët për thesaret e shtrenjta të padukshme që përfaqëson larmia e dimensioneve hyjnore të të gjitha segmenteve dhe ritualeve adhuruese të Haxhit. Ndërsa ne të tjerët, të cilët jemi të angazhuar me dimensionet shoqërore dhe politike të tij, duhet të kemi parasysh dhe duhet t'ia rikujtojmë vazhdimisht vetes sonë, se në këto ditë që jetojmë, jemi shumë larg zbatimit dhe vënies në praktikë të këtyre dimensioneve të rëndësishme dhe të shenjta të adhurimeve në Haxh. Pasi të vetëdijsohemi dhe të kuptojmë se jemi shumë larg gjendjes në të cilën kërkon Allahu i Madhëruar prej nesh, është detyrë parësore e jona të kthehemi me shpejtësi atje ku duhet të jemi dhe të përmirësojmë gjendjet tona dhe ta korrigjojmë gjithçka ka kaluar, në mënyrën më të mirë dhe më të shpejtë të mundshme.

Duhet të jetë e qartë për të gjithë myslimanet e botës, se ky tubim madhështor, që quhet Haxh, është përgjigje e një fteseje të pastër politike, adresuar anëtarësisë së ymetit prej Profetëve Ibrahim dhe Muhamed (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi ata të dy dhe mbi familjet e tyre të nderuara!*). Kjo është një ftesë e drejtpërdrejtë dhe e sinqertë e të dy Profetëve të mëdhenj, adresuar të gjitha zemrave besimtare, në skajet e afërta dhe më të largëta të botës, për t'u mbledhur dhe për t'u organizuar në këtë tubim të shenjtë hyjnor. Kjo është një ftesë, adresuar të

gjithë myslimanëve të botës, për t'iu bindur Allahut të Madhërishëm, për të vendosur drejtësi mbi tokë, për të thyer, për të shkërmoqur, për të thërrmuar llojet dhe format më të sofistikuara të putave dhe të zotave të dukshëm dhe të padukshëm, që shfaqen kudo dhe në të gjitha kohërat. Përgjigjja ndaj kësaj ftese të shenjtë është përgjigje ndaj projektit të pandërprerë për të thërrmuar putat që thërrmoi Ibrahimimi dhe Muhamedi (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi ata të dy dhe mbi familjet e tyre të nderuara!*).

Përgjigjja ndaj kësaj ftese të shenjtë është përgjigje ndaj projektit të Musait (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) për të shembur dhe për të mposhtur format më të sofistikuara të diktaturave të zotave të vetëshpallur dhe të tiranive, ashtu siç bëri me Faraonin.

Përgjigjja ndaj kësaj ftese të shenjtë është përgjigje ndaj projektit dhe përpjekjeve për të shembur të gjitha format e faraonizmit ndërkombëtar, që shfaqen në formën e shejtanit të madh dhe kanë për synim të përpijnë interesat e popujve të shtypur të botës.

Përgjigjja ndaj kësaj ftese të shenjtë është përgjigje ndaj projektit hyjnor islam, për të ndaluar të gjitha format e nënshtrimit, të pushtimit dhe të nënshtrimit, që i ushtrojnë fuqitë e djallit ndaj popujve të shtypur dhe të pafuqishëm të botës, të atyre fuqive djallëzore, që i urdhërojnë popujt e shtypur dhe robtë e lirë të Allahut që t'u bëjnë atyre sexhde.

E vërteta e madhe e Haxhit, që përfaqësohet më së shumti te kuptimet e shenjta të thirrjes “Lebejk!”, është emigrim dhe rrugëtim për te Allahu i Madhëruar. Ky emigrim i madh dhe i shenjtë, shkaktar i të cilit janë bërë dy Profetët e nderuar, Ibrahim i dhe Muhamedi (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi ata të dy dhe mbi familjet e tyre të nderuara!*) është përfaqësuesi më i denjë i një “Jo-je” të madhe ndaj formave të sofistikuara të putave, të zotave, të diktaturave, të tiranive dhe të bijve të tyre.

Përfundimisht, rrjedha e thjeshtë logjike na orienton të bindemi dhe të gjykojmë se ku ka putë më të madhe se Amerika, që është grabitqarja më e madhe e botës?! Ku ka putë më të rrezikshme se Bashkimi Sovjetik, ateist, që shtyp pa mëshirë popujt myslimanë?! Ku ka puta më të mëdha dhe më të rrezikshme se putat e kohëve tona?!

HAXHI ËSHTË SHKOLLA E SAKRIFICËS

Me rastin e festës së madhe të Kurban Bajramit, jam sot përpara jush, për t'i shprehur nga thellësia e zemrës përgëzimet më të sinqerta të gjithë botës islame. Kjo është një festë madhështore, që i kujton mbarë njerëzimit festivalin ibrahimit të vetëflijimit dhe të sakrificës. Kjo është festa madhështore e myslimanëve, që risjell për njerëzimin shfaqjen më të sinqertë të sakrificave të gjithë bijve të Ademit, të njerëzve të ndershëm prej dijetarëve dhe eulijave. Dimensionet e vërteta të teuhidit dhe ato politike të këtyre ritualeve të shenjta, nuk mund t'i perceptojë askush tjetër përveç Profetëve, dijetarëve, eulijave dhe njerëzve të dashur dhe të zgjedhur të Allahut të Madhëruar. Ky është Profeti Ibrahim (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*). Babai i shembjes së putave dhe i Zotave të rremë, erdhi për t'i mësuar mbarë njerëzimit se rrëzimi i putave dhe i zotave të rremë, që adhuroheshin padrejtësisht prej popullit të tij, ishte një ndërmarrje e pastër politike dhe shoqërore, përpara se të jetë vepër me dimensione njehsuese dhe adhuruese. Babai i Teuhidit na mësoi ne dhe gjithë njerëzimit se si të sakrifikojmë gjithçka të shtrenjtë dhe të shenjtë për hir të Allahu të Madhëruar.

Festa e Kurban Bajramit do të thotë të përgatitemi mendërisht dhe shpirtërisht për të sakrifikuar gjithçka të

shtrenjtë që kemi, duke i vënë ato në funksion të ndihmesës së çështjes së lartë islame dhe të përhapjes së drejtësisë së Allahut në të gjitha vendet e botës. Profeti Ibrahim (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) i ka mësuar njerëzimit dhe të gjithë pasardhësve të Ademit se Meka e Bekuar është thertorja, ku ofrohen sakrificat më të mëdha të të dashuruarve pas hyjnore. Ai i ka mësuar njerëzimit se këto vende të shenjta janë vendet ku e ka zanafillën fryma e Teuhidit dhe lufta ndaj formave të idhujtarisë, pasi lidhja e fortë e zemrave me të shtrenjtët është shprehje e formave të fshehura të shirkut dhe të idhujtarisë.

Ky është vendi, ku bijtë e Ademit kanë mësuar kuptimet e luftës, të përpjekjeve dhe të sakrificave dhe prej aty i kanë transferuar këto kuptime për pjesën tjetër të anëtarëve të njerëzimit. Janë pikërisht këto vende të shenjta, prej nga burojnë kuptimet hyjnore të vetëflijimit dhe të sakrificave për hir të Allahut dhe të fesë së Tij. Ngrihuni në këmbë dhe tregojini botës se të gjitha këto sakrifica bëhen për hir të Allahut të Madhëruar. Këto sakrifica bëhen për një qëllim të vetëm, të lartë dhe hyjnor, që është lartësimi i Fjalës së Allahut dhe përhapja e drejtësisë dhe e dritës së Tij për mbarë njerëzimin. Tregojini botës se të gjitha këto sakrifica të mëdha kryhen për një qëllim të lartë hyjnor, që është largimi i duarve të femohuesve dhe idhujtarëve prej përcaktimit të fateve të njerëzimit. E vërteta e kulluar hyjnore duhet të përjetësohet te të gjitha normat dhe sjelljet njerëzore deri në Ditën e

Fundit. Ai ishte Profeti i madh, i cili, bashkë me të birin e tij, Ismailin, thërrmoi nga themelet llojet e ndryshme të putave dhe të zotave të rremë. Kjo është tradita e mrekullueshme hyjnore, e ndjekur me të njëjtin pasion dhe rigorozitet edhe prej më të dashurit të krijesave të Allahut, Profetit Muhamedi (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). Ata erdhën për t'i mësuar njerëzimit se duhet të shemben, duhet të thërrmohen dhe duhet të shkatërrohen, që në themel, të gjitha format e putave dhe të zotave të rremë, të cilët ushtrojnë autoritetin e tyre fals mbi anëtarësinë e njerëzimit. Ata erdhën për t'i mësuar njerëzimit se Meka është nëna e qyteteve të botës, zemra dhe shpirti i tyre deri në pëllëmbën më të fundit të tokës së saj. Shenjtëria e saj ka nisur ditën e parë që Allahu i Madhëruar ka krijuar Tokën dhe zgjatet deri në ditën e fundit të saj. Shenjtëria e dheut të saj është e pakonkurrueshme prej asnjë dheu tjetër, deri në skajet më të largëta të gjeografisë. Ajo është Toka e Shenjtë e mbarë njerëzimit, që duhet mbajtur e pastër prej papastërtisë së idhujtarëve dhe femohuesve deri në Ditën e Fundit, që do të ketë jetë mbi tokë. Ajo është Toka e Shenjtë, që duhet mbajtur e pastër prej të gjitha llojeve dhe formave të putave, qoftë diell, qoftë hënë, qoftë planet, qoftë gur, qoftë kafshë apo njeri, duke pasur parasysh dhe duke mos harruar kurrë se forma më e rrezikshme nëpërmjet të cilave shfaqet puta është, njeriu, është tirani, është diktatori.

Prej kohës së Ademit, të përzgjedhurit të Zotit, (Paqja e Tij qoftë mbi të!) e deri te Profeti Ibrahim (Paqja e Zotit qoftë mbi të!) për të mbërritur te i dashuri i Allahut, Profeti Muhamed (Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!) e deri në fundin e kohës, në të cilën do të shfaqet Imam Mehdiu, si shkatërruesi i fundit i putave dhe thirrësi i madh për te feja e Teuhidit, a nuk është në të drejtën tonë të themi se putat më të rrezikshme janë Fuqitë e Mëdha, të cilat shtypin, poshtërojnë dhe robërojnë popujt e dobët të botës, duke u imponuar nëpërmjet fuqisë, dhunës dhe falsifikimit?!

Të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm se Qabeja e Bekuar është qendra e vetme botërore, që mund të realizojë shkatërrimin e këtyre putave. Kjo ishte thirrja e madhe, që e kishte zanafillën në fillim të historisë, me Profetin Ibrahim (Paqja e Zotit qoftë mbi të!). Ky ishte projekti madhështor i këtij Profeti të madh në fillim të historisë, për t'u realizuar me sukses në fundin e kohës prej birit dhe pasuesit të tij të dashur, Imam Mehdiu i premtuar (Shpirtrat tanë iu bëfshin kurban!). Ai është Imami i madh që do të rishfaqet pas mungesës së madhe në fundin e kohës dhe të historisë, për të përsëritur me forcë thirrjen e madhe të Teuhidit nga Qabeja e Bekuar. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë;

“...وَأَدِّن فِي النَّاسِ...” “...thirr ndër njerëzit...”¹²

¹² Surja “El Haxh”, ajeti 47.

Në një tjetër ajet, gjithashtu, thotë:

“...طَهَّرَا بَيْتِي لِلطَّائِفِينَ وَالْعَاكِفِينَ وَالرُّكَّعِ السُّجُودِ”

“...pastroje Shtëpinë Time (Qabenë) për ata që bëjnë tauaf, për ata që qëndrojnë aty për adhurim, për ata që përkulen në ruku dhe për ata që e venë ballin në tokë duke bërë sexhde...”

Kjo mënyrë pastrimi është pastrim prej të gjitha llojeve të papastërtive, me në krye politeizmin dhe idhujtarinë, që u përmendën në ajetin e parë. Në suren “Et Teube” lexojmë, gjithashtu, fjalën e Allahut të Madhëruar:

“...وَأَذَانٌ ... وَرَسُولِهِ ...”

“...thirrje prej Allahut dhe prej të Dërguarit të Tij...”¹³

Shkollat e ndryshme të myslimanëve kanë arritur në një përfundim se, në fundin e kohës dhe të historisë, kur të kthehet Imam Mehdiu i shumëpritur (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*), nga Qabeja e Bekuar ai do të drejtojë thirrjen e Teuhidit për mbarë njerëzimin.

Të gjithë myslimanët, përgjatë historisë, nga Meka e Bekuar dhe nga Qabeja e Shenjtë e kanë drejtuar thirrjen e Teuhidit për mbarë njerëzimin. Nëpërmjet këtyre thirrjeve, nëpërmjet këtyre lutjeve adhuruese, të dala nga shpirti, nëpërmjet ofshamave të shpirtit, të shkaktuara prej duarve të zeza të padrejtësisë, nëpërmjet thirrjeve që dekonspirojnë planet, kurthet dhe intrigat e fuqive të

¹³ Surja “Et Teube”, ajeti 3.

errëta, nga Qabeja e Shenjtë dhe nëpërmjet këtij rituali të shenjtë, myslimanët shprehin gatishmërinë e tyre të plotë për të shembur, për të thërrmuar, për të shkatërruar përfundimisht dhe për të gurëzuar të gjitha llojet e putave dhe të zotave të rremë, me në krye komandantin e djajve dhe të shejtanëve.

Nëpërmjet këtyre thirrjeve thellësisht të ndjera, myslimanët arrijnë të realizojnë të plotë, Haxhin e të shtrenjtit të Allahut, Ibrahimit (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*), Haxhin e më të dashurit të Allahut, Muhamed Mustafasë (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*) dhe Haxhin e Imam Mehdiut (*Paqja e Zotit qoftë mbi të dhe Zoti e ktheftë sa më shpejt në mesin e myslimanëve!*). Nëse nuk do të mundemi të realizojmë këtë formë të Haxhit, qoftë në dimensionin sipërfaqësor, qoftë në thelb, do të bëhemi padyshim pjesë e shembullit, që thotë: “Sa shumë zhurmë dhe sa pak hanxhinj!”.

ZBATIMI I RITUALEVE

Duhet të bëhet e ditur për mbarë myslimanët e botës çështja se tek themelet e bashkimit të myslimanëve te sipërfaqet e shenjta të hyjnore, nëpërmjet aplikimeve të tyre adhuruese dhe jo vetëm, qëndron sakrifica, përpjekja dhe angazhimi i tyre i shenjtë për të këputur duart e fuqive të errëta, që zgjaten te vendet e myslimanëve dhe që synojnë interesat e tyre. Qëllimi më i madh prej ritualit të Haxhit është zbatimi dhe vënia në praktikë e këtyre kuptimeve të shenjta, respektivisht në vendet prej nga vjen secili.

LARGIMI PREJ FEMOHUESVE ËSHTË SHTYLLË PREJ SHTYLLAVE TË HAXHIT

Askush nuk duhet të dyshojë për asnjë moment se prej pikave më të rëndësishme të ritualit të shenjtë të Haxhit dhe kolona vertebrale e tij, është shpallja dhe shprehja në mënyrë deklarative dhe me të gjithë fuqinë e shpirtit, e largimit të plotë prej idhujtarëve dhe femohuesve. Të gjithë myslimanët duhet të jenë të vetëdijshëm se ky largim qëndron te themelet e detyrave njehsuese dhe politike të Haxhit.

Askush nuk mund të pretendojë se mund të realizohet me sukses dhe me sinqeritet shpallja e largimit prej formave të ndryshme të politeizmit dhe të idhujtarisë, pa e deklaruar njëkohësisht urrejtjen dhe largimin prej idhujtarëve, politeistëve dhe hipokritëve. Ku ka vend më të sigurt, më të përshtatshëm dhe më të pastër se Qabeja e Bekuar, për ta shpallur këtë largim, këtë urrejtje dhe këtë armiqësi. Kjo është shtëpia më e rëndësishme për të gjithë banorët e njerëzimit, nga ku mund t'i shpallet luftë formave të ndryshme të shtypjes, të pushtimit, të poshtërimit, të grabitjes, të pabesisë, të shfrytëzimit dhe të robërisë. Cili mund të jetë ai vend më i përshtatshëm se Shtëpia e pastër e Allahut, për të shkatërruar format e ndryshme të putave dhe të zotave, në përgjigje të besës së kërkuar prej Allahut, për të mos pranuar dhe për të mos adhuruar Zot tjetër përpos Tij?

Kryerja e ritualeve të shenjta të Haxhit, në ato vende të shenjta, përfaqëson simbolikën e lëvizjes më të madhe politike që ka njohur historia e njerëzimit, të organizuar nën kujdesin personal të krijesës më të dashur të Allahut, Profetit Muhamed (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*), për të cilën Allahu i Madhëruar është shprehur në Kur'an:

“وَأَذَانٌ مِّنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ إِلَى النَّاسِ يَوْمَ الْحَجِّ الْأَكْبَرِ”

“Ja shpallja e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij, drejtuar njerëzve në ditën e Haxhit të madh...”¹⁴

Duhet ta dimë se është prej traditës së Profetit tonë të nderuar, që të mos shpallë largimin e tij prej idhujtarëve politeistë vetëm në ditët e Haxhit. Detyra e myslimanëve është të mbushin skajet më të largëta të botës me ndjenjën e pastër dhe të dëlirë të dashurisë për Zotin, sikurse është detyrë madhore e tyre të shpallin largimin e plotë, përbuzjen dhe urrejtjen për të gjithë armiqtë e Allahut dhe të fesë së Tij. Këto janë detyrat e shenjta dhe të mirëpërcaktuara të myslimanëve dhe diçka tjetër shumë e rëndësishme kërkohet prej tyre, që të mos dëgjojnë fjalët e hipokritëve, të skeptikëve dhe të njerëzve të shthurur, që punojnë natë e ditë për t'i dobësuar myslimanët dhe për të mbjellë dyshimet te mendjet e tyre, por të bëhen pjesë e pandarë e thirrjes së shenjtë të Teuhidit sa të jetë jeta.

¹⁴ Surja “Et Teube”, ajeti 3.

THIRRJA E LARGIMIT ËSHTË E PËRJETSHME

Të gjithë myslimanët e botës duhet të informohen dhe të qartësohen se thirrja e largimit prej idhujtarëve politeistë nuk është e lidhur vetëm me një kohë të caktuar. Kjo thirrje dhe ky largim është pjesë e tekstit dhe e frymës së kushtetutës së përjetshme të myslimanëve. Edhe në rast se idhujtarët nuk janë më të pranishëm në tokat e shenjta, kjo thirrje, drejtuar besimtarëve, nuk mund të zhvlerësohet dhe nuk mund të shfuqizohet për asnjë arsye, pasi është një thirrje e përjetshme, e vlefshme deri në fund të historisë. Ajo është thirrje e vlefshme për çdo vend dhe për çdo kohë.

Ky tubim madhështor i myslimanëve konsiderohet një prej ritualeve më të shenjta dhe më të rëndësishme të myslimanëve, deri në fund të historisë së njerëzimit. Këtu qëndron edhe urtësia e madhe, për të cilën kanë folur vazhdimisht imamët tanë të nderuar, kur kanë ngjallur traditën e kuvendeve të ngushëllimit, në nder të zotërisë së njerëzve, mbi të cilin është ushtruar padrejtësia më e madhe në histori. Këto kuvende të lavdishme, janë siguria më e madhe për të mbajtur të ngritur dhe të gjallë në kujtesën e njerëzimit thirrjen dhe ulërimën therëse të padrejtësisë, që është ushtruar mbi anëtarët e nderuar të Familjes së Profetit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të*

dhe mbi familjen e tij të nderuar!)). Kjo është siguria më e madhe për të mbajtur të gjallë në kujtesën e myslimanëve dhe të njerëzimit padrejtësitë e tmerrshme të dinastisë emevite, ndëshkimi dhe hidhërimi i Zotit qoftë mbi ta, edhe pse sot janë zhdukur.

LARGIMI DUHET TË SHPALLET PREJ TË GJITHË ZULLUMQARËVE

Në të vërtetë, shpallja e largimit prej idhujtarëve dhe politeistëve të pafe është faza e parë e kësaj lufte, e këtyre sakrificave dhe e përpjekjeve të mëdha. Vazhdimësia e këtij procesi shumë të rëndësishëm shpirtëror dhe mendor i përket periudhave të mëvonshme, pasi secila fazë ka specifikat dhe kërkesat e veta. Pyetja që, me të drejtë, lind është: Cilat janë detyrat tona dhe çfarë duhet të bëjmë në ditët e sotme, në një kohë kur krerët e vendeve të kufrit dhe të idhujtarisë i kanë përpunuar botëkuptimet fetare, kulturore dhe politike të popujve sipas interesave dhe në funksion të planeve të tyre për t'i mbajtur të nënshtruar ata popuj? A mos vallë, duhet të mbyllemi në shtëpitë tona, të qëndrojmë duarlidhur e gojëkëqur, plotësisht të nënshtruar dhe të dorëzuar ndaj planeve të djallit dhe shërbëtorëve të tij?! A mos vallë, duhet të rrimë duarkryq përballë fushatës së djallit dhe të veglave të tij për të shkatërruar, për të degjeneruar dhe për të poshtëruar çdo ditë e më shumë pozitat e racës njerëzore?! A mos vallë, duhet të qëndrojmë duarlidhur përballë të gjitha përpjekjeve të makinerisë propagandistike të djallit, që ka për qëllim përhapjen e kulturës së demoralizimit, të dorëzimit dhe të plogështisë

ndër shoqëritë islame?! A mos vallë, duhet të qëndrojmë të nënshtruar dhe fare pa lëvizur kundrejt përpjekjeve të djallit, për t'i bindur myslimanët se rituali i gurëzimit gjatë Haxhit është i lidhur vetëm me objektet e caktuara pa frymë dhe se Profeti Ibrahim (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*), edhe pse ka qenë prej nismëtarëve kryesorë për shembjen e putave dhe gurëzimin e të gjitha formave të zotave të rremë, përpjekja e tij ka qenë e lidhur vetëm më putat e asaj kohe dhe nuk ka pasur lidhje me luftën kundër fuqive të errëta antinjerëzim?!

I kërkojmë Allahut mbrojtje dhe falje prej një dëshmie si kjo, sepse Ibrahim (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) ka qenë shumë larg këtij pasiviteti, nënshtrimi dhe dorëzimi.

Nuk duhet të ketë asnjë dyshim dhe nuk duhet të ekzistojë asnjë iluzion se përpjekjet e Profetit Ibrahim (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*) për të shkatërruar putat dhe zotat e rremë, si dhe lufta e tij e madhe për të luftuar nemrudët e kohës dhe bashkë me të adhuruesit e diellit, të hënës, të yjeve dhe të formave të ndryshme të zotave të rremë, nuk ka qenë asgjë më shumë se faza e parë e një emigrimi dhe e një përpjekjeje akoma më të madhe, që do të vijonte më pas. Të gjitha vështirësitë e mëdha, me të cilat u përball ky Profet i nderuar, duke filluar me banimin në një vend të shkretë, të mbuluar prej thatësisë, më pas ndërtimi i Shtëpisë së Shenjtë dhe më pas sakrifikimi i birit të tij, Profetit Ismail (*Paqja e Zotit qoftë mbi të dy ata!*), ka qenë një paradhomë apo parahapësirë historike, që i ka paraprirë

vulës së Zbulesave Hyjnore, të zbritur mbi më të dashurin e krijesave të Allahut, mbi Profetin Muhamed (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!*). Jo më kot, thelbi i misionit dhe i thirrjes së Muhamedit ka qenë përsëritja dhe përforcimi i thirrjes së babait të tij, Profetit Ibrahim (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*), kur lëshon kushtrimin më të rëndësishëm të historisë së njerëzimit dhe thotë: “Shpall dhe deklaroj largimin tim të plotë prej idhujtarisë dhe prej gjithçkaje!”.

Nëse do të përpiqemi të shpikim dhe të sajojmë komentime të tjera, të deformatuara, larg këtyre kuptimeve, do të mbërrijmë në përfundimin se në ditët e sotme forma të tilla të adhurimit dhe të idhujtarisë janë zhdukur dhe, për rrjedhojë, përpjekjet e Ibrahimit dhe të Muhamedit (*Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi ata të dy dhe mbi familjet e tyre të nderuara!*) kanë qenë të lidhura thjesht me putat dhe zotat e rremë të kohës kur ata kanë jetuar. Cili është ai njeri, që ka minimumin e mundësive, për të menduar dhe për të medituuar se format e reja, të sofistikuara dhe moderne të adhurimit dhe të politeizmit janë shtuar shumë?! Cili është ai njeri, që e ka të vështirë ta kuptojë, se llojet e ndryshme të putave dhe të zotave të vetëshpallur, kontrollojnë sot fatet e popujve të ndryshëm të botës? Shembulli më i qartë për këtë është Shtëpia e Zezë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nuk nevojitet ndonjë mençuri e madhe për të kuptuar dhe për të konstatuar se ky vend kontrollon sot mendjet, shpirtrat, jetët dhe fatet e

njerëzve në pjesën më të madhe të botës dhe fatkeqësisht në të gjitha vendet islame.

Nuk ka dyshim se thirrja, ulërime dhe largimi ynë prej idhujtarëve dhe femohuesve në ditët tona, është thirrja dhe britma jonë në fytyrë të padrejtësive dhe të atyre që i ushtrojnë ato. Kjo është britma dhe ulërime e një populli (ymeti), të cilit i ka ardhur shpirti në majë të hundës prej formave të sofistikuara dhe të drejtpërdrejta të pushtimeve të Lindjes dhe të Perëndimit, veçanërisht të Amerikës dhe instrumenteve të saj të përhapur dhe të mbjellë me shumicë në mbarë botën. Kjo është ulërimë në fytyrat e të gjitha atyre vendeve që grabisin, vjedhin dhe gllabërojnë pa mëshirë pasuritë e popujve myslimanë dhe të mirat e tyre materiale.

LARGIMI DHE ÇLIRIMI I ENERGJIVE

Sa herë shpallim dhe deklarojmë largimin tonë prej idhujtarëve dhe politeistëve, kemi për synim të çlirojmë energjitë e mbledhura të botës islame. Jam besimplotë se, me ndihmën e Allahut të Madhëruar dhe të brezave të rritur me mësimet e Kur'anit, do të vijë shumë shpejt ajo ditë, kur myslimanët do të realizojnë planet, ëndrrat dhe synimet e tyre. Jam i bindur se nuk do të jetë e largët dita, në të cilën myslimanët do të bashkohen një ditë me njëritjetrin, do të ngrenë zërin dhe do ta përplasnin thirrjen e tyre të fuqishme në fytyrën e tiranëve dhe të zullumqarëve, të cilët kontrollojnë sot padrejtësisht pjesën më të madhe të interesave të tyre. Shpresoj shumë se nuk do të jetë e largët dita, kur njerëzit e vuajtur të ymetit do të mblidhen dhe do të ulërijnë në fytyrat e zullumqarëve thirrjen e tyre të drejtë, duke i treguar të gjithë njerëzimit se zullumqarët, tiranitë dhe diktaturat moderne janë krijesat më të urryera dhe më të mallkuara të njerëzimit.

Nuk ka dyshim se britma dhe ulërima jonë e dhimbjes, është shprehja më e sinqertë e pafuqisë sonë, për të duruar poshtërimin, nënshtrimin, dhimbjen, vjedhjen dhe robërinë. Nuk ka dyshim se thirrja jonë e madhe dhe e drejtë, është shprehja më e sinqertë e përpjekjeve dhe e dëshirës së popujve myslimanë, për t'u arratisur prej

nënshttrimit, pushtimit dhe robërisë, që ushtrojnë përmbi popujt tanë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo është thirrja e të gjithë popujve, të cilët nuk pranojnë më që të jetojnë nën autoritetin e Amerikës, e cila, përveç politikës dhe pasurisë, përpiqet të kontrollojë edhe frymëmarrjet e njerëzve. Kjo është thirrja e të gjithë atyre që kanë dëshirë të jetojnë të lirë, të vdesin të lirë dhe të trashëgojnë thirrjen e largimit, të lirisë dhe të pavarësisë për brezat e ardhshëm.

LARGIMI ËSHTË ULËRIMA E BESIMIT DHE E POSHTËRIMIT

Edhe njëherë e përsërisim dhe deklarojmë se thirrja, ulërima dhe britma jonë e largimit është shprehje e sinqertë e luftës dhe e përpjekjeve tona të sinqerta për të mbrojtur besimin, nderin dhe gjithçka të shtrenjtë që kemi. Kjo thirrje është shprehje e përpjekjeve dhe e luftës sonë të pandërprerë për të mbrojtur Revolucionin dhe arritjet tona të mëdha. Thirrjet dhe britmat tona të largimit, janë shprehjet më të sinqerta të dhimbjes dhe të vuajtjes së gjatë të fyteve tona të çara e të plagosura prej hanxharëve të hipokritëve, të femohuesve dhe të tradhtisë.

Thirrja jonë e madhe është shprehja më e sinqertë e vuajtjeve, e dhimbjeve, e robërisë, e mjerimit dhe e urisë së të gjithë të vuajturve këmbëzbathur, pasuritë dhe të mirat materiale të të cilëve i ka gllabëruar dora e zezë e grykësisë, që nuk ngopet kurrë. Thirrja jonë e sinqertë është përfaqësuese e dhimbjes së madhe të këtyre shtresave të vuajtura, të cilave ua kanë grabitur pasuritë e fituara me djersën e tyre të shkuar curril prej punës, natë e ditë. Kjo është një thirrje, një britmë dhe një ulërimë e sinqertë në fytyrat e të gjithë atyre që kanë pirë gjakun e njerëzve të thjeshtë, të popullit të varfër, të fshatarëve dhe të punëtorëve të mjerë dhe gjithçka bëhet me etiketa

moderne, në emër të kapitalizmit, të socializmit apo të komunizmit. Thirrjet dhe britmat tona të mëdha janë shprehja më e sinqertë e largimit prej këtyre sistemeve të padrejta, të cilat e kanë lidhur nervin kryesor të politikave të zhvillimit ekonomik botëror me interesat e tyre, duke ua mohuar popujve të tjerë të botës të drejtat e tyre më minimale.

Përmbajtja e lëndës

HYRJE.....	5
KAPITULLI I PARË.....	10
DIMENSIONI MORAL I HAXHIT.....	10
Meka, qyteti i luftës dhe i përpjekjes së Profetit (<i>Paqja dhe begatia e Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij të nderuar!</i>).....	10
Qabeja, qendra e dhënies së besës Allahut dhe e largimit ndaj femohuesve.....	14
Xhamia e Shenjtë (El-Mesxhidul -Haram) është shtëpia e të gjithëve.....	16
Xhamia e Shenjtë (El-Mesxhidul -Haram) nuk është vetëm për adhurim.....	17
Rëndësia e dimensionit moral të Haxhit.....	18
E fshehta e “telbijes” - “dëshmisë”, që besimtarët përsëritin gjatë Haxhit.....	20
Çlirohuni prej gjithkujt tjetër, përpos Allahut të Madhëruar.....	24
Haxhi është kërkesë, lutje dhe nevojë drejtuar Allahut të Madhëruar	26
Tregohuni të sinqertë në Haxh.....	29
E fshehta e ritualeve të Haxhit.....	32
Mos e gurëzoni veten tuaj!.....	38
Nuk mund të ketë Haxh të plotë pa Haxh të vërtetë.....	40

Qetësia nëpërmjet Kur'anit gjatë kryerjes së Haxhit.....	44
KAPITULLI I DYTË.....	51
DIMENSIONI SHOQËROR I HAXHIT.....	51
Uniteti në filozofinë e Haxhit.....	51
Haxhi është qendër e njohjes së myslimanëve me njëri-tjetrin.....	54
Bashkohuni të gjithë në gurëzimin e djallit.....	56
Bashkohuni për të kthyer autoritetin në botë.....	59
Bashkimi është e vetmja zgjidhje.....	63
Themeloni frontin e të vuajturve.....	68
Kujdesuni që të mos përçaheni.....	69
Sekreti i triumfit dhe arsytet e disfatës.....	71
Përballuni me intelektualët e shitur.....	73
Bashkimi në namazin me xhemat, me vëllezërit synitë.....	76
KAPITULLI I TRETË.....	78
RËNDËSIA E DIMENSIONIT POLITIK TË HAXHIT.....	78
Haxhi është mundësi për vetëdijesim politik.....	88
Përgatitni raporte.....	92
Imperializmi i druhet bashkimit tuaj.....	93
Mungesa e vetëdijes së të mëdhenjve.....	96
Haxhi është mbledhja e madhe.....	97
Armiku i përbashkët.....	101
Përmirësoni gjendjen e qeveritarëve tuaj.....	104
Përgatituni për të luftuar Izraelin.....	106
Roli i dijetarëve dhe i mendimtarëve.....	112
Mungesa e vetëdijes te dijetarët.....	114
Haxhi i çuditshëm i Abrahamit.....	119

Haxhi është shkolla e sakrificës.....	125
Zbatimi i ritualeve.....	131
Largimi prej femohuesve është shtyllë prej shtyllave të Haxhit.....	132
Thirrja për largim është e përhjetshme.....	134
Largimi duhet të shpallet prej të gjithë zullumqarëve.....	146
Largimi dhe çlirimi i energjive.....	140
Largimi është ulërma e besimit dhe e poshtërimt.....	142

اسم الكتاب: الحج في فكر الإمام خميني

المترجم: الحاج ولنت مريا

التدقيق: صبريه فزا

التصحيح الأدبي: يريدا كولا

التصحيح اللغوي: ويولسا كاراي

الايخراج النهائي و تصميم الغلاف: صبريه فزا

ناشر: جمعية النسيم - تيرانا - ألبانيا